E PËRDITSHME
E PAVARUR
Drejtor:
FAHRI BALLIU
Kryeredaktor:
ILIR NIKOLLA
Nr. 41 (4106)
Viti XIV i botimit
(numri i parë doli më 18.10.1997)
E diel,
14 shkurt 2010

55

Adresa: Rruga "Medar Shtylla", qendra e biznesit
Tel: 04/2321364,
Tel: 04/2321366,
Fax:04/2321365,
Tiranë
E-mail:
info@gazeta55.net,
gazeta55mail@yahoo.com,
Internet:
www.gazeta55.al
Çmimi 30 lekë
Greqi 1,5 EURO

SUPLEMENTI **"LETRAT"**

Përsiatje për praninë gjuhësore të «pellasgjishtes së lashtë»

Nga Mathieu Aref

"Kam punuar pa pushim me librat; pa mbaruar ende njërin, nisja tjetrin"

Intervistë me JK Rowling, dhënë para pak vitesh në transmetimin e BBC

Tryeza politike - Berisha jep zgjidhje, Rama vajton zgjedhjet

Rezoluta e Këshillit të Evropës dhe raporti i OSBE/ODIHR-it për 28 qershorin kanë qenë dokumentet mbi të cilat kryeministri Sali Berisha ka propozuar kompromisin për përmirësimin e kuadrit zgjedhor. I gjendur ngushtë, Edi Rama është mjaftuar me vajtimin e zgjedhjeve, duke parë se s'ka dalje nga humbja elektorale dhe se po i afron 4 marsi i skadimit të mandateve dhe i rrënimit të partisë

Berisha: Opozita ka kartë të bardhë të propozojë të gjitha ndryshimet ligjore për zgjedhjet e ardhshme

NË BRENDËSI

Ambasadori Emmanuel Montobio reagon në emër të Presidencës spanjolle të BE lidhur me tryezën politike

"Të respektohen afatet kushtetuese, vendi i të zgjedhurve është në parlament"

"Kaq për sot", historia e një takimi me diversione

Nga Lavdrim Lita

Bugajski: SHBA-ja të përfshihet në planin për zbatimin e strategjisë për veriun

SPECIALE 4

Publicisti Fahri Balliu, leksion në Universitetin e Brukselit për natyrën e enverizmit

Në Bruksel, u përuruan të përkthyera në gjuhën frënge dy libra të publicistit, botuesit dhe shkrimtarit Fahri Balliu, ku autori mbajti një leksion të hapur në sallën kryesore të Universitetit Ndërkombëtar të Brukselit. Më shumë se 200 të pranishëm, mes të cilëve shkrimtarë, diplomatë dhe eksponentë të diasporës, vlerësuan ligjëratën e shkrimtarit Balliu për krimet e përbindshme të diktaturës enveriste në Shqipëri

ALPET
ENERGJI POZITIVE

NOBEL
Shkolla 12-vjeçare jopublike
Shkolla që sfidon të ardhmen
REGJISTRIMET FILLUAN
Kontakto: 0692099430; 0692076801

I VETMI UNIVERSITET PRIVAT NE JUG
UNIVERSITETI PAVARESIA VLORE
Bulevardi Vlorë-Skele
PO. Box 4358 Posta Vlorë
AL-9401 Vlorë-Albania
Tel: +355 33 4 11 555
Tel: +355 33 4 11 666
Fax: +355 33 4 11 777
info@unipavaresia.edu.al
www.unipavaresia.edu.al

ALPET
ENERGJI POZITIVE

Tryeza - Berisha jep zgjidhje, Rama vajton zgjedhjet

Rezoluta e Këshillit të Evropës dhe raporti i OSBE/ODIHR-it për 28 qershorin kanë qenë dokumentet mbi të cilat kryeministri Sali Berisha ka propozuar kompromisin për përmirësimin e kuadrit zgjedhor. I gjendur ngushtë, Edi Rama është mjaftuar me vajtimin e zgjedhjeve, duke parë se s'ka dalje nga humbja elektorale dhe se po i afron 4 marsi i skadimit të mandateve dhe i rrënimit të partisë

Nga Leonard Quku

Mbyllet pa asnjë rezultat të prekshëm takimi i parë ndërmjet mazhorancës dhe opozitës në zyrën e Presidentit të Republikës, Bamir Topi, në Presidencë, takim ky, i filluar në orët e para të paradites së djeshme, përfaqësuesit e dy forcave më të mëdha politike në vend, nga njëra anë kryetari i mazhorancës dhe njëherazi kryeministri Sali Berisha i shoqëruar nga kreu i grupit parlamentar të PD dhe nga ana tjetër lideri i opozitës Edi Rama, i shoqëruar nga kryetari i Asamblesë Kombëtare të PS, Gramoz Ruçi, diskutuan për plot 3 orë, në prani edhe të kreut të shtetit, lidhur me rekomandimet e rezolutës së Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

Mësohet se takimi prej më shumë se tre orësh u ka shërbyer palëve politike për ngritjen e çështjeve zgjedhore ndërsa është konfirmuar nga shefi i mazhorancës dhe i qeverisë, Sali Berisha zotimi përballë ligjit, për të miratuar çdo kompromis që lidhet me zgjedhjet, ndërsa ka nënvizuar me vendosmëri se çështjet e gjykatave nuk do të diskutohen.

"Jemi të gatshëm për të gjitha kompromiset e nevojshme për çështjet zgjedhore. Ne nuk mund të trajtojmë çështje që i ka vendosur gjykata. Ne ramë dakord që Presidenti të vijojë rolin e tij në normalizimin e situatës politike", u shpreh kryeministri Berisha. Berisha gjithashtu bëri të ditur se i kërkoi kreut të PS të listojë çdo kërkesë të mëtejshme, porse duke paralajmëruar se kërkesa për hapjen e kutive bie ndesh me ligjet dhe Kushtetutën e vendit.

Sipas kryeministrit, përmes një qëndrimi të tillë, PS po dhunon sistemin gjyqësor në vend. "Unë i kërkova zotit Rama ta listojë gjithë problematikën. Natyrisht unë nuk mund të trajtoj dhe nuk kërkoj të trajtohet problemi që kam me gjykatën sikundër problemet që Rama i ka me Gjykatën e Apelit, kjo është ajo që mund të them, çdo problem që ka me mazhorancën jam i hapur ta trajtoj, por problemet me gjykatat, jo", deklaroi kreu i mazhorancës, Sali Berisha.

Tryeza e Presidentit Topi përfundoi pas tre orësh negociata ndërmjet Berishës dhe Ramës.

Mësohet gjithashtu se Presidenti, ka kërkuar nga të dy përfaqësuesit e forcave politike, zgjidhje të ngërçit brenda kuadrit të lejuar ligjor. Për këtë, kreu i shtetit ka pranuar edhe rolin e tij si negociator, rol që ia atribuon edhe rezoluta e Këshillit të Evropës.

Takimi i parë i presidentit Bamir Topi me delegacionet e dy partive kryesore politike në vend, Partisë Demokratike dhe Partisë Socialiste, ashtu siç ishte pritur, ka konfirmuar qëndrimin radikal të Edi Ramës, i cili ka mbetur tek kërkesat antikushtetuese të hapjes së kutive, në kundërshtim me vendimin e Gjykatës së Apelit.

Qëndrimi duket se ka vendosur në pozitë edhe presidentin e republikës, i cili tashmë ka detyrimin që të identifikojë mënyra të tjera për kapërcimin e ngërçit politik, i cili duket se do të dëmtojë edhe ecurinë e reformave në vend.

Në përfundim të takimit, kryeministri Sali Berisha ka qenë i pari që është deklaruar për mediat, duke konfirmuar qëndrimin e mazhorancës se ajo është e hapur për të gjithë kompromiset që mbështeten në dy dokumente kryesore; në rezolutën e Këshillit të Evropës si dhe në raportin e OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet e 28 qershorit.

Ende s'është e qartë se si do të vijohet dialogu, por me sa duket, afrimi i skadencës së 4 marsit për deputetët socialistë do të sjellë eksportimin e debatit brenda grupit parlamentar socialist, i cili po ndjen se është sakrifica kryesore e qëndrimit jopolitik të kryetarit të PS-së, Edi Rama.

Në deklaratën e parë zyrtare të Edi Ramës, u duk se ai kishte dalë nga tryeza në një ngushticë kohe, meqenëse u përkujdes të theksonte se oferta e tij për dialog s'mund të priste shumë gjatë. "E sqarova Berishën se ne nuk kemi punë me vendimin e gjykatave dhe nuk bëjmë përpjekje për të përmbysur rezultatin, por duam realizimin e autopsisë së zgjedhjeve të vdekura, me qëllim që zgjedhjet e ardhshme të mos jenë të tilla", u shpreh Rama, në konferencën për shtyp. Ai theksoi se opozita nuk tërhiqet nga kërkesa për transparencë të zgjedhjeve dhe se lënia e kutive jashtë objektit të hetimit parlamentar, do të ishin shkelje e parimit për të nxjerrë në dritë të vërtetën e 28 qershorit.

Edvini theksoi se është i gatshëm për të vazhduar dialogun, por sipas tij, kjo nuk mund të zgjasë për shumë kohë, sepse thellimi i krizës bëhet edhe më tepër problematik në interes të shqiptarëve. Ende s'është e qartë se si do të vijohet dialogu, por me sa duket, afrimi i skadencës së 4 marsit për deputetët socialistë do të sjellë eksportimin e debatit brenda grupit parlamentar socialist, i cili po ndjen se është sakrifica kryesore e qëndrimit jopolitik të kryetarit të PS-së, Edi Rama.

Vetë presidenti Bamir Topi rezervoi në daljen e vet vetëm fjalë të mira për tryezën, duke e klasifikuar atë si një përvojë të mirë politike në vend dhe duke lavdëruar të dyja partitë si të angazhuara për të mos e lënë vendin më gjatë në këtë ngërç institucional.

Në përfundim të deklarimit të tij për mediat, ai përsëriti se ishte rënë dakord për të "eksploruar" mundësitë për gjetjen në të afërmen të një zgjidhjeje që do të kthente opozitën në parlament.

Presidenti Bamir Topi flet për tryezën

"Dialogu do të vazhdojë deri në gjetjen e një zgjidhjeje"

Presidenti i Republikës Bamir Topi, u shpreh dje pas tryezës së organizuar prej tij, sipas rekomandimeve të rezolutës së Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, se dialogu nuk do të ndalet deri në rikthimin e opozitës në Kuvend.

Kreu i shtetit vlerëson rifillimin e dialogut politik mes mazhorancës dhe opozitës dhe njëherazi garanton se do të qëndrojë në gatishmëri të plotë deri në kapërcimin e ngërçit institucional. "Pritshmëria për këtë takim ka qenë e lartë, interesi i medias, i opinionit publik, për të parë një rifillim të dialogut politik të munguar prej kohësh. Unë besoj që momenti më pozitiv i ditës së sotme është predispozicioni për t'u ulur në tryezë, rifillimi i dialogut politik midis dy elementeve substanciale të demokracisë, mes mazhorancës dhe opozitës, e cila ka ditur në vitet e pluralizmit shqiptar të bashkëpunojë, ka ditur të kalojë traumat e bashkëpunimit dhe jam i bindur që edhe takimi i sotëm, i cili angazhoi në më shumë se tre orë, në bisedime të hapura, në bisedime pa komplekse të aktorëve kryesorë të politikës shqiptare, të cilët diskutuan për opsionet e tyre dhe natyrisht dhanë një element shumë të rëndësishëm që tryeza e dialogut do të vazhdojë"- u shpreh Topi.

Topi u shpreh se nuk do të tolerohet asnjë cenim ndaj demokracisë dhe stabilitetit të saj. Ai u shpreh se do të punohet që demokracia në Shqipëri të jetë funksionale dhe të mos ndërpriten aspiratat e vendit drejt strukturave evropiane.

"Ne do të punojmë në pikat ku palët mund të gjejnë gjuhën, mund të bashkëpunojnë dhe sigurisht kjo jep shpresë që kjo tryezë, së bashku me elementë të tjerë që kanë të bëjnë jo thjesht vetëm me faktorët politikë, por edhe ekspertizë, gjithmonë mbi bazën e vullnetit politik të shprehur, të vazhdojë dhe të japë garanci që demokracia në Shqipëri do të jetë funksionale, do të jetë efikase në funksion të interesave më madhore të popullit shqiptar", deklaroi Presidenti Topi. Ndërkaq, duke theksuar nevojën e shtrirjes së dialogut, presidenti vlerësoi rolin e ndërkombëtarëve, në mënyrë të veçantë Këshillin e Evropës ku Shqipëria është anëtare nga korriku i vitit 1995-së, përfaqësuesit e vendeve të Bashkimit Evropian në Tiranë, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të gjithë ata që kontribuuan që të realizohej tryeza politike.

"Unë i kërkova zotit Rama ta listojë gjithë problematikën. Natyrisht unë nuk mund të trajtoj dhe nuk kërkoj të trajtohet problemi që kam me gjykatën sikundër problemet që Rama i ka me Gjykatën e Apelit, kjo është ajo që mund të them, çdo problem që ka me mazhorancën jam i hapur ta trajtoj, por problemet me gjykatat, jo"

Kryeministri Sali Berisha flet pas tryezës

Opozita ka kartë të bardhë të propozojë të gjitha ndryshimet ligjore për zgjedhjet e ardhshme

"Unë garantova Presidentin e Republikës dhe zotin Edi Rama se ne jemi të gatshëm për të gjitha kompromiset e nevojshme, për të gjitha çështjet zgjedhore, bilaterale, pra mes Partisë Demokratike dhe Partisë Socialiste. Në këtë kontekst, unë i propozova zotit Rama të listojë të gjitha çështjet dhe problemet që ekzistojnë mes mazhorancës dhe opozitës, mes Partisë Demokratike dhe Partisë Socialiste dhe ne do t'i trajtojmë ato në mënyrën me serioze dhe më konstruktive"

Kryetari i mazhorancës dhe njëherazi kryeministri Sali Berisha shprehet se problemet e partive me gjykatat, nuk mund të kthehen në probleme ndërpartiake dhe që të cenojnë stabilitetin politik.

Kreu i qeverisë vuri në dukje se kërkesat të cilat nuk kanë asnjë bazë ligjore dhe për më tepër janë të fryra nga problemet e një partie, në rastin konkret PS, me Gjykatën e Apelit, nuk është pjesë e bisedimeve dhe nuk mund të marrë asnjë zgjidhje nga tryeza e Presidentit Topi. Këtë deklaratë kryeministri Berisha e bëri pas takimit të zhvilluar në Presidencë me kryesocialistin Edi Rama, takim ky i kërkuar nga Presidenti Topi, pas rekomandimeve të rezolutës së KiE, mbi situatën politike në Shqipëri. "Aty ne patëm një shkëmbim të hapur të mendimeve dhe pikëpamjeve. Ne ramë dakord që Presidenti i Republikës të vazhdojë të eksplorojë të gjitha mundësitë e konvergjencave për çështje bazuar në Rezolutën e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe në raportin përfundimtar të OSBE/ODIHR-it. Sikundër ne jemi dakord për të plotësuar të gjitha kërkesat e Rezolutës Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe raportit përfundimtar të OSBE/ODIHR –it mbi zgjedhjet e 28 qershorit, të cilat janë vlerësuar nga 510 vëzhgues ndërkombëtarë si zgjedhjet që plotësuan shumicën e angazhimeve të OSBE/ODIHR-it dhe në të cilat nuk pati asnjë provë për manipulim të rezultatit apo numërim të parregullt. Po në këtë kontekst, në kuadër të rezolutës së KE dhe raportit përfundimtar të OSBE/ODIHR-it, koalicioni qeveritar i ofron zotit Rama dhe opozitës që të hartojë të gjitha amendamentet për adresimin e vërejtjeve dhe sugjerimeve të tyre dhe mazhoranca do t'i votojë ato. Sikundër jemi të gatshëm të ngremë komisionin hetimor parlamentar që në seancën e ardhshme, ku opozita të ketë shumicën në të gjitha votimet në këtë komision, përmes tërheqjes së dy anëtarëve tanë nga kuorumi i tij.

Gjithashtu, unë garantova Presidentin e Republikës dhe zotin Edi Rama se ne jemi të gatshëm për të gjitha kompromiset e nevojshme, për të gjitha çështjet zgjedhore, bilaterale, pra mes Partisë Demokratike dhe Partisë Socialiste. Në këtë kontekst, unë i propozova zotit Rama të listojë të gjitha çështjet dhe problemet që ekzistojnë mes mazhorancës dhe opozitës, mes Partisë Demokratike dhe Partisë Socialiste dhe ne do t'i trajtojmë ato në mënyrën me serioze dhe më konstruktive", u shpreh kreu i qeverisë Berisha.

Duke u ndalur te pretendimet e Partisë Socialiste, kryeministri Berisha vuri në dukje se tryeza, me asnjë kusht nuk mund të trajtojë problemet e Partisë Socialiste me gjykatat.

"Natyrisht, unë nuk mund të trajtoj problemet zgjedhore që PS ka me Gjykatën e Apelit, sikundër unë nuk kërkoj trajtimin nga ne të dy të problemeve zgjedhore që Partia Demokratike ka me Gjykatën e Apelit. Problemet me vendimet gjykatave nuk janë probleme midis partive, por janë çështje që secila prej partive ka me pushtetin gjyqësor dhe vendimet e tij. Ju e dini se për Partinë Demokratike, në mënyrë të përsëritur, Gjykata e Apelit dhe Kolegji Zgjedhor kanë dhënë vendime të disfavorshme, madje edhe në zgjedhjet e fundit. Por unë nuk i kam bërë asnjëherë ato probleme ndërpartiake, sepse ato kanë qenë probleme midis Partisë Demokratike dhe pushtetit gjyqësor, vendimet e të cilit kemi qenë dhe jemi të detyruar t'i pranojmë. E njëjta gjë vlen edhe për Partinë Socialiste", deklaroi Berisha, duke shtuar se Gjykata e Apelit ka hedhur poshtë jo vetëm kërkesën e zotit Rama për rinumërim të votave në disa zona, por ajo ka hedhur poshtë edhe kërkesën e Partisë Demokratike për rinumërim në distriktin e Fierit.

"Bazuar në nenin 116 të kodit elektoral, i cili sanksionon se rinumërimi votave mund te behet vetëm ne raste kur ka kundërshtime gjate procesit të numërimi të tyre, gjykata konkludoi se nuk mund të ketë rinumërim të votave pa kundërshtime gjatë numërimit të tyre. Përveç kësaj, Gjykata e Apelit shpalli të pavlefshme, me kërkesë të PS, 512 votat e komunës Rushdije vetëm pse fletët e votimit nuk kishin dy vula, por vetëm një (për arsye se njërën vulë e mori komisioneri i Partisë Socialiste dhe u largua nga Qendra e Votimit gjithë ditën). Dhe në këtë mënyrë i dha mandatin Partisë Socialiste.

Natyrisht këtë vendim PS e pranon por ajo nuk pranon vendimin tjetër me të cilin Kolegji Zgjedhor hodhi poshtë kërkesën e saj për rinumërim të votave. Unë nuk kam akuzuar zotin Rama se më grabiti mandatin për Rushdijen. Jo! Mandati iu mor Partisë Demokratike nga Gjykata e Apelit dhe unë e kam pranuar këtë vendim. Çështje të cilat Partisë Socialiste ia ka hedhur poshtë gjykata janë çështje mes saj dhe pushtetit gjyqësor dhe jo mes saj dhe Partisë Demokratike. Duke respektuar këto parime mendoj se çdo çështje tjetër mund të zgjidhet", deklaroi kryeministri.

Kreu i qeverisë theksoi se mazhoranca mbetet e vendosur të japë të gjithë ndihmesën e saj për një rezultat sa më pozitiv të dialogut.

"Unë dua të siguroj qytetarët shqiptarë se ne mbetemi të vendosur të japim të gjithë ndihmesën tonë për një rezultat pozitiv të dialogut"' tha Berisha.

Berisha përshëndeti kreun e shtetit, për këtë iniciativë të rëndësishme, duke e konsideruar atë si jetike për vijimin e progresit politik të Shqipërisë dhe si një detyrim të ushtruar nga rezoluta e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

"Dua të falënderoj Presidentin e Republikës për ftesën dhe të shpreh bindjen time se tryeza e thirrur nga ai ishte një përpjekje pozitive dhe serioze", deklaroi ndër të tjera, kryeministri Sali Berisha.

Rezoluta e KiE, flet qartë për rolin e opozitës, të rikthehet në Kuvend dhe të ngrihet aty komisioni hetimor

Edvin Rama po tenton të sfidojë edhe institucionet ndërkombëtare

Në një kohë kur rezoluta e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, flet qartë për rolin e ardhshëm të opozitës, pas afro 6 muajsh çuarje dëm, kryesocialisti Edvin Rama, duket se po mendon të sfidojë edhe insistimin e ndërkombëtarëve me kokëfortësinë dekompozuar, të mos heqjes dorë nga kërkesat antiligjore. Nisur nga ky pozicion dhe prirja e Ramës për të mos iu nënshtruar dialogut, një element ky tepër domethënës, për demokracinë dhe stabilitetin e saj, PS jo vetëm nuk ka ndërmend që të demonstrojë një sjellje ndryshe në tryezën e negocimit, por pritet të improvizojë të tjera sajesa, siç ishte ai memorandumi i djeshëm, që u depozitua në mënyrë të pakuptimtë vetëm pak minuta para se të fillonte tryeza e takimit. Edi Rama, po tregon se nuk di nga t'ia mbajë. Presioni në drejtim të tij është i jashtëzakonshëm me afrimin e ditës së skadencës së mandateve ylberiste.

Ndaj edhe i shqetësuar për skarcitetin e ardhshëm politik, lakuriqi i PS nga disa podiume shtypi, referon ligjëratat stresuese që opinioni publik ka muaj të tërë që i dëgjon.

Duke u kthyer në kohë dhe për të korresponduar shpërfilljen e ndërkombëtarëve nga ana e Edvinit, rezoluta e KiE, është një shembull konkret i arrogancës së Edvinit jo vetëm ndaj rendit kushtetuese në vend, por edhe ndaj kancelarive të kulturuara dhe të standardizuara perëndimore.

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, miratoi ditët e fundit të janarit, një rezolutë lidhur me situatën politike në Shqipëri.

Në bazë të rekomandimeve të dy raporterëve të KiE, Ëilshare dhe Laasko, euro-deputetët referuan gjatë për atë që po ndodhte në Shqipëri, pas vendimit të opozitës për të bojkotuar pa afat punimet e Kuvendit.

Në unison, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, dënoi qëndrimin e palës opozitare dhe i kërkoi asaj rikthim të menjëhershëm në parlament, pasi në të kundërt ishte duke cenuar stabilitetin politik të Shqipërisë.

Referuar argumenteve të qëndrueshme të përfaqësuesve të mazhorancës, KiE, miratoi me shumicë votash një rezolutë, e cila përbën edhe udhërrëfyesin e zgjidhjes së ngërçit institucional në vend. Tryeza e organizuar dje nga Presidenti Topi, është vetëm hapi i parë, i dëgjimit të pretendimeve të palëve, por vendimin i saj është vetëm këshillues, çka do të thotë se Edi Rama ka në mendje të çojë deri në fund tymnajën e tij, për të dhunuar ligjet dhe institucionet kushtetuese.

Nga një vend me stabilitet të çmuar dhe me një klasë politike të emancipuar, Edvin Kristaq Rama, ka konfirmuar formacionin politik që drejton, si "blozën në të bardhë" dhe në mënyrë rigoroze po mendon vetëm për përshkallëzimin e destabilitetit politik.

Publicisti Balliu, leksion në Universitetin e Brukselit për natyrën e enverizmit

Nga Eden Babani, Bruksel
Fotot nga Asllan Krasniqi

Në Bruksel, u përuruan të përkthyera në gjuhën frënge dy libra të publicistit, botuesit dhe shkrimtarit Fahri Balliu, ku autori mbajti një leksion të hapur në sallën kryesore të Universitetit Ndërkombëtar të Brukselit. Më shumë se 200 të pranishëm, mes të cilëve shkrimtarë, diplomatë dhe eksponentë të diasporës, vlerësuan ligjëratën e shkrimtarit Balliu për krimet e përbindshme të diktaturës enveriste në Shqipëri

Me nismën e Universitetit të Lirë Ndërkombëtar të Brukselit (L'Université Libre Internationale) dhe të Qendrës Europiane të Kërkimeve Ndërkombëtare dhe Strategjike (Centre Européen de Recherches Internationales et Strategiques – C.E.R.I.S), u përuruan në Bruksel dy libra të publicistit, botuesit dhe shkrimtarit Fahri Balliu: „La femme du diable" („Zonja e djallit") dhe „La dictature des sens" („Diktatura e shqisave"), njohur në Shqipëri përkatësisht me titujt: „Zonja e Zezë Nexhmije Hoxha" dhe „Panteoni i zi". Të dy librat, përkthyer në gjuhën frënge, janë botim i Shtëpisë Botuese Favre.

Mbrëmja përuruese u mbajt në një nga sallat e leksioneve të Universitetit të Lirë Ndërkombëtar, në prani të më shumë se dyqind bashkatdhetarëve nga Shqipëria, Kosova dhe trojet e tjera etnike me banim në Belgjikë, si edhe shumë të ftuarve vendas.

Ishin të pranishëm: Ambasadorja e Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Belgjikës, në BE dhe në Dukatin e Madh të Luksemburgut, zonja Mimoza Halimi, si edhe Konsulli, zoti Naim Mandri. Ambasadën e Republikës së Kosovës në Bruksel, e përfaqësonte Këshilltari i saj, zoti Gani Azemi.

Tubimin dhe praninë e autorit dhe të zonjës Balliu, e nderuan gjithashtu: Rektori Karim P. Ouedraogo, Dekani Ramadan Gjanaj, Profesor Andre Miroir (drejtor i C.E.R.I.S.), Profesor Sulejman Gjanaj, nënkryetar i Partisë së Lëvizjes së Legaliteit (P.L.L), dhe punonjës të tjerë të Universitetit. Nga komuna e Skarbeekut (një ndër më të mëdhatë Brukselit, me përqendrimin më të madh të shqiptarëve), e përfaqësonte përgjegjësi i kulturës. Ishte i pranishëm edhe drejtuesi i Shtëpisë Botuese Favre.

Nga Parisi kishte ardhur Doktor i Shkencave Politike dhe i Marrëdhënieve Ndërkombëtare, njëherësh autor i librit „Historia e Mbretërisë Shqiptare", Profesor Patric Najbor.

Pas fjalës së hapjes nga ana e Rektorit Ouedraogo, përshëndeti dekani, zoti Ramadan Gjanaj. Në vijim, drejtori i C.E.R.I.S., Profesor Andre Miroir, duke iu referuar brendisë së librave të Balliut, solli konsideratat e veta lidhur me regjimet komuniste dhe udhëheqësit komunistë. Fjala e Profesorit, mes stilit filozofik-shkencor dhe atij letrar-ironizues, tërhoqi vëmendjen dhe duartrokitjet e dëgjuesve.

Nga ana e tij, zoti Fahri Balliu falënderoi në fillim të pranishmit për nderin që i bënë me pjesëmarrjen e tyre në tubim. Rastin fatlum të takimit me ta, autori i librave përurues e vlerësoi si hap drejt një miqësie të ardhshme. Sot e tutje, tha ai, unë ju quaj miq të mi, të gjithë ju që jeni në këtë sallë. Në vijim, Balliu shpjegoi për të pranishmit shtysat që i nxitën dëshirën për të shkruar veprat në fjalë. Shkrimtarët dhe gazetarët, tha ai, i zbulojnë faktet jetësore hap pas hapi. Shtysa që t'i thonë ato, bëhet dora-dorës e papërmbajtshme. Atëherë, njeriu i penës ndjen nevojën t'i hedhë në letër dhe t'i bëjë të njohura për publikun e gjerë.

Botuesi dhe drejtori i gazetës „55" shtoi se e kanë tërhequr tej mase hulumtimi mbi bëmat çnjerëzore të komunizmit në Shqipëri, krimet e përbindshme të të ashtuquajturve udhëheqës komunistë, gjysmakë për sa i takon formimit kulturor, perversë dhe gjakësorë në performancën e tyre kriminale. Në këtë linjë, ai shtjelloi karakterin e personazhit të tij historik në veprën „La femme du diable" („Zonja e zezë"). Sipas hulumtimeve të zotit Balliu në burime arkivore, ai nuk ka mundur të gjejë as edhe një dokument ku Zonja e Zezë të ketë shprehur emocione njerëzore, me përjashtim të letrës që i ka shkruar emisarit jugosllav Dushan Mugosha. Hoxha dhe e shoqja, tha ai, ose Djalli dhe Zonja e Djallit, zgjodhën variantin më të keq të komunizmit real shtetëror, atë të Stalinit, duke e orientuar njëherësh drejt instalimit të komunizmit familjar, çka prodhoi tragjedi të mëdha në popull. Enver Hoxha vrau, burgosi, internoi dhe përndoqi vetëm bashkëkombës të vetët, tha ia. Ndryshe nga tiranë dhe diktatorë të tjerë që ka njohur historia botërore, nuk është gjetur deri më sot ndonjë dokument i cili të vërtetoje që, me urdhër të Enver Hoxhës, të jetë vrarë të paktën një njeri me kombësi tjetër, përveç asaj shqiptare. Makina propagandistike e udhëhequr nga Zonja e Djallit, u fryu borive të urrejtjes ndaj kosovarëve dhe çamëve, duke krijuar një ekuilibër të paprecedent në historinë rajonit: në dobi të të huajve, vrastar për shqiptarët. Falë këtij ekuilibri antikombëtar, çifti Hoxha synoi përjetësimin e pushtetit për vete dhe për pasardhësit. Froni i përgjakur mbi të cilin qëndroi çifti vrastar dyzet e kusur vjet, u ngrit mbi eshtrat e më shumë se 5000 të dënuarve me vdekje, të zhdukurve nëpër burgje e internime, mbi vuajtjet e më shumë se 66 mijë të internuarve në kampet e punës së detyruar. Instalimin e komunizmit familjar në Shqipëri, projektuar dhe jetësuar nga çifti Hoxha, po e vuajnë sot e gjithë ditën jo vetëm shqiptarët me banim në Republikën e Shqipërisë, por edhe ata të Republikës së Kosovës, të trojeve etnike dhe të diasporës, falë brezit të dytë të bllokmenëve që kanë uzurpuar kreun e Partisë Socialiste dhe që përpiqen me çdo kusht e me çdo mjet të pengojnë afrimin e Shqipërisë e të shqiptarëve me botën demokratike të Perëndimit. Rasti më i freskët është rrëzimi i Ligjit për Lustracionin nga ana e Gjykatës Kushtetuese, ku gjallojnë shërbyes të ish-diktaturës komuniste. Rrëzimi i Ligjit në fjalë, është një goditje e rëndë për ish-të përndjekurit politikë, të cilët ngado që të vërtiten, ndeshen me persekutorët e tyre që kanë lëshuar rrënjë në gjykata, në prokurori, në administratën shtetërore, në noteri etj.

Më tej, zoti Balliu solli shifra krahasuese mes krimeve të kryera nga Sigurimi i shtetit mbi afro tre milionë shqiptarë dhe atyre të kryera nga STAS-i mbi afro dhjetë milionë gjermanë të Gjermanisë Lindore. Duke vënë ballë për ballë shifrat e 250 të ekzekutuarve për motive politike në Gjermaninë Lindore dhe të mbi 5000 të dënuarve me vdekje me po ato motive në Shqipëri dhe në të njëjtën periudhë kohe dyzetvjeçare, për të huajt e pranishëm në tubim, komentet ishin të panevojshme.

Lidhur me bashkëpunimin mes shërbimit sekret shqiptar dhe atij jugosllav, zoti Balliu tregoi në mënyrë të këndshme historinë e një fatkeqi nga Pogradeci, i cili, i rekrutuar nga Sigurimi i Shtetit, u dërgua diku te të afërmit e vet në Maqedoni, me qëllim spiunimi. UDB-a e arrestoi dhe pasi e ballafaqoi me emrin me të cilin njihej në dokumentet e Sigurimit shqiptar, e detyroi të pranonte dhe të nënshkruante një rekrutim të dytë, këtë herë për të spiunuar vendin e vet. Kthimi në Shqipëri i spiunit tashmë të dyfishtë, e vuri fatkeqin përballë së njëjtës provë. Sigurimi i Shtetit kishte dijeni për rekrutimin e tij të dytë. I befasuar dhe pa rrugëdalje, spiuni i pafat iu kthye oficerit të Sigurimi: „Pse s'thua, ju qenkeni e njëjta ndërmarrje!" Ngjarja për të qeshur e për të qarë, la përshtypje të madhe në sallë, sidomos te të huajt.

Pyetjeve të Profesor Patric Najbor, autori i librit „Historia e Mbretërisë Shqiptare", zoti Balliu iu përgjigj me vlerësime për arritjet e Shqipërisë në periudhën e mbretërimit të Ahmet Zogut, qoftë në fushën e organizimit të administratës shtetërore, të policisë dhe të ushtrisë, qoftë në fushën e ekonomisë dhe të financave, qoftë në drejtësi, në arsim e kulturë, qoftë në atë të diplomacisë. Ka ardhur koha, shtoi ai, që të bëhet më shumë për të vënë në dukje të vërtetat historike që u shtrembërua nga historiografia komuniste.

Në përfundim të fjalës së vet, zoti Fahri Balliu, solli në kujtesë të pjesëmarrësve arritjet e sotme të qeverisë së Kryesuar nga Kryeministri Berisha. Unë, tha ai, kam shkruar një libër mbi përpjekjet e Berishës për të mposhtur kasandrat që pengojnë vendosjen e demokracisë në Shqipëri. Do të shkruaj edhe shtatë të tjerë me qëllim që të vë në dukje qeverisjen e tij të vështirë, por të suksesshme.

Në koktejin e rastit, të pranishmit bënë fotografi me autorin, morën autografe prej tij, si dhe shkëmbyen mendime dhe kartëvizita.

Ambasadori Emmanuel Montobio reagon në emër të Presidencës spanjolle të BE lidhur me tryezën politike

"Të respektohen afatet Kushtetuese, vendi i të zgjedhurve është në parlament"

Ambasadori i spanjoll, Emmanuel Montobio, vendi i të cilit udhëheq Presidencën e radhës të Bashkimit Evropian, shprehet rreth tryezës së dialogut e iniciuar dje, ku lideri i mazhorancës Sali Berisha dhe kreu i opozitës Edi Rama, u ulën në bisedime dypalëshe se, është një hap i rëndësishëm për gjetjen e një kompromisi të mundshëm.

Sipas ambasadorit Spanjoll, ka ardhur koha që klasa politike të gjejë vetë një zgjidhje të plotë dhe brenda kuadrit kushtetues.

"Unë mendoj se ky është një hap shumë i rëndësishëm, përpara. Një proverb kinez thotë se me një hap mund të nisësh një rrugë prej 3 mijë miljesh, dhe unë shpresoj se ky hap është i pari në rrugën e integrimit të Shqipërisë në BE. Dialogu si një mjet politik mes liderëve politikë, gjë që është normale në një demokraci janë përpjekjet për të zgjidhur problemet politike të vendit brenda kuadrit institucional dhe kushtetues të vendit dhe ndaj ne inkurajojmë këtë nismë të presidentit Topi, e nxisim atë të vazhdojë rolin e tij drejtues", u shpreh Montobio.

Montobio informoi se më 22 shkurt në Tiranë do të vijnë dy anëtarë KiE, për të parë hapat me të cilat po zgjidhet kriza dhe jo për ta zgjidhur atë.

"Për të parë hapat me të cilat do të zgjidhet kriza politike në Shqipëri, më 22 shkurt do të vijnë në Tiranë një delegacion i përbërë nga 2 anëtarë. Nuk do të vijnë për të zgjidhur krizën por për të parë hapat me të cilat ajo po zgjidhet nga politika shqiptare", theksoi më tej, ambasadori spanjoll.

Montobio shton se afati i fundit për zgjidhjen e krizës është data 6 mars, por, tha ai, janë të gjitha shpresat që kjo krizë të jetë zgjidhur para kësaj date.

"Sidoqoftë, ka një afat kushtetues më 6 mars për shkak të 6 muajve që duhen për të marrë vendin në parlament nga deputetet, në këtë rast të opozitës. Ajo që ka thënë BE në çdo kohë ka qenë që vendi të gjithë parlamentarëve është në parlament dhe që ne do të donim që kjo situatë të kapërcehej në mënyrë që të lejohet që kur afati të mbërrijë në këtë lloj avancimi të kemi deputetët në parlament", nënvizoi ambasadori spanjoll.

Deklaron Zëvendëspresidentja e Parlamentit Evropian, Roberta Angelilli

"Opozita të kthehet në Kuvend, të bashkëpunojë me qeverinë dhe të përfaqësojë zgjedhësit"

Parlamenti Evropian shprehet edhe njëherë mbi situatën politike në Shqipëri, duke dëshmuar se rikthimi i opozitës në kuvend, pas muajsh të tërë sabotimi total të institucioneve shtetërore, është një detyrim ndaj votuesve dhe reformave që duhet të konfirmojë në bashkëpunim me qeverinë "Berisha".

Zv/presidentja e PE, Roberta Angelilli deklaron se Edi Rama duhet të rilexojë raportin e publikuar në nëntor 2009 nga ky institucion, ku iu apeluar opozitës që të ndërpresë bojkotin dhe t'i drejtohet sallës së Kuvendit, pasi siç tha ajo, kemi vlerësuar progresin e Shqipërisë, ndërsa nuk ka pasur raportime të dyshimta mbi mënyrën e realizimit të procesit të zgjedhjeve.

"Në bazë të rezolutës së PE, u vlerësua progresi i Shqipërisë dhe njëherazi u cituan përmirësimet e kryera në kuadrin ligjor dhe administrativ për procesin e zgjedhjeve. Në të njëjtën kohë, Strasburgu i bëri thirrje opozitës që t'i japë fund bojkotit të Parlamentit, duke kërkuar prej saj, që të marrë përsipër detyrimin për të përfaqësuar zgjedhësit në parlament dhe të bashkëpunojë me qeverinë për çuarjen përpara të reformave",- tha Zëvendëspresidentja e PE, Angelilli.

Ajo thekso se bashkohet me deklaratat e bëra nga Joseph Daul, kryetar i Partisë Popullore Evropiane, i cili theksoi rolin e tij të rëndësishëm në monitorimin nga vëzhguesit ndërkombëtarë të zgjedhjeve të fund qershorit 2009 dhe njëherazi konkludoi se nuk ka asnjë raportim për manipulim të rezultatit apo parregullsi të procesit.

"Unë shpresoj që Partia Socialiste e Shqipërisë të ndjekë rrugën e duhur. Rruga e saj është ajo e rikthimit në Kuvend, për të punuar me qeverinë e zgjedhur në mënyrë demokratike nga qytetarët shqiptarë, në mënyrë që të sigurohen reformat e nevojshme për marrjen e statusit kandidat për anëtarësim në BE", përfundoi Zëvendëspresidentja e Parlamentit Evropian Roberta Angelilli.

BE, presion të ashpër për rikthimin e opozitës në Kuvend

"Shkelja e afateve Kushtetuese, djegie e sigurt e mandateve të PS"

Prej ditësh me radhë Bashkimi Evropian ka ashpërsuar gjuhën ndaj Partisë Socialiste dhe opozitës në tërësi. Trysnia e ndërkombëtarëve ka ardhur në rritje ditë pas dite, ndërsa po duket ende si një mision i pamundur, futja e opozitës në Kuvend, pas shpalljes së qëndrimeve që bien ndesh jo vetëm me ligjin, por edhe me Kushtetutën.

Bashkimi Evropian është shprehur disa herë nëpërmjet Presidencës së radhës spanjolle, për ndalimin e bojkotit dhe hyrjen në Kuvend, në tempullin e demokracisë, për t'u bërë pjesë e skemës së reformave dhe të progresit për afrimin e Shqipërisë në Union.

Christina Gallach, zëdhënësja e Presidencës spanjolle u shpreh se "Bashkimi Europian dhe Presidenca spanjolle është jashtëzakonisht e kënaqur për tryezën e dialogut që do zhvillohet të shtunën. Ne mendojmë dhe këtë e kemi shprehur në emër të të gjithë vendeve anëtare, se kjo tryezë është një rast që duhet kapur dhe duhet të përbëjë mbylljen e një kapitulli, e një situate që nuk mund të vazhdojë kështu. Një ngërç i tillë ka për Shqipërinë dhe qytetarët e saj, një kosto të madhe në jetën e përditshme dhe për marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Europian. Ne shpresojmë, se nga takimi i të shtunës do shohim një qëndrim të ri dhe një rezultat të ri", u shpreh ajo.

Gallach thotë se mungesa e dialogut e vështirëson procesin e integrimit të Shqipërisë në strukturat evropiane. Por, këto deklarata nuk po dëgjohen nga opozita dhe Edvin Rama.

Në të njëjtin qëndrim është shprehur edhe Parlamentit Evropian, përmes Presidentit Jerzy Buzek.

Zyrtari i lartë i PE, i kujton Ramës rezolutën e institucionit më të rëndësishëm të BE, miratuar nëntorin e vitit të shkuar, për progresin e Shqipërisë dhe vlerësimet për mbylljen me sukses të procesit të zgjedhjeve.

"Do të doja të inkurajoja të gjithë liderët politikë të Shqipërisë për tu angazhuar në dialog, me qëllim që t'i jepet fund ngecjes politike. Konsideroj të mirëpritur nismën e Presidentit Topi për të organizuar negociatat tryezë të rrumbullakët me krerët e qeverisë dhe opozitës në Tiranë dhe shpresoj që këto bisedime të çojë në zgjidhjen me sukses. Do të doja të inkurajoja liderët politikë të Shqipërisë për t'i dhënë fund ngecjes politike, të pushojë sa më parë bojkoti i parlamentit, dhe të ecet përpara me reformat e nevojshme dhe vijimin e axhendës së integrimit evropian, shprehet Buzek, duke shtuar se, pres me padurim të marr lajme inkurajuese nga Tirana".

Ndërkaq, edhe ambasadorët e BE të akreditуar në Tiranë, janë shprehur kundër bojkotit në të gjitha takimet që ata kanë zhvilluar me Ramën.

Ambasadorët e SHBA, BE dhe KE, përkatësisht, Withers, Montobio dhe Lohan, i kërkuan edhe në takimin e fundit Ramës, që t'i drejtohet pa kushte tryezës së thirrur nga Presidenti Topi dhe paralel më këtë të mos vonojë më hyrjen e opozitës në Kuvend.

Më i prerë në deklaratën e tij është ambasadori spanjoll, Emmanuel Montobio, vendi i të cilit udhëheq Presidencën e radhës të BE, i cili ka deklaruar qartazi se shkelja e afateve kushtetuese nga ana e opozitës, do të çojë në djegien e mandateve të deputetëve të dalë nga 28 qershori.

“Vatra” përkujton në Nju-Jork disidenten Musine Kokalari

Nga Beqir Sina

Nën patronazhin e Vatrës u përkujtua Musine Kokalari, me një përkujtim e nderim të jetës e veprës të, të gjitha grave shqiptare, në Shqipëri, Kosovë dhe nga të gjitha trojet etnike

Me rastin e përvjetorit të 93-të të lindjes së disidentes shqiptare Musine Kokalari dhe në përkujtim e nderim të jetës e veprës të të gjitha grave shqiptare, në Shqipëri, Kosovë dhe nga të gjitha trojet etnike, të cilat, kanë vuajtur dhe janë presekutuar nga regjime të ndryshme politike e sllavo komuniste, Federerata PanShqiptare e Amerikës VATRA, javën e kaluar zhvilloi një aktivitet përkujtimor. Në këtë veprimtari simbolike, studiues, drejtues shoqatash, veprimtarë e aktivistë të komunitetit, ish-gra të persekuturara gjatë regjimit të Enver Hoxhës në Shqipëri, dhe nga ato që e përjetuan gjenocidin serb, në Kosovë, është folur dhe diskutuar edhe lidhur me rolin e gruas në shoqëri dje dhe sot, dhe në veçanti lidhur me dhunën e ushtruar ndaj femrës në vitet e kaluara. Ky ishte aktiviteti i parë i kësaj natyre në komunitet, dhe u zhvillua në lokalin e njohur në Bronks - Nju Jork, „Restorantin East Wood-Manor“ - „qendër“, kjo e njohur tashmë në komunitet, për tubime, festime dhe aktivitet e tjera. Aktiviteti, u zhvillua nën përkujdesjen e shoqatës Vatra. Në këtë tubim gratë shqiptaro-amerikaneë patën rastin për të përkujtuar Musine Kokalirin, gruan e shquar të letrave dhe të politikës së kohës (anëtarët e familjes së saj në SHBA-së kanë qenë gjithashtu, bashkëthemeluesit e shoqatës patriotike Vatra), shoqatë kjo në Amerikë, e cila ia kushtoi gjithë veprimtarinë e saj në mërgim - pavarësisë dhe përparimit të Shqipërisë, Kosovës dhe të gjitha trojeve etnike. Kjo veprimtari u mbajt pasi përkonte edhe me 10 shkurtin, që do të shënonte 93-vjetorin e lindjes së Musine Kokalarit. Qasja nëpërmjet këtij aktiviteti përkujtimor i „gërshetuar“ edhe me rolin e gruas në shoqërinë shqiptare, dje dhe sot, u zhvillua në një kohë që „fatkeqësisht“ edhe askush nga institucionet e kulturës, shoqata e organizata në atdhe, nuk u kujtuan për të përkujtuar, të parën shkrimtare dhe politikane shqiptare, të parën femër me titull Doktore Shkencash në letërsi. Pikërisht, në një kohë kur në një luginë në rrëzë të malit të Dajtit, në veri rreth 15 km larg nga kryeqyteti i Shqipërisë - Tirana“, janë gjetur mbetjet e të burgosurve politikë të ekzekutuar me nga një plumb pas koke, gjatë regjimit komunist, dhe të hedhur anë disa gropa të futur në thasë plasmasi. Oratorët falenderuan Federatën Pan Shqiptare Vatra, për mundësinë që u ofroi në realizimin e kësaj veprimtarie si kryetarin e kësaj organizate Ing. Agim Karagjozi, dy nën/kryetarët; Dr. Gjon Buçaj e Agim Rexhaj, anëtarët e kryesisë zotërinjtë Zef Balaj e Zef Përndocaj, Editorin e gazetës Dielli, z Dalip Greca, Dr. Nexhat Kaliçi, regjisorin Nuhi Destani, Zonjat Merita Shkupi, Rita Saliu, Merita Bajraktari McCormack, Mjafturie Daci, Aida Dismondy, Xhemile Greca e Lena Kataliç, si edhe gazetat „Dielli“, „Iliria“ e „Bota Sot“, të cilat i dhanë jehonë falas kësaj veprimtarie. Në fillim të kësaj veprimtarie është shfaqur edhe një film dokumentar i realizuar nga regjisori Nuhi Destani Dr. Nexhat Kaliçi dhe i sponsorizuar nga shoqata Vatra. Në këtë dokumentar flitej mbi represionin serb mbi gruan shqiptare në Kosovë, gjatë sundimit serb. Njëheresh ky tubim sipas organizatorve ishte edhe një reagim proteste ndaj Gjykatës Kushtetuese në Shqipëri, e cila pak ditë më parë rrëzoi ligjin e Lustracionit, për krimet e komunizmit në Shqipëri, aq më tepër kur atje sapo u zbulua në malin e Dajtit, një varrez masive me mbetjet e të 19 personave të pushkatuar nga rregjimi komunist, gjatë peruidhës 1944-1990.

Në diskutime folën gra e vajza që kanë kryer studimet univesitare në Shqipëri apo në SHBA, studiues, e personalitete të njohura të komunitetit, çka do të krijonte edhe përshtypejn e zhvillimit të një „simpoziumi të vogël“. Fjala përshëndetëse u mbajt nga nën/kryetari i shoqatës Vatra, dr. Gjon Buçaj. Zonja Merita Shkupi mbajti një kumtesë të gjatë kushtuar jetës dhe veprës së Musine Kokalarit. Ndërsa, zonja Rita Saliu mbajti kumtesën „Gjenocidi serb në Kosovë“, shikuar në fokusin mbi gjenocidin ndaj femrës shqiptare në Kosovë, gjatë sundimit serbo-sllav. Aktiviteti u tha se është zhvilluar duke marrë shkas nga seanca dëgjimore që Kongresi Amerikan zhvilluar disa ditë më parë me protagonistët kundra dhunës ndaj grave, dhe vendimeve serioze që u parashtruan aty për masat e parandalimit të saj. Të pranishme në seancën e Uashingtonit, ishin gjithashtu Ambasadorja për çështjet Globale të Grave në Departamentin e Shtetit Melanie Verner, si dhe aktorja amerikane Nicole Kidman. Ndërsa në fund të aktivitetit me rastin e përvjetorit të 93-të lindjes së disidentes shqiptare Musine Kokalari dhe në përkujtim e nderim të jetës e veprës të, të gjitha grave shqiptare, në Shqipëri, Kosovë dhe nga të gjitha trojet etnike, të cilat, kanë vuajtur dhe janë persekutuar nga regjime të ndryshme politike e sllavo-komuniste, organizuar nga Federerata PanShqiptare e Amerikës VATRA, dhe shoqatat e grave, kishte edhe diskutime të hapura nga gra ish-të persekutuara politike, apo regjime të ndryshme në trevat shqiptare. Pati edhe recitime poezish kushtuar femrës shqiptare nga poezi të artistes Justina Aliaj si dhe u kënduan këngë popullore nga të gjitha trevat prej kengëtares së mirënjohur Merita Halili, nën drejtimin e mjeshtrit të firzamonikës Raif Hyseni.

Cirku i Edit për „hapjen e kutive“

Nga Behar Sadiku

„Cirku do të luajë, apo jo“. Ky ka qenë titulli i një filmi çek të shfaqur në vendin tonë gati para tre dekadave, dhe që nuk e di pse më sjell ndërmend tërë këtë 6-mujor, kur në mediat tona amplifikohet nga mëngjesi deri në darkë refreni i shokut Edi, që aksidentalisht i ka ndodhur të jetë në pozitën e mbishpinësit të Opozitës. A thua se vendi ynë i ka zgjidhur të gjitha hallet dhe tashmë nuk ka me se të merret, e sa të kruajë dhëmbët a të luajë derën po merret me këtë „cirkusin e Edit për hapjen e kutive“. Që Shqipëria, një vend tashmë i anëtarësuar me të drejta të plota në NATO dhe që pret të aderojë me shpejtësi në Bashkimin Europian (dhe gjasat janë mjaft të mira), kërkon ta zhvendosë vëmendjen e mbi tre milionë e gjysëm shqiptarëve në gjëagjëza folklorike e të pavlera, vetëm e vetëm për të „forcuar“ alibinë e humbjes totale në zgjedhje, si rezultat i një vizioni krejt të turbullt, shterran e dështak. Të marrësh e të shkarkosh barrën nga supet e tua dhe t’ia lësh „kopilin në derë“ dikujt tjetër nuk është kushedi se çfarë. Por të marrësh aventura të tilla për të gjymtuar fatin dhe ardhmërinë e vendit, kjo natyrisht është sa e turpshme aq dhe e dënueshme. „Casus belli“ që ti ke zgjedhur: problemi i ndershmërisë në votime është diçka që qëndron shumë larg moralit dhe veprimtarisë tënde në favor të kësaj çështje. Votimet e lira dhe zgjedhjet e ndershme janë siguri treguesit më të rëndësishëm të „abc“-së së demokratizimit të shoqërisë dhe shtetit demokratik shqiptar. Standardet që janë arritur deri më tash, por edhe ato të pritshmet (që kërkohen të arrihen) në pjesën e tyre kockore janë ngjizur mirë dhe tregojnë që klasa jonë politike brenda një periudhe jashtëzakonisht të shkurtër kohore (as dy dekada!) ka arritur të paraqitet me një dinjitet të pëlqyeshëm edhe në eksponatet e Europës, me tradita shekullore në këtë lëmë.

Partitë politike në Shqipëri dhe dy liderët kryesorë të kësaj epoke, zotërinjtë Berisha e Nano, ku më shumë e ku më pak kanë qenë në rendin e atyre njerëzve që kanë treguar se dijnë të punojnë e të implementojnë arritjet pozitive dhe eksperiencën e vendeve me kulturë demokratike, e për rrjedhojë edhe shkalla e zhvillimit të këtij treguesi ka pësuar në pjesën më të madhe të lëvizjes një dukuri pozitive me një ngritje të paimagjinueshme.

Nuk duhet të harrojmë se Shqipëria erdhi nga post-diktatura më çnjerëzore që ka njohur Europa Lindore, ku zgjedhjet ishin elementi më i „pështirë“, ku diktatori ishte fitimtar me 99.99 përqind, paçka se ishin me dhjetëra mijra të burgosurit politikë, të internuarit e të pushkatuarit. Nuk duhet të harrojmë se ne pushkatuam në vitin 46 jo thjesht „grupin e deputetëve“ por lirinë e të drejtën për të menduar e vepruar ndryshe.

Por pse shqetësohet atëhere shoku Edi Rama - dhe tok me të disa kanarina të kafazit të tij, të katapultuar për të qenë „të zgjedhur“? A e dinë ato të vërtetën e njeriut që kanë në krahë, nëse ai është „as“ apo „pras“ i lirisë dhe duarve të pastra në zgjedhje Pse në Partinë Socialiste grupi „Lëvizja për Mendimin Ndryshe“ nuk është në të njëjtin akord? A mos vallë shoku Edi është më socialist se socialistët, më i devotshëm se ata që e ngritën këtë parti nga hiri dhe e shndërruan në një forcë të vërtetë politike me vizion demokratik. Natyrisht që jo. Edhe Edi e di këtë gjë po kaq mirë, bile edhe më shumë se unë apo të tjerët. Atij pak i dhimbset Partia (për të mos thënë aspak!), por shumë i dhimbset ardhmëria e tij e përhumbur gjithsesi. Kjo është e vërteta dhe aspak ndryshe. Por fakti është që ajo ekziston dhe nuk ke si ta bishtnosh.

A nuk është vallë shoku Edi dhe skota e manipulatorëve të përgatitur prej tij që vodhi ditën për diell, m’u në sy të kryeqytetit të shqiptarëve votat e popullit kryeqytetas. A nuk ishte ky shok që i tjetërsoi në mënyrën më të pabesueshme rezultatet e zgjedhjeve të vitit 2003 për kryetarin e Bashkisë së Tiranës. Nuk e kemi harruar besoj. Por edhe nëse dikush nga „deputetët“ e Edit ka qenë në një moshë miturane dhe nuk ka dijenitë e duhura për këtë shkak, mund t’i kujtoj disa nga „bëmat“ e usta Edit. Fjala bie, nga 400 vota të gjendura në kuti shoku Edi kishte „fituar“ në procesverbal 700 vota të vlefshme për kryetar. Aq të mëdhaja e të „hatashme“ ishin vjedhjet e këtij shoku, saqë as KQZ-ja (që ky e kishte të „vetën“) nuk ia mbylli dot të gjitha pocaqëritë. Eh more shoku Edi, sa i zoti u tregove! Vodhi e falsifikoi falanga e „pionierëve të bashkisë“ që i kishe përgatitur me zell ti. Çfarë nuk bëtë në ato të gjora kuti, i kthyet në kuti-Pandore… aq saqë Gjykata Zgjedhore nuk pat se nga t’ia mbajë, por urdhëroi përsëritjen në mbi 30% të gjithë qendrave të votimit.

Të kujtohet shoku Edi, se këto nuk janë gjëra që fshihen me një „të rënë“ të furçës! Nuk e kuptoi se si mund të flasë për moralin zgjedhor një njeri që është treguar me të gjithë forcën dhe egërsinë si varrmihës dhe shnderues i tyre.

Ja këto më erdhën ndër mend kur të pashë duke „mbajtur leksione morali për votën e lirë“. Nuk jam vonë që po të them sot pas gjashtë muajve. Në rastin e parë thashë : e po le të justifikohet mavriu para të tijve. Nuk u dha vërtet fitoren, por ia ka zgjedhur rrugën që t’ua bëjë më të butë humbjen. Por kur edhe sot, pas gjysmë viti ti vazhdon të çirresh e të bërtasësh se „të dhemb“ ajo që ty as që ta ndjen, kjo jo vetëm që më dëshpëron, por natyrshëm dhe më revolton. Ti të paktën duhet të heshtësh kur bëhet fjalë për votën e lirë. Ti i përket atij klani që edhe pse i paktë numerikisht, treguat me prova tw gjalla se e përdhunuat dhe e lënduat keq atë. Hiq dorë nga „cirku“. Kutitë nuk mund të hapen dhe ti e di më mirë se kushdo tjetër këtë gjë.

“Kaq për sot”, historia e një takimi me diversione

Nga Lavdrim Lita

Gjithçka e pritshme. Pritshmëria për këtë takim ka qenë i lartë, pasi pritej një rifillim i dialogut që mungon prej kohësh. Takimi midis palëve politike në tryezën e presidentit Topi pati si qëllim rivendosjen e kontakteve ballëpërballë të liderëve të PD dhe PS, dy prej partive më të mëdha në vend. „Kaq për sot“ - kështu janë ndarë liderët e politikës shqiptare. Ndërsa për publikun këto bisedime sollën lajmin se do të vijohet akoma me bisedime në ditët në vazhdim, pasi ky takim ishte më shumë njohës sesa përmbyllës. Siç ishte e kuptueshme letra e të dy palëve nuk u zbuluan krejt, edhe asi nën mëngë i presidentit Topi mbeti mister.

Sa për kronikë duhet thënë se kjo tryezë ishte fryt i përpjekjeve të përfaqësive të huaja në Tiranë, veçanërisht asaj të SHBA-së. Këshillit të Evropës nga ana tjetër, iu desh të miratonte një rezolutë, ku janë dhënë rekomandime për zgjidhjen e „ngërçit“ politik në vend. Ambasadorët e akreditуar në Tiranë, u kanë bërë apel forcave politike të angazhohen për kapërcimin e „ngërçit“ politik dhe të marrin parasysh të gjithë pasojat që sjell mos prania e opozitës në Parlament. Kuptohet vetiu se përpjekjet e tyre patën një reflektim në klasën politike, si nga ana e maxhorancës po ashtu edhe nga lodhja në rrugë e opozitës. Natyrisht me i qetë në këtë takim u pa të ishte kryeministri Berisha, i fortë në pozicionin që i japin vendimet e drejta të gjykatave. Një vendim gjykate sipas Kushtetutës nuk paragjykohet, vetëm pranohet. Kurse Edi Rama u pa të ishte në vështirësi, duke parë se presidenti Topi nuk përmendi në asnjë moment diversionin e memorandumit zyrtar të PS, që u soll me media pak minuta para se të fillonin negociatat. Ky takim i parë pati një rezultat, pasi qëllimi i pathënë kësaj tryeze për ndërkombëtarët ishte të sillte në binarët e politikës së vërtetë opozitën, duke e larguar nga pozicionet ekstraparlamentare. Orvatjet e paprincipta të „politikës së re“ nuk sollën shpërblimin e bojkotit në tryezë. Gjithashtu në këto negociata u pa profili i ulët i Edi Ramës, ngase sajesa e kutive të votimit as që u mor parasysh në tavolinën e presidentit Topi. Ndërsa edhe kryetari i PD, Sali Berisha e likuidoi problemin me frazën lakonike „Unë nuk kërkoj të trajtoj probleme që kanë të bëjnë me gjykatën“. Pra, kufiri i bisedimeve është i qartë për të gjithë, kemi bashkëbisedime të hapura për çdo gjë, përpos për gjëra që cenojnë ndarjen dhe integritetin pushteteve në demokratike. Afati ultimativ i ditës 7 marsi është një limit deri se kur mund të shkojnë bisedimet; por është e qartë se Edi Rama kërkon të arkivojë bojkotin përpara se LMN të vendosë hyrjen në parlament. Një hyrje e disa deputetëve të PS në parlament do të thoshte një pozicion i dobët në tryezën e bisedimeve në krahasim me solidifikimin e pozicioneve të maxhorancës.

Ndërkaq „qëndresa“ didaskalike e Edi Ramës në konferencë për shtyp - pas tryezës - ishte një tjetër diversion për t’u thënë militantëve dhe deputetëve se nuk po bëj pazare, por po vendos themelet e fitores së ardhshme. Mjerisht kjo qëndresë është në kundërshtim të plotë me aspiratat e shqiptarëve për një cilësi të demokracisë në vend, ç’ka do të përshpejtonte afatin e hyrjes në BE. Gjithsesi data 22 shkurt mund të jetë një datë optimale për arritjen e një kompromisi. Prania në këto ditë e reportereve të Parlamentit Europian do të jetë një shtysë që palët të gjejnë një pikë kontakti për sa i përket përmirësimeve të Kodit zgjedhor që duhet të dalin nga komisioni hetimor parlamentar i krijuar posaçërisht për këtë temë.

Bugajski: SHBA–ja të përfshihet në planin për zbatimin e strategjisë për veriun

„Gjatë dy viteve të kaluara, prej shpalljes së pavarësisë, në Kosovë ka pasur disa suksese, por edhe mangësi“, thotë analisti Janush Bugajski, nga Qendra për studime strategjike dhe ndërkombëtare në Uashington

Brenda disa ditësh, Kosova e shënon dyvjetorin e pavarësisë. Si e vlerësoni ju punën e bërë gjatë kësaj periudhe nga institucionet?

Mendoj se nëse shikojmë prapa, është një fotografi e përzier; ka pasur disa suksese, por edhe mangësi. Sukses është se 65 vende e kanë njohur Kosovën, Kushtetuta është miratuar, janë mbajtur zgjedhjet lokale, që përgjithësisht konsiderohen të lira dhe korrekte, si dhe të organizuara mirë. Pra, në këtë kuptim ka qenë e suksesshme. Megjithatë, do të thosha se dikush ka pritur se Kosovën do ta njihnin më shumë vende deri tash, pasi çështja e njohjeve e pengon Kosovën për të hyrë në institucionet ndërkombëtare, megjithëqë ka pasur sukses në anëtarësimin në Bankën Botërore dhe në Fondin Monetar Ndërkombëtar. Por, ende është një rrugë e gjatë para Kosovës për t'u bërë anëtare e organizatave të tjera kryesore ndërkombëtare. Mirëpo, do të theksoja se para Kosovës gjenden disa prova të madhore, që do ta çonin procesin përpara, përfshirë, natyrisht, zgjedhjet më vonë këtë vit.

Njëra nga sfidat e mëdha, sipas analistëve, është situata në veri. Në këtë aspekt, institucionet e Kosovës dhe ICO-ja po punojnë në strategjinë për veriun, me qëllim të integrimit të kësaj pjese në institucionet e Kosovës. Si i shihni zhvillimet në këtë situatë?

Kjo është shumë e rëndësishme. Pas takimeve dhe deklaratave aktuale, nga anëtarët e Qeverisë së Kosovës dhe të trupës monitoruese ndërkombëtare, duket se ekziston përkushtim i ripërtërirë për integrimin e pjesës veriore të Kosovës në institucionet e vendit dhe, njëherësh, të çohet përpara procesi i eliminimit të institucioneve paralele, që e shkatërrojnë autoritetin e Qeverisë në Prishtinë. Pyetja është se si do të implementohet kjo? Me fjalë të tjera, supozohet se nuk do të përdoret forca, por duhet të ketë stimulime në stilin e „shkopit dhe karotës“. Pra, duhet përpjekur për t'i bindur njerëzit në pjesën veriore, që të mos marrin pjesë në zgjedhjet e Serbisë, por të marrin pjesë në zgjedhjet e Kosovës, në mënyrë që pastaj autoritetet lokale të jenë pjesë e strukturës shtetërore kosovare. Nuk do të jetë lehtë. Do të jetë i nevojshëm angazhimi i fuqive botërore dhe i komunitetit ndërkombëtar. Mendoj se edhe Shtetet e Bashkuara, po ashtu, duhet të jenë shumë të involvuara.

NATO-ja po i redukton trupat që shërbejnë në Kosovë, në kuadër të KFOR-it. Si e lexoni ju këtë reduktim të trupave në këtë situatë?

Në disa mënyra. Ju mund të argumentoni se është mirë dhe se tregon se Kosova po bën progres. Para së gjithash, trupat ishin vendosur atje për ta parandaluar dhunën ndëretnike. Ne kemi shumë pak dhunë ndëretnike gjatë dy viteve të kaluara. Megjithëqë janë disa tensione, veçanërisht në enklava dhe me disa nga anëtarët më radikalë të pakicës serbe, nuk ka pasur kurrfarë ripërtëritje të dhunës dhe kjo paraqet një plus; kjo është pozitive. Megjithatë, mendoj se, nëse me të vërtetë pjesa veriore e vendit do të përfshihet në institucionet e Kosovës, NATO-ja duhet të jetë e përgatitur për çfarëdo reagimi nga ana e disa elementëve më radikale në veri.

Në zgjedhjet e fundit lokale në Kosovë, që i përmendët, serbët në pjesën qendrore të Kosovës, ishin pjesë e zgjedhjeve, duke i injoruar rekomandimet nga Beogradi për të mos marrë pjesë, por serbët në veri i bojkotuan zgjedhjet. A mendoni se ekziston një ndarje e thellë ndërmjet serbëve, lidhur me çështjen e integrimit në shoqërinë kosovare?

Po, mendoj se ka ndarje ndërmjet atyre që e kuptojnë se e ardhmja e tyre është në Kosovën e pavarur dhe të atyre në veri, që ende mendojnë në kuptimin e mundësisë së ndarjes së Kosovës. Për këtë arsye mendoj se mund të jemi dëshmitarë të disa konflikteve ndërmjet komunitetit serb, ose ndërmjet liderëve politikë serbë, sa i përket së ardhmes. Për këtë arsye mendoj se EULEX-si dhe Shtetet e Bashkuara duhet të përpiqen ta bindin Serbinë, që ajo ta shkëpusë vetveten, sa më shumë që të jetë e mundur, nga çfarëdo institucioni paralel në veri, pasi kjo nuk është e dëmshme vetëm për Kosovën, por është e dëmshme edhe për Serbinë.

U përmend se deri tash Kosovën e kanë njohur 65 shtete. Sipas jush, ky numër a është i mjaftueshëm, apo i vogël?

Kjo paraqet një të tretën e vendeve të botës. Mund të imagjinoj se pas dy vitesh numri do ta kalojë gjysmën e vendeve në botë. Por, siç thashë, duhet të bëhet ende punë e madhe për t'i bindur më shumë vende, veçanërisht në botën myslimane, por edhe shumë vende në zhvillim, që ndoshta janë në situatë të ngjashme me Kosovën, për ta kuptuar se Kosova është shtet i ri dhe se do të mbetet shtet i ri, prandaj opsioni më i mirë do të ishte që të njihet dhe të vendosen marrëdhënie diplomatike.

Në fund të kësaj interviste një pyetje lidhur me liberalizimin e vizave me Bashkimin Evropian. Serbia, Maqedonia dhe Mali i Zi tash udhëtojnë pa viza, ndërsa Kosova, Shqipëria dhe Bosnjë Hercegovina, jo. A e shihni ndonjë mundësi që, së shpejti, edhe për këto tri vende do të bëhet liberalizimi?

Mendoj se përfundimisht i gjithë Ballkani Perëndimor do ta ketë këtë liberalizim. Çështja është që të kemi shtete funksionale dhe stabile, që janë ndërkombëtarisht të pranuara, që BE-ja nuk i konsideron kërcënim njerëzit e këtyre vendeve kur ata udhëtojnë në shtetet e Bashkimit Evropian. Mendoj se liberalizimi do të ndodhë. Në këtë aspekt, vendet që i përmendët, janë me popullatë shumicë myslimane dhe për këtë arsye nuk duhet të ketë pengesa fetare dhe kulturore të çfarëdo lloji. Për këtë arsye, është e rëndësishme për Evropën, që të tri vendet të përfshihen në procesin e liberalizimit.

ANTA

ANTA(Agjensia Nacionale e Trafikut Ajror)

ANTA(Agjensia Nacionale e Trafikut Ajror) me zyra prane Aeroportit „Nene Tereza“ kerkon kandidate per Kontrollor te Trafikut Ajror.

Kerkesat paraprake per t'u plotesuar nga kandidatet jane:

1. Mosha te jete mbi 18 vjec dhe jo me shume se 25.
2. Te kene mbaruar te pakten arsimin e mesem me rezultate mbi 9-te sidomos ne subjektet e shkencave ekzakte.
3. Gjuha angleze (e folur dhe e shkruar)te jete te pakten mbi nivelin mesatar(Upper- Intermediate)
4. Certifikate mjekesore.
5. Te mos kete asnje precedent penal

Dokumentet qe duhen paraqitur :

1. CV(Curriculum Vitae) me fotografi.
2. Certifikate personale nga gjendja civile.
3. Fotokopje e Kartes se Identitetit
4. Fotokopje e noterizuar e Diplomes ose Defteses se Pjekurise se bashku me listen e notave.
5. Fotokopje e noterizuar e deshmise se gjuhes angleze ose vertetim qe ka studiuar anglisht ne shkollen e mesme / larte (dokument i leshuar nga Fakulteti)
6. Certifikate mjekesore ku te vertetohet qe nuk ka probleme me shikimin, me degjimin dhe me sistemin nervor.
7. Deshmi penaliteti nga Prokuroria dhe Min. Drejtesise
8. 1(nje) fotografi.

Afati i dorezimit te dokumenteve eshte data 30/04/2010.

Dokumentet duhet te dorezohen personalisht pasi kandidatet duhet te plotesojne formularin e aplikimit ne adresen:

ANTA
Aeroporti Nene Tereza
Rinas
Departamenti i Burimeve Njerezore
Sektori i Trajnimeve
T: (4) 2379225

Infood

INFOOD SH.P.K.

CILËSIA, PRIORITETI YNË

"Infood" është një kompani e re tregtare me kapital gjerman, e ngritur mbi eksperiencën, cilësinë, përkushtimin dhe historikun e paraardhëses D.W.M. Produktet që kjo Kompani sjell në tregun shqiptar përbëjnë një veçori për konsumatorin. „Infood" është e vetmja kompani që importon ekskluzivisht produkte ushqimore gjermane të një cilësie të lartë, të mirënjohura prej njëzet vitesh nga konsumatori shqiptar. Kjo kompani ka përfaqësinë e një sërë firmash të njohura në botë, si Kampina, Warsteiner, Arla Food, Krüger etj.

Reshjet krijojnë probleme në disa komuna të vendit

Vështirësohet qarkullimi i automjeteve në akset kryesore

Reshjet e shiut dhe të borës, të cilat kanë përf shirë vendin tonë gjatë ditëve të fundit, kanë krijuar situatë të vështirë në disa qytete dhe komuna. Për pasojë, edhe qarkullimi i automjeteve në akset kryesore të vendit, ka qenë më i vështirë se zakonisht. Kjo edhe për shkak të ngricave të krijuara në pjesë të ndryshme të akseve rrugore. Më poshtë, po paraqesim zonat më problematike dhe masat e marra për përmirësimin e lëvizjeve të automjeteve. Ndërkohë, Ministria e Transporteve ka sqaruar gjithë drejtuesit e mjeteve në lidhje me situatën e rrugëve si pasojë e reshjeve. Ministria sqaron se si pasojë e reshjeve të shumta të dëborës në pjesën veriore, veri –lindore dhe lindore të vendit janë shkaktuar herë pas here bllokime të përkohshme të rrugëve. Sipas njoftimit, rrugët ku është e nevojshme të mbahen zinxhirë janë, aksi Qafë Mali-Shllak dhe Qafë Mali Fier, Kukës-Shishtavec, Rrëshen-Kurbnesh dhe Rrëshen – Qafë Benjë, Qafë Kërrabë, Qafa e Llogorasë dhe Qafë e Shtamës. Ndërkohë që janë të bllokuar dhe të pakalueshme, si pasojë e dëborës: Fushë Arrëz –Iballë, Kukës Shishtavec qarkullohet më zinxhirë në 5 km e fundit, Ostren i Vogël –Klejn –Steble, Kurbnesh –Lurë dhe Dajt-Qafë Mollë. Gjithashtu dhe hyrja e autostradës Fier-Lushnjë vazhdon të jetë e bllokuar si pasojë e ujërat te kthesa në Vajkan. Kalimi në këtë aks është i mundur vetëm për mjetet e mëdha ndërkohë që kalimi për veturat bëhet nga rruga e vjetër.

Qarku Shkodër: Në Qarkun e Shkodrës ka patur reshje shiu, me intervale. Në lartësitë mbi 600 m ka patur reshje dëbore. Në rrethin e Pukës ka patur reshje bore. Me vështirësi kalohet rruga Qafë Mali-Fierzë, pasi në këtë aks trashësia e borës ka arritur deri në 40 cm, në orët e para të mëngjesit ka patur edhe ngrica. Në këtë aks rrugor, nga efektivat e qarkullimit rrugor lejohet të qarkullojnë vetëm mjetet e vogla dhe me zinxhirë, ndërsa mjetet e rënda janë bllokuar për shkak të sigurisë në rrugë. Komuna e Iballës është bllokuar përsëri nga reshjet e borës. Drejtoria Rajonale Rrugëve vazhdon hedhjen e kripës dhe skorjeve, për të mundësuar kalimin normal të automjeteve në të gjithë akset rrugore. Nga Shkodra për në Dukagjin qarkullohet nga Mali i Shoshit, por me vështirësi dhe me zinxhirë.

Qarku Lezhë: Aktualisht situata paraqitet normale, pa probleme. Në rrethin e Mirditës, ka patur reshje shiu dhe situata rrugore është përmirësuar ndjeshëm. Nuk ka asnjë rrugë të bllokuar.

Qarku Kukës: Në rrethin e Kukësit ka patur reshje të dobëta shiu, dhe në lartësitë mbi 400 reshje bore, pa ngrica, për rrjedhojë nuk ka akse rrugorë të bllokuar. Në aksin rrugor Qafë Mali-Qafë Shllak, trashësia e borës ka arritur në 40 cm, por në disa lugina edhe më tepër për shkak të grumbullimit të borës nga era. Në këtë aks kalohet me vështirësi dhe me zinxhirë. Qarkullimi lejohet vetëm për mjetet e vogla, ndërsa trajlerat janë ndaluar prej efektivave të qarkullimit rrugor. Në këtë qark Komuna e Arrnit vazhdon të jetë e bllokuar. Në drejtim të komunave Grykë Çaj, Bushtricë, Zapod dhe Lekbibaj, qarkullohet me vështirësi dhe në segmente të veçanta për shkak të ngricave, me zinxhirë.

Qarku Dibër: Edhe në këtë qark ka patur reshje të pakta bore. Reshje bore më intesive ka patur në rrethin e Bulqizës. Në qytetin e Bulqizës trashësia e borës ka arritur 15 cm, ndërsa në zonat rurale ka shkuar deri në 30cm. Efektivat e Qarkullimit rrugor dhe Drejtoria Rajonale Rrugëve kanë punuar në vazhdimësi dhe rrugët janë të gjitha të kalueshme, por në segmente të veçanta me zinxhirë. Rruga që lidh Peshkopinë me Lurën, vazhdon ende e bllokuar, por lidhja e Komunës Lurë realizohet me vështirësi, nëpërmjet Kurbneshit. Në të gjithë territorin e Qarkut, përveç komunës së Trebishtit, e cila është bllokuar dje në mëngjes për shkak të borës së rënë me intensitet të lartë, komuna të tjera nuk ka të bllokuara. Në të gjithë qarkun gjatë dy ditëve ka patur reshje të dobëta shiu dhe në lartësitë mbi 400 m, reshje të dobëta bore.

Qarku Korçë: Në të gjithë Qarkun e Korçës ka patur reshje bore. Në qytetin e Korçës lartësia e borës është deri në 15 cm. Forcat dhe mjetet e Drejtorisë Rajonale të Rrugëve dhe të Policisë së Qarkullimit Rrugor janë në gatishmëri të lartë dhe në inspektim të vazhdueshëm. Nuk ka patur probleme shqetësuese apo akse rrugorë të bllokuar. Dje rreth orës 2040, në rrugën Pogradec-Qafë Plloçë, pak para lartësisë maksimale, rrëshqiti një masiv dheu nga skarpata e sipërme e rrugës dhe për pasojë u bllokua kalimi i mjeteve për rreth 2 orë. Subjekti kontraktor mundësoi heqjen e dheut dhe aktualisht po qarkullohet me një kalim. Në ndihmë të saj ka shkuar edhe një ekskavator i Bordit të Kullimit dhe mendohet që pas dite rruga të hapet plotësisht. Aksi rrugor Voskopojë-Lekas përsëri u bllokua nga reshjet e borës. Për shkak të temperaturave tepër të ulëta do të vështirësohet hapja e rrugës sepse bora është e ngrirë.

Qarku Elbasan: Të premten, iu kërkua Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, mbështetje me një fadromë, kërkesë që u plotësua menjëherë dhe dje në orët e para të mëngjesit fadroma mbërriti në Librazhd dhe filloi nga puna për hapjen e rrugës për në fshatin Qarishtë, të Komunës Qendër. Të bllokuar nga bora janë fshati Polis dhe Vilan, Komuna Polis dhe fshati Skënderbej në Komunën Rrajcë, në rrethin e Librazhdit. Inspektori EC të qarkut së bashku me Kryetarin e Komunës, shkuan në vendngjarje dhe familjarët e dy banesave të dëmtuara u strehuan përkohësisht tek të afërmit e tyre. Nga Qarku kërkohet te kryhet një studim nga një ekip gjeologo-inxhinierik i Shërbimit Gjeologjik, në lidhje me qëndrueshmërinë e formacioneve gjeologjike të tokës.

Qarku Gjirokastër: Të premten, nga një rrëshqitje dheu u bllokua rruga Tepelenë-Gjirokastër, në afërsi me Urën e Subashit, por ndërhyrja e shpejtë e Drejtorisë Rajonale të Rrugëve, bëri të mundur që rruga të hapej pas 30 minutash.

Parashikimi i kushteve të motit

Gjatë ditës së sotme, do të kemi përsëri mot me vranësira dhe reshje shiu të pakta. Në lartësitë mbi 400 m do të kemi reshje bore. Nuk do të mungojnë edhe kthjellimet e përkohshme. Temperaturat ekstreme, pritet të luhaten: minimalja në zonat malore do të arrijnë deri në -20C, ndërsa temperatura maksimale do të regjistrohet në zonën e ulët, deri në 14 0C. Ndërsa, gjatë ditës së nesërme, në të gjithë territorin e vendit do të kemi mot me vranësira dhe kthjellime të përkohshme. Vranësirat do të shoqërohen me shira të dobët lokalë. Në lartësitë mbi 600 m, reshjet do të jenë në formë dëbore. Temperatura minimale do të arrijë deri në -20C. Në datat 16, 17 dhe 18 Shkurt 2010, pritet të mbizotërojë mot i paqëndrueshëm me vranësira dhe reshje shiu, por edhe me kthjellime të përkohshme Në lartësitë mbi 600 m, reshjet do të jenë në formë dëbore. Sasia maksimale e reshjeve do të jetë deri në 25 mm. Temperaturat ekstreme do të jenë pa ndryshime të ndjeshme.

Krizat e zemrës, 3 herë më të shpeshta në mot të ftohtë

Tkurrja e enëve të gjakut, spazma dhe faktorët të cilët ndikojnë në rritjen e tensionit të shkaktuara nga temperaturat e ulëta shtojnë dhe më shumë rrezikun e krizave të zemrës. Krizat e zemrës shfaqen dy-tre herë më shumë gjatë muajve të dimrit sesa në muajt e verës dhe janë vdekjeprurëse. Duhet të tregohemi shumë të kujdesshëm veçanërisht në orët e para të mëngjesit gjatë muajve të dimrit. Ai shpjegon faktorët të cilët ndikojnë në shtimin e rasteve të krizave të zemrës gjatë muajit të dimrit në krahasim me stinët e tjera. Infeksionet e rrugëve të frymëmarrjes, gripi, konsumimi i kalorive të tepërta të cilat përmbajnë yndyrna dhe mosdjegia e tyre, disa ndryshime hormonale për shkak të mosmarrjes së mjaftueshme të rrezeve të diellit, stresi i shkaktuar nga qëndrimi në ambiente të mbyllura. Faktorët që ndikojnë në rritjen e tensionit, tkurrjen e enëve të gjakut, spazmën të shkaktuara nga moti i ftohtë rrisin më shumë rrezikun e shfaqjes së krizave të zemrës. Në kohë të ftohtë trupi për të ruajtur temperaturën e tij dërgon më pak gjak në lëkurë dhe kjo shkakton tkurrje tek të gjithë enët e gjakut veçanërisht në damarët të cilët ushqejnë lëkurën. Kjo lloj tkurrjeje bëhet shkak për rritjen e tensionit. Krizat, ataket e zemrës ndodhin më shumë gjatë orëve të para të mëngjesit. Për këtë ndikojnë shumë gjëra si ndryshimi i rrjedhjes së gjakut, faktorët hormonalë, tension më i lartë. Mëngjeset e bardha të mbuluara me borë, me diell, të ngjallin ndjenjën e freskisë, mund të shkaktojnë veçanërisht bllokim të damarëve dhe të rrisin më shumë faktorët e riskut. Kjo është koha më e rrezikshme për personat të cilët kanë tension të lartë. Shumë studime çuditërisht kanë vërtetuar se personat të cilët kanë dalë jashtë në mëngjes pas një mbrëmjeje me borë dhe kanë bërë lëvizje të shpejta si pastrimi i xhamave të makinës nga dëbora apo kanë pastruar pjesën para shtëpisë kanë kaluar kriza zemre. Pastrimi i dëborës, hapja e rrugës apo pastrimi i xhamave të makinës në të njëjtën kohë është një ushtrim i vështirë i cili rrit tensionin.

Disa këshilla për të ulur riskun e krizave të zemrës gjatë dimrit:

- Nëse vuani nga zemra apo tensioni merrini rregullisht ilaçet.
- Punën e pastrimit të dëborës veçanërisht në mëngjesin e pare me dëborë bëjeni dalëngadalë duke pushuar; nëse është e mundur mos e bëni fare.
- Për të bërë ushtrimet fizike në vend që të dilni jashtë në ajër të ftohtë mund t'i zhvilloni brenda në shtëpi apo sallone sporti. Ambientet e mbyllura dhe të mëdhenj si p.sh. qendrat tregtare janë ambiente të përshtatshme për të bërë një ecje 30 minuta.
- Infeksionet, veçanërisht infeksionet e rrugëve të sipërme respiratore shihen shumë tek të sëmurët me zemër dhe ndikojnë në funksionimin e saj. Ecjen apo ushtrimet që do të bëni në qendrat tregtare bëjini më mirë në oraret kur nuk ka shumë njerëz për t'u mbrojtur nga infeksionet.
- Bëni vaksinat e gripit dhe të pneumonisë.
- Nëse keni kaluar një krizë zemre mos dilni jashtë dhe mos qëndroni në një ambient me tym, të pistë dhe në ajër të ftohtë. Nëse e keni të detyrueshme të dilni mos harroni të merrni me vete dhe hapin e nëngjuhës.
- Mos harroni që gjatë muajve të dimrit shtojmë në peshë dhe mos hani produkte kaloritë e të cilave nuk mund t'i harxhoni.
- Mateni rregullisht tensionin.

Autizmi, më tepër te fëmijët që lindin para kohe e tek nënat e mëdha

Sëmundja e autizmit është më e prirur të shfaqet tek fëmijët të cilët lindin para kohe, ose tek ata që e kanë nënën të madhe në moshë. Sipas një studimi të fundit, nënat që lindi në moshë më të madhe më shpesh lindin fëmijë me autizëm, krahasuar me të tjerat që janë në moshën e duhur për të kryer lindje. Autizmi është një çrregullimi i zhvillimit neural që karakterizohet me reagim dhe komunikim të çrregullt shoqëror, dhe me sjellje të kufizuar dhe të përsëritshme. Konkretisht, hulumtuesit nga Universiteti i Kalifornisë kanë vërtetuar se nënat më të moshuara se 40-vjeç, shfaqin 50 përqind rrezik më të lartë për të lindur fëmijë me autizëm, në raport me nënat që kanë moshë nga 20 deri 30 vjeçare. Ndërkaq, studimi në fjalë shton se autizmi ndërkaq, është një sëmundje që priret të prekë më shumë edhe fëmijët e lindur para kohe.

Sejdiu&Thaçi: Strategjia për veriun, interes i përgjithshëm i Kosovës

„Rend dhe ligj, në kuptimin e sundimit të plotë, jo si diktaturë, jo si tutori ndaj dikujt, por esencialisht si një qasje integruese“, ka thënë në një intervistë për Radion Evropa e Lirë, presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu. Presidenti Sejdiu ka deklaruar se integrimi i pjesës veriore të Kosovës në institucionet e Prishtinës nuk do të bëhet me dhunë dhe se nga ky proces do të kenë dobi edhe serbët e atjeshëm. Sejdiu ka vlerësuar se strategjia për integrimin e veriut, e cila po hartohet nga Qeveria e Kosovës dhe Zyra ndërkombëtare civile, është një plan i mirë dhe në interes të përgjithshëm të Kosovës.

Kryeministri Thaçi: Strategjia e veriut, interes shtetëror/Strategjia e qeverisë është në finalizimin e përpilimit dhe kjo do të mundësojë që veriu i Kosovës të kthehet në normalitetin ligjor, ka thënë kryeministri Hashim Thaçi nie mbledhjen e qeverisë. Kryeministri Thaçi ka thënë se edhe ne veri të Mitrovicës do të mbretërojë rregulli dhe ligji dhe se do të ndalet korrupsioni, krimi i organizuar dhe format e ndryshme të cilat janë jashtë ligjit të Republikës së Kosovës. Kryeministri ka thënë se ky është projekt integrues për veriun dhe se sipas tij është e ftuar edhe opozita që të merr pjesë në grupet punuese në këtë strategji e cila është interes shtetërore i Kosovës. Në anën tjetër, sa i përket strategjisë për veriun, ministri për Kosovë në qeverinë e Serbisë Oliver Ivanoviq ka thënë për agjencinë serbe të lajmeve B92 se kjo strategji përveç provokimit të mundshëm për tensione ne veri, nuk mundë të ketë sukses. Ndërsa analisti amerikan për çështje të Ballkanit, Janush Bugajski ka thënë se nuk duhet të pritet një zbatim i shpejtë i strategjisë, dhe as që ajo të zbatohet me anë të forcës. Bugajski mendon se do të nevojitet shumë bindje, shumë dije dhe shkathtësi, që bashkësia serbe në Kosovë të bindet që është në interes të saj të jetë pjesë e një Kosove që zhvillohet si një shtet normal demokratik. Mirëpo, sipas tij, ky do të jetë një proces i gjatë, në realizimin e të cilit do të ketë mjaft pengesa.

Fokus-Drejtësia në veri të Kosovës - në krizë?/Gjatë dy viteve në gjykatat në veri të Kosovës është marrë vendim për gjashtë raste dhe kjo, pas rifunksionalizimit të pjesshëm të atyre institucioneve në dhjetor të 2008-s, bëjnë të ditur zyrtarë të EULEX-it. Përfaqësues të gjykatave në pjesën veriore të Mitrovicës thonë se drejtësia në veri të Kosovës është në krizë, që nga ndërprerja e punës së gjykatave dy vite më parë. Pezullimi i punës së këtyre institucioneve ishte shkaktuar nga protestat e serbëve të atyre gjykatave disa ditë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Mirëpo, rifunksionalizimi i pjesshëm i tyre, me vendosjen e gjykatësve e prokurorëve të EULEX-it, në dhjetor të vitit 2008, vlerësohet i pamjaftueshëm në drejtim të sundimit të ligjit, për shkak të, siç thuhet, mungesës së punonjësve vendorë në ato gjykata. Kryetari i Gjykatës së Qarkut në veri të Mitrovicës, Kapllan Baruti, në një bisedë të shkurtër për Radion Evropa e Lirë, alarmon institucionet përgjegjëse për gjendjen e krijuar në veri të Kosovës. „Drejtësia e pjesës veriore të Kosovës nuk është në krizë tani, por është në krizë prej datës 20 shkurt të vitit 2008, kur neve na është ndaluar që të kryejmë funksionin tonë të rregullt“. „Prej atëherë, në pjesën veriore është shkaktuar një vakuum juridik, i cili është tejet i dëmshëm për qytetarët e të gjitha komuniteteve“, thotë Baruti.

Aktualisht, në Gjykatën e Qarkut në veri të Mitrovicës janë të angazhuar katër gjykatës, dy prokurorë, dy këshilltarë ligjorë të gjykatave dhe dy këshilltarë ligjorë prokurorialë - që të gjithë të mandatuar nga misioni EULEX. Zëdhënësja e këtij misioni, Kristina Herodes, bën të ditur se që nga seanca e parë gjyqësore, e udhëhequr nga paneli i gjykatësve e prokurorëve evropianë, në fillim të muajit mars, deri më tani, në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë janë gjykuar gjashtë raste. Megjithatë, ajo thekson nevojën për rikthimin e gjykatësve e prokurorëve lokalë në ato institucione. „Për EULEX-in është shumë e rëndësishme që të kthehen gjykatësit e prokurorët shqiptarë e serbë nëpër vendet e tyre të punës. Janë diku 55 raste në pritje dhe ka të dyshuar që janë në paraburgim –madje njëri që nga viti 2007“. „Kjo është një çështje për urgjencë dhe drejtësi. Nuk është fjala vetëm te drejtësia, por është një çështje më e gjerë, sepse njerëzit duan ta jetojnë jetën e tyre. Ata duan t'i zgjedhin problemet që kanë dhe nuk bëhet fjalë vetëm për raste kriminale, por edhe për raste civile“, thekson Herodes. Idetë e ndryshme në lidhje me rikthimin e punonjëseve vendorë në gjykatat në veri, ishin dhënë së fundi nga përfaqësues të Qeverisë së Kosovës, të cilët propozuan që atyre gjykatësve e prokurorëve t'u ofrohet një mjet transportues për në objektet e gjykatave në veri.

Përfaqësues të këtyre gjykatave mirëpresin këtë hap, siç e quajnë ata, teknik, por thonë se problemi në këtë çështje është i natyrës politike. Në fillim të muajit nëntor të vitit të shkuar ishte zhvilluar takimi i parë në mes të përfaqësuesve të EULEX-it dhe atyre të Ministrisë së Drejtësisë së Serbisë. Por, deri më tani nuk është bërë i ditur asnjë rezultat konkret për kthimin e gjykatësve dhe prokurove vendorë në veri. Zëdhënësja e EULEX-it, Kristina Herodes, sqaron këtë problematikë. „EULEX-i është mision teknik, por ka çështje, në të cilat është e përfshirë politika“, shprehet Herodes. Përfshirja e Beogradit zyrtar në zgjidhjen e çështjeve që kanë të bëjnë me veriun Kosovës nuk është hedhur poshtë as nga përfaqësues të Zyrës Civile Ndërkombëtare, të cilët në bashkëpunim me Qeverinë e vendit, kanë hartuar një plan, me të cilin synojnë të rikthejnë sundimin e ligjit në veri të vendit. Baruti thekson se rifunksionalizmi i tërësishëm i gjykatave në veri të Mitrovicës, duhet të jetë hapi primar në jetësimin e këtij plani. „Nëse nuk ndodh pikërisht kjo, atëherë e gjithë strategjia do të dështojë“, thotë Baruti.

Intervista/“Serbia nuk mund të anëtarësohet në BE, pa njohjen e pavarësisë së Kosovës“

Kosovarët shpresojnë një valë të re njohjesh së pavarësisë, pas mendimit të GJND-së, pala serbe pret të kundërtën. Për këtë çështje, flet për DW-në profesori i të drejtës ndërkombëtare Christian Tomuschat

Zoti Tomuschat, shikuar nga perspektiva e sotme, a ishte shpallja e pavarësisë së Kosovës zgjidhja më e mirë?

Tomuschat: Ky ishte vendimi i kosovarëve dhe nuk më takon mua ta komentoj. Por vendimi me siguri që ishte i kuptueshëm, sepse kosovarët kanë jetuar shumë gjatë në një gjendje të pazakonshme. Filimisht pati represione prej autoriteteve jugosllave, ndërsa më vonë për vite të tëra kishte një administratë ndërkombëtare, e cila megjithatë nuk ishte ideale.

Kosovën e kanë njohur deri tani vetëm 65 vende, ndërkohë që kosovarët kanë pritur më shumë. A jeni të befasuar me këtë fakt?

Ekzistojnë vende të cilat janë të përmbajtura për shkak se kanë frika nga lëvizjet secesioniste në vendet e tyre. Por besoj se frika është e pabazë, sepse Spanja me baskët ka një problem krejtësisht të ndryshëm. Baskët kanë një autonomi të gjërë dhe të drejtat e tyre. Ata kurrë nuk mund të kërkojnë të drejtën për secesion dhe vetvendosje. Tek kosovarët situata ishte krejt ndryshe: ata me të vërtetë ishin një pakicë e diskriminuar. Kjo është edhe baza për pavarësimin e Kosovës, e cila mbase do të konfirmohet edhe nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë.

Në GJND ka pasur argumentime të shumta pro dhe kundër pavarësisë së Kosovës. A ishte shpallja e pavarësisë në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare?

Jo, sipas mendimit tim, kjo ishte në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Kjo është kjo një çështje e rëndë dhe e di që juristët kanë mendime të ndryshme. Por për shkak të gjendjes në të cilën kosovarët ishin për më shumë se një dekadë, ishte e paevitueshme që të vendosin për shpalljen e pavarësisë.

Çfarë mund të pritet nga mendimi këshilldhënës i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë?

Unë nuk i njoh raportet brenda Gjykatës, por nuk mund ta marrë me mend që Gjykata të japë një mendim negativ. Në fund të fundit, rrota e historisë nuk mund të kthehet mbrapsht dhe mendoj se duhet të shikojmë drejt ardhmërisë. Një ditë do të kemi raporte shumë miqësore mes Serbisë dhe Kosovës. Kur e mendojmë Evropën Përëndimore ku gati që më nuk ka kufij, atëherë duhet të shpresojmë se edhe raportet e Kosovës, me Serbinë dhe Malin e Zi shumë lehtë do të përmirësohen dhe do të vendoset një harmoni. Sa i përket raporteve me Shqipërinë, gjithsesi nuk ka probleme të mëdha.

Ju e thatë se rrota historike nuk mund të kthehet mbrapsht, por Serbia shpreson se vendet perëndimore do të ndryshojnë vendimin e tyre për njohjen e pavarësisë. Mund ta paramendoni një gjë të tillë?

Jo, këtë nuk mund ta paramendoj. Nuk mund ta paramendoj as që GjND-ja të jap një votë negative. Atje me siguri që ka asryeshmëri të mjaftueshme politike, por jam i bindur se ka edhe fakte të mjaftueshme juridike për vendimin e vendeve perëndimore që të mbështesin pavarësinë e Kosovës, sepse kosovarët kanë pasur të drejtën e vetëvendosjes dhe shkëputjes.

Kosovarët presin pas mendimit të Gjykatës një valë të re njohjesh, ndërsa Serbia pret konfirmim e qëndrimeve të saj kundër pavarësisë. Pra çfarë mund të pritet?

Mendimi këshilldhënës i Gjykatës nuk është i obligueshëm. Por ky mendim ka një autoritet të lartë, sepse GJND-ja është instanca më e lartë për çështjet juridike ndërkombëtare. Në qoftë se Gjykata jep mendim pozitiv, mendoj se do të ketë një valë të njohjeve të reja dhe në këtë mënyrë Kosova definitivisht do të stabilizohet si shtet. Është e mundur që edhe Rusia t'i bashkangjitet këtyre lëvizjeve, sepse në interesin e Rusisë është që mendimi i Gjykatës të mos jetë negativ për Kosovën. Ekzistojnë edhe problemet e Abhazisë dhe Osetisë Jugore, ku Rusia ka vepruar në një formë e cila nuk është fare në përputhje me qëndrimet e saj ndaj Kosovës.

A ka perspektivë evropiane për Kosovën dhe Serbinë dhe a mund të paramendohet anëtarësimi i Serbisë në BE pa njohjen e Kosovës?

Jo, pa njohjen e Kosovës nuk do të ketë anëtarësim të Serbisë në BE. Mendoj se mund të pranohen vetëm së bashku, por edhe anëtarësimi i Kosovës do të jetë problem shumë i madh për BE-në, sepse Kosova ekonomikisht është jashtëzakonisht e dobët. Mendoj se është shumë problematike që Kosova të bëhet anëtare e plotfuqishme dhe të marrë vendime sikur të gjitha vendet tjera. Këtu duhet të kemi një politikë shumë të mirë dhe largpamëse, për të gjetur një zgjidhje të mirë.

Irani humbet arsyen, bllokon sinjalin e VOA-s, BBC dhe Dojçe Veles

Zëri i Amerikës, BBC-ja dhe Deutsche Welle kanë kritikuar autoritetet iranianë për zhurmimin e paligjshëm të transmetimeve të tyre në Iran. Këto kanale ndërkombëtare transmetimesh në deklaratën e tyre të përbashkët që bënë sot, akuzojnë Iranin për zhurmimin e satelitit nëpërmjet të cilit transmetojnë. Ato thonë se veprimi i Iranit është shkelje e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe u bënë thirrje operatorëve të satelitit t'i bëjnë presion Iranit të ndërpresë zhurmimin. Departamenti amerikan i Shtetit tha se përpjekjet e Iranit për të bllokuar pothuajse gjithë mbulimin e protestave të djeshme antiqeveritare në Teheran tregojnë se qeveria „i trembet popullit të vet". Njoftohet se Irani ka bllokuar gjithashtu shërbimin telefonik dhe Internetin. Autoritetet iraniane kanë akuzuar median ndërkombëtare se ka nxitur protestat pas zgjedhjeve të kontestuara presidenciale të vitit të kaluar. Në Iran shpërthyen protesta masive pas zgjedhjeve të qershorit. nga të cilat Presidenti Mahmud Ahmadinexhad doli me një mandat të dytë në atë post

NATO fillon ofensivën në Afganistanin jugor

Trupat amerikaneTrupat e NATO-s të udhëhequra nga Shtetet e Bashkuara kanë ndërmarrë një mësymje në provincën jugore afgane të Helmandit në një plan për të marrë nën kontroll një prej bazave më të fuqishme të Talebanëve. Helikopterët ushtarakë fluturuan mbi qytetin Marjah në orët e para të ditës së djeshme në operacionin „Moshtarak" që do të thotë „Sëbashku" ku marrin pjesë 15 mijë trupa të marinës amerikane, NATO-s dhe ushtarë afganë për të spastruar bazën kryesore të trafikut të opiumit të Talebanëve nga kryengritësit. Një zyrtar i Pentagonit tha për Zërin e Amerikës se presidenti Hamid Karzai ka dhënë pelqimin për misionin dhe se trupat janë në pozicione të gatshëm për të marshuar në Marjah. Zyrtarët përllogarisin që forcat e NATO-s do të përballen me një rezistencë talebane prej afro 1 mijë luftëtarësh. NATO-ja njoftoi planet për mësymjen më shumë se një javë më parë për tu dhënë banorëve kohë që të largohen nga ajo zonë. Aleanca ka këshilluar popullsinë prej afro 80 mijë banorësh që të qendrojnë në shtepi pasi të vazhdojnë operacionet ushtarake.

Duket si lojë e mbyllur - Perëndimi i uron fitoren Janukovicit



Urimet nga burrështetasit botërorë filluan të arrijnë në adresë të Viktor Yanukovicit, fituesit të supozuar të zgjedhjeve presidenciale në Ukrainë, duke e shtuar kështu trysninë ndaj rivales së tij, kryeministres Yulia Tymoshenko, që ta pranojë humbjen. Gjatë javës, edhe presidenti i SHBA-së, Barack Obama, thirri Janukovicin në telefon, për t'ia uruar atij fitoren në rrethin e dytë të zgjedhjeve. Presidenti i Francës, Nicolas Sarkozy, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen dhe presidenti i BE-së, Herman Van Rompuy, gjithashtu i dërguan letra urimi Janukovicit, ndërsa kryeministri i Britanisë, Gordon Brown, apeloi që Ukraina ta vazhdojë shtegun drejtë anëtarësimit në BE edhe nën kryesimin e Yanukovicit. „Britania ka mbështetur aspiratat e Ukrainës për anëtarësim në BE dhe do të vazhdojë të mbështesë këto aspirata. Një BE më e gjerë është një BE më e fuqishme", theksoi Brown. Vëzhguesit ndërkombëtarë i kanë vlerësuar si të lira dhe korrekte zgjedhjet në Ukrainë, duke dëmtuar kështu gjasat që të kontestojë me sukses rezultatin e zgjedhjeve në gjykatë

Hillary Clinton nis një turne në Gjirin Persik, kur Hamasi u rikthehet kërcënimeve ndaj Izraelit

Sekretarja amerikane e shtetit, Hillary Clinton, është në nisur për vizitë në Katar dhe Arabinë Saudite, për të kërkuar mbështetjen e këtyre shteteve për sanksione më të ashpra kundër Iranit, për shkak të programit bërthamor të Teheranit, gjatë takimeve që do të zhvillojë me udhëheqës arabë dhe myslimanë. Clinton do të nënvizojë gjithashtu edhe synimin e administratës së Barack Obamës për të promovuar paqen mes arabëve dhe Izraelit dhe për fillimin e një kaptine të re në marrëdhëniet me shtetet myslimane. Ajo u nis një ditë më vonë se sa që ishte planifikuar, pasi që bashkëshorti i saj, ish-presidenti amerikan, Bill Clinton, iu nënshtrua të enjten një ndërhyrje kirurgjike në zemër, por kjo shtyrje nuk do të ndikojë në anulimin e ndonjë prej takimeve të saj të planifikuara, njoftoi State departamenti amerikan. Clinton mund të kërkojë nga sauditët që të shtojnë sasinë e naftës për furnizimin e Kinës, në përpjekje që të sigurohet përkrahja e Pekinit për sanksione ndaj Iranit. Kina pjesën më të madhe të naftës e importon nga Irani. Së fundi, qëndrimin e vet ndaj Iranit e ka ashpërsuar edhe Rusia.

Hamasi i kërcënohet Izraelit me luftë rajonale/Udhëheqësi politik në ekzil i organizatës Hamas, Khaled Meshaal, ka tërhequr vërejtjen se në luftën e re të mundshme me Izraelin nuk do të përfshihet vetëm territori i Gazës, por i gjithë rajoni, ka shkruar gazeta Al Hayat. Meshaal theksoi se organizata e tij nuk është e interesuar për luftë dhe gjakderdhje të re, ngase sipas fjalëve të tij, lufta e fundit ka mjaftuar. Megjithatë, ai shtoi se nëse Hamasit i imponohet një konflikt i ri, atëherë kjo organizatë do të rezistojë fuqishëm. Gjatë vizitës së tij të fundit në Rusi, Meshaal ka akuzuar Izraelin se po kërcënohet me luftë në Gazë, Siri dhe Liban. Ai për kërcënimet e reja me luftës fajësoi kryesinë e Izraelit, para se gjithash kryeministrin izraelit, Benjamin Netanyahun, Ministrin e Jashtëm, Avigdor Liebermann dhe Ministrin e Mbrojtjes, Ehud Barakun. Ai akuzoi Izraelin edhe për dështimin e përpjekjeve të Rusisë që të ndërmjetësojë mes dy palëve në negociatat paqësore. Mediet izraelite kanë njoftuar se vizita e Meshaalit në Rusi ka hidhëruar zyrtarët izraelitë, të cilët Moskës i kanë dërguar një shkresë të protestës. Hamasi nuk ja njeh Izraelit të drejtën për ekzistencë, nuk pranon të heq dorë nga dhuna dhe nuk pranon as marrëveshjet paraprake paqësore, të cilat palestinezët i kanë nënshkruar më herët me Izraelin.

Greqia s'po përtyp dot kontrollin e ri të BE-së mbi financat e saj

Pas vendimit për mbështetje nga Bashkimi Europian, kryeministri grek ka deklaruar vendi ka humbur një pjesë të sovrantitetit kombëtar dhe ka theksuar vullnetin për të bërë gjithçka për ta rifituar atë. Opozita ka reaguar ashpër ndaj kësaj deklarate, duke theksuar në të njëjtën kohë se qeveria po interesohet vetëm për reduktimin e defiçitit buxhetor dhe se nuk merr asnjë masë për të rimëkëmbur zhvillimin ekonomik të vendit. Atmosfera në Athinë, pas vendimit të enjten të Bashkimit Europian, perceptohet më qartë nga një shfletim i gazetave greke të ditës së premte. Sigurisht, ofrimi i mbështetjes ndaj Greqisë përbën temën kryesore në të gjitha gazetat. Dhe që të gjitha theksojnë lidhjen ndërmjet mbështetjes politike të ofruar dhe mbikqyrjes së trefishtë në të cilën vendoset tashmë Greqia, duke e krahasuar këtë mbikqyrje me lakun, kamxhikun, ose gogolin. Por gazetat kryesore theksojnë se negociatat që u kurorëzuan me vendimin e djeshëm, ishin gjysmake. Dhe kjo sepse, ose disa partnerë komunitarë nuk ishin dakord që Greqia të ndihmohej, ose pse kërkonin masa të tjera edhe më të ashpra. Në favor të masave shtesë shprehen edhe ekspertët grekë. Panajotis Largovas është shef i katedrës së Ekonomisë në Universitetin e Peloponezit: „Do të jetë një shpëtim i përkohshëm në rast se e konceptojmë që i zgjidhim problemet nëse na ofrohen 20 apo 22 miliardë euro. Problemi do të mbetet. Prandaj është e domosdoshme të kryhen qysh sot e në vazhdim hapat e tjerë, që janë reformat, zbatimi rigoroz i programit të stabilitetit dhe masa shtesë, që sigurisht do të kenë një impakt social". Gjithsesi, kryeministri Jorgos Papandreu, deklaroi qartë që në rast të devijimit nga objektivat e programit të stabilitetit, Greqia është e gatshme dhe angazhohet të marrë masat e nevojshme: „Nëse shohim se nuk arrihen objektivat e programit të stabilitetit, ne jemi të vendosur t'i marrim masat e nevojshme shtesë, me qëllim që të realizojmë objektivat tona". Por deklaratat e Papandreut shkaktuan reagimin e ashpër të opozitës. Lideri i partisë më të madhe opozitare, Demokracia e Re, Antonis Samaras, tha se çështja nuk është se sa partia e tij mbështet qeverinë në këtë ndërmarrje të vështirë, por se sa vetë qeveria mbështet ekonominë greke. „Tani qeveria merr masa vetëm për uljen e deficitit buxhetor, por jo për gjallërimin e tregut. Nuk jep frymëmarrjen e nevojshme të mbështetjes së ekonomisë". „Mirëpo, pa masa të tilla, dhe pavarësisht mbështetetjes komunitare, recesioni do të jetë i madh dhe deficititet nuk kanë për t'u reduktuar", tha lideri opozitar, Samaras. Kryeministri grek u tha bashkëkombasve të vet se me futjen në regjimin e mbikqyrjes, influencohet edhe sovraniteti kombëtar i Greqisë. „Për shkak të papërgjeshmërisë së qeverisë së mëparshme, u humb një pjesë e sovrantietit tonë kombëtar, kështu siç u trajtuan çështjet ekonomike. Le të bëjmë tani punën tonë, me qëllim që Greqia të bëhet përsëri zotëruese e fatit të vet". Ndërkaq, nuk dihen ende hollësi se si do të funksionojë mbështetja europiane ndaj Greqisë, çka zoti Papandreu tha se nuk është diskutuar ende me hollësi, dhe që ndoshta do të bëhet në mbledhjen e ardhshme të ECOFIN-it, të hënën. Tre instancat mbikqyrëse të programit të stabilitetit do të jenë Komisioni Europian, Banka Qendrore Europiane dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar. Lidhur me këtë të fundit, kryeministri tha se përfshirja në grupin mbikqyrës e FMN-së ka karakter vetëm teknik dhe se Greqia e kishte kërkuar prej kohësh bashkëpunimin me të. Sipas tij, potenciali teknokratik i FMN-së është i rëndësishëm, për të dihmuar në reformën administrative, si dhe në funksionimin më transparent e më eficent të buxhetit.

CMYK


Përralla
nga gjithë
bota
55


Adrian Majuru
BUKURESHTI
I SHQIPTARËVE
55

ALVENTA
finanza strategica

NË SHQIPËRI

“Alventa”, ikona italiane e konsulencës financiare, tani në Shqipëri

Investitorë të fuqishëm italianë kanë marrë këshillat e grupit të konsulencës juridike e financiare “Alventa” për të kryer investime të fuqishme në Shqipëri, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat. Suksesi në operacione të fuqishme financiare e kanë shndërruar “Alventa”-n në një grup konsulence shumë të kërkuar, në kushtet e një ekonomie botërore, gjithmonë e më të globalizuar.

Alventa - stafeta e suksesit

Konsulencë në politikat fiskale
Ndihmë në vendosjen e partneritetit me autoritetet lokale;
Kapërcimi i shpejtë i pengesave burokratike, duke garantuar një qasje të shpejtë në procedurat për marrjen e punëve publike;
Vendosja e marrëdhënieve me institucionet ndërkombëtare huadhënëse dhe garantimi i një partneriteti me autoritetet lokale për një qasje më të mirë në linjat e kreditimit;
Konsulencë juridike për vlerësimin dhe hartimin e kontratave, duke përfshirë kryerjen e negociatave deri në mbylljen e marrëveshjeve të partneritetit

ALVENTA SRL Viale Europa, 72 36075 Mnotecchio Maggiore (VI) tel/fax 0039 444 699 926
P.IVA/C.F. 03499130247 Iscrizione REA VI - 0330179 **info@alventagroup.com** **www.alventagropu.com**

LETËRKËMBIM

Me Kostaq Xoxën

E djathta shqiptare është humane, përkundrejt cinizmit komunist

Nuk do të shkruaja në organin e shtypit në të cilin jemi angazhuar edhe ne, ish-të përndjekurit politikë, për gjëra që kanë të bëjnë me intimitetet e njerëzve. Por, meqë privatësia, nga njëra anë thuhet se duhet të mbetet tabù, nga ana tjetër përdoret në interes të politikës socialiste të mbrapshtë. Në këto raste më jepet të shkruaj edhe unë, me cilësinë e njeriut që ka vuajtur burgjeve dhe internimeve, vetëm e vetëm se iu gjetën disa shkrime në formë ditari, ndaj të cilave ai regjim kundërveproi ashpër, duke më dënuar me shtatë vjet burgim. Pas burgut bëra dhjetë vite internim . Por më e keqja është se detyruan gruan të më ndante dhe tani jam i vetëm, pa familje, në një gjendje dëshpëruese. Megjithatë e mbaj veten me kurajë, kur shoh se dita-ditës po zbulohen varret e personave, pjesa më e madhe e të cilëve, të asgjesuar pa gjyq. Këta mbeten eshtrahumbur, se varret e tyre janë kolektive, të shpërndara Malit me Gropa e gjetiu. Nuk e kam pasë njohur Havzi Nelën dhe nuk kam pasur talentin e tij të spikatur. Por e ndjej veten si vëllanë e tij shpirtëror dhe kam qarë kur është varur për faje, pak a shumë si ato të miat.

Nuk do të shkruaja, zonja Aneta Rama, sikur ju, në intervistën tuaj të tetë shkurtit, botuar në një të përditshme, do të shpërfaqnit dhimbjen tuaj si prind, por pa i politizuar çështjet. Ndërsa ju lëndoheni se shihni të shkruar emrin e djalit tuaj me Edi Kristaq Rama, dhe e kuptoni se bashkëshorti juaj përflitet për firmën që ka vënë, si anëtar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, që kishte edhe atributet që të firmoste ekzekutimet e atyre që dënoheshin mizorisht për fajësí që vetëm diktatura e Enver Hoxhës i quante të tilla.

Kur intervistuesi ju ka pyetur nëse djali juaj është njerí që kërkon falje, që toleron dhe të mirëkupton, ju jeni përgjigjur se për ju është i pandryshueshëm, kujdeset për ju dhe për djalin. Dhe keni shtuar: "Ato që thashë janë edhe çështje që ai i ka marrë nga familja". Kështu përgjigjen e keni zgjeruar, duke i përmendur tërthorazi babanë. Në këtë rast jeni ftuar të shpreheshit edhe për të jatin. –"Kur kam dëgjuar Edvin Kristaq Rama që përmendet vazhdimisht, - është shprehja juaj për të atin , - kjo nuk është gjë tjetër veçse Edi Ramën ta bëjë krenar për këtë gjë, se edhe kushdo që e ka njohur Kristaqin, do t'i thoshte "të jesh krenar për babanë që ke pasur". Ah, kjo krenaria juaj për të zbardhur pendët e korbit!

Pra, jo vetëm Ditmir Bushati paska qenë krenar për të atin i cili, si sekretar i Komitetit të Partisë, ka vënë firmat në dënimet, ku nuk mungonin edhe ato kapitalet, por edhe nëna dhe i biri i Kristaq Ramës e paskan pasur këtë krenari!. Ky i fundit, Edi, u ndodh para një pyetjeje të tillë në Uashington: - "Si i jeni përgjigjur ju kërkesës publike të familjarëve të poetit të varur Havzi Nela (njeriut të fundit të ekzekutuar në Europën Lindore për arsye politike në vitin '89) për të kërkuar ndjesë për faktin që firma e babait tuaj figuron ndër ato që kanë dhënë dritën jeshile për varjen e poetit. Është e rëndësishme për mua, si ish-i përndjekur, (pyetësi, Mustafa Xhepa, është ish-i persekutuar politik) të marr një përgjigje jo thjesht nga i biri i të atit që ka vënë firmën në këtë krim por, mbi të gjitha, nga njeriu që drejton sot opozitën dhe që një ditë pretendon të drejtojë Shqipërinë!". Vëreni, tani, përgjigjen e Edvinit: -"Më vjen keq për ty se si je katandisur; goxha burrë merresh me gënjeshtra. Kjo nuk është e vërtetë. Babai im ka qenë artist (po incestin e tij në familje a vazhdon ta pranojë?) dhe s'ka pasur punë me këto gjëra që thua ti". Të mohosh një konfirmim ekzekutimi që përmban firmën e Kristaq Ramës, kur kjo firmë ka dalë në gazetë në fac símile, kjo e ka emrin paturpësí. Ka të bëjë me karakterin e një njeriu. Dhe ky karakter është krejt i ndryshëm nga ai që paqyroni ju në thënien: "Komshinjtë e mi, sa herë më takojnë, më thonë se nuk e harrojmë Kristaq Ramën në ato xhiro buzë Lanës, në pritje të makinës së (radhëve) të qumështit". Zbukurime me lule letrash joaromatike! Thoni edhe se ajo firma që e vini në dyshim "është helm ndaj popullit"! Ajo është helm ndaj poetit, - nëse do të flasim sinqerisht,- helm i atyre gjykatave që vendosnin "në emër të popullit (!)".

Ju flisni kështu, zonjë, jo si nënë, por si politikane komuniste. Flisni si byroisti Spiro Koleka. Ja, një thënie tjetër juaja:

-"Edi është një njeri që, nëse është i bindur se ka të drejtë, e shpie atë deri në fund". Meqë flisni për "bindje", ai ka qenë gjithmonë njëri pa bindje. Në librin "Refleksione" ka shkruar se PS-ja, si trashëgimtare e PSSH-së, është parti kriminale dhe e jashtëligjshme. Ishte koha kur donte ta hiqte veten si dhjetorist, por – për fat të mirë – s'i besuan. Tani ai del se është kryetari i të jashtëligjshmëve! E kuptoni, zonjë, se ç'bindje ka biri juaj? Duhet ta dini se ai fluturoi nga pozicioni që kërkoi t'i jepte vetes figurën e një Zhan D'Arke liridashëse, në personifikimin e ideologut fanatik, në kohën e tanishme kur, në Gjermaninë e sotme, një mësues i thjeshtë u përjashtua nga mësimdhënia se ishte, në kohë të hershme, ithtar i Hitlerit! Prandaj çuditem kur habiteni se po ju largohen njerëzit dhe (po ju citoj) "Lubonjën dhe Zhejin nuk i shoh më prej vitesh. Megjithatë unë i ndjek në televizor dhe me shpirtin e një nëne, me kurajë i dëgjoj dhe kur thonë të pavërteta për Edin dhe kjo më dhemb". Sado "të pavërteta" që të thonë, (përse nuk thoni cilat janë ato?) të vërtetën e madhe, të vërtetën skandalozë jua ka nxjerrë në dritë të diellit Mero Baze, emri i të cilit nuk përmendet, se tani është dhënë me shpirt pas Edi Ramës, birit tuaj. Ai, si zhbirues gjërash personale, ka zbuluar dokumentet gjyqësore të divorcit të birit tuaj. Dhe i ka botuar në "Temën" e tij. Ju flisni me ton mallëngjyes dhe për "periudha të dhimbshme", që tingëllojnë false. Po ju citoj sërish në apologjinë tuaj: "Në vitin 1997 kam kaluar një periudhë shumë të vështirë dhe të dhimbshme. Filloi me rrahjen e Edit, në 22 janar 1997 të po këtij viti. Sigurisht janë momente që nuk harrohen për një nënë, por ishin momente që tronditën të madh dhe të vogël në atë periudhë".

Këto "tronditje" më revoltojnë, kur bëni sikur nuk kuptoni ç'është tronditja e vërtetë. Duke mos qenë dakord me vakinë e rrahjes së Edit, mua më duket si një pikë ujë në oqean, përballë tragjedisë shpirtërore, kur isha në burg dhe mora lajmin e vdekjes së vajzës sime të mitur, të pafajshme, nga tirania e atij regjimi enverist që ka mbetur gjer tani i pandëshkuar, falë edhe përkushtimit të E. Ramës, Fatos Klosit, Isarait dhe enveristëve të tjerë, që bëjnë çmos që të mos realizohet lustracioni.

Tani do të më falin edhe lexuesit, që do të flas për veten time, që të mos abuzoni me fjalën "tronditje": ....Isha i ri, tërë energji dhe i pashëm, siç thuhej. Vajza me të cilën u fejova, e dashuruar marrëzisht pas meje, më betohej se dashuria jonë do të ishte e përjetshme. U martuam. Ajo nuk iu nënshtrua prindërve të saj, të dy komunistë, që nuk e pranuan këtë martesë. Patëm një vajzë që zbukurohej ditaditës. Ishte e bukur, si Matilda! (Ju nuk u tronditët për shfigurimin e këtij emri, për depersonalizimin, për tronditjen e vartetë, për shkatërrimin e talentit të saj dhe për heqjen dorë nga profesionin i artistes, për mbylljen në vetvete, e vrarë në shpirt për së gjalli. Asnjëherë nuk flisni për tronditjen e kësaj vajze, për faj të birit tuaj). Kur u burgosa për kot më kot, për një ditar, ime shoqe u ndodh përpara presionit: ose të martohej me një djalë që i propozuan prindët e saj, ose nuk i mbetej veçse internimi. Pranoi martesën. Nuk e kishte të vështirë divorcin me mua. Por ai dhëndri i ri na paska qenë një i pashpirt. Vajzën s'donte ta shihte me sy. Donte ta nxirrte në rrugë, se i kishte gjetur fotot e mia, një pjesë të të cilave vajza ime i kishte shpëtuar nga djegia. Ajo më shkruante vazhdimisht në burg, paçka se letrat e mia nuk i binin në dorë, për faj të s'ëmës. Te gjyshi dhe gjyshja nuk pati asnjë mbështetje. Iku fare nga ajo banesë "e saj" e mallkuar. Kërkoi të shkonte në internim, te një xhaxhai i saj. Duke mos pasur lekë sa duhet , rrugës shoferi apo një shoku i tij, e keqtrajtoi. U gjet e mbytur në lumë. E kuptova se do t'i kishte ndodhur ndonjë gjë e tmerrshme. Sepse nuk merrja më letra prej saj. Një i burgosur i ri më vuri në dijeni për tragjedinë. Më mbuloi trishtimi. Më vonë mësaova edhe vdekjen e ish-gruas. Nga një sëmundje e pashërueshme, më thanë. Zoti e ndjeftë. Nga burgu dola i sëmurë. Sa herë u përçapa për vetëvrasje! Por një mik i burgut, kishte ikur emigrant në Itali dhe, kur erdhi në verë, më takoi dhe më la në dispozicion apartamentin e tij. "Rri sa të duash, - më tha. Zëre se e ke shtëpinë tënde. Më bleu edhe një televizor". Më mori adresën. Letra e parë që mora, më njoftonte se kishte hapur një konto në emrin tim, me 100 euro të përmuajshme. Tani, ndonëse në gjendje të vështirë shëndetësore, nuk më mungojnë miqtë zemërbardhë, që më mbajnë me kurajë. Këtë letër ia diktova njërit, që m'u ofrua të më ndreqte gabimet.

Dhe ja, mbarova. Gjithmonë e vazhdimisht nuk më hiqet nga mendja vajza ime e shkretë dhe më kujtohet Matilda. Ajo fatkeqe duhej të pranonte se djali nuk ishte i saj dhe i Edit, por i Kristaqit! Ajo duhej të vuante edhe mungesën e subvencionit për banesë e ushqim. Edi nuk mund t'i mohojë këto sulme të tij ndaj një të pafajshmeje, sepse i ka të shkruara të zezë mbi të bardhë, me firmë e me vulë zyrtare. Por këto të zeza, as që i përmend fare shoqja e Kristaqit i cili, po t'i besojmë të birit, na qenka edhe gjyshi, edhe babai i fëmijës! Këto nuk i ka nxjerrë dr. Berisha, por Mero Baze. Ky nuk përflitet fare nga propaganda e molepsur, gjasme namuzlie e madhe ndaj privatësisë. Por ngarkohet dr. Berisha me fajësi të paqena i cili, pasi duroi me muaj sulme ndaj familjes së tij, u përgjigj me vonësë, duke përmendur vetëm disa nga aterialet që përmbante "Tema" në faqet e saj. Sa për familjen e Berishës, ka dalë publikisht nëndrejtori i përgjithshëm i Bankës Botërore që ndihet i penduhar për akuzat ndaj djalit të doktorit, akuza të cilat, siç thotë, janë bërë në mirëbesim nga ai, duke u besuar falsifikatorëve të së vërtetës.

"Momente që tronditën të madh dhe të vogël", pra, mund të kërkohen gjetiu.

Resul Sh.

Letrat e bajas

Nga Flori SLATINA

10 këshillat e Valentinit!

Thuaji partneres ose partnerit të dua...

1. Thuaji partneres ose partnerit "të dua", të paktën një herë në ditë. Edhe pse mund të jetë i sigurt, personi që keni në krah ka nevojë t'u dëgjojë ta thoni këtë fjalë.

2. Përshëndetjen e mëngjesit apo të rikthimit pas punës në shtëpi shoqërojeni gjithmonë me puthje dhe nëse atë ditë po mendoni edhe për të kryer marrëdhënie seksuale shtojini edhe një përqafim.

3. Bëni "takime dashurie" me partnerin për gjithë jetën tuaj. Trajtojeni partnerin edhe më mirë nga sa e keni trajtuar kur jeni njohur në fillim. Mos harroni, jini të përzemërt, buzëqeshini partnerit sa herë që rikthehet në shtëpi, mbajini duart njëri-tjetrit gjatë një shëtitjeje që bëni të dy, etj.

4. Lërini pas defektet e tij. Nëse jeni të lidhur me një djalë apo vajzë që nuk është shumë e rregullt, atëherë keni dy alternativa t'i përsërisni ato që bëni dhe të mërziteni të dy, ose ta këshilloni butësisht që ai të mos i përsërisë më.

5. Përqendrohuni tek pozitivja. Në vend që të mendoni vetëm për një fjalë apo veprim të gabuar të tij, e cili u ka mërzitur shumë, mendoni pozitivisht, mendoni të gjitha gjërat e bukura që bën për ju, fjalët e ëmbla që u pëshpërit në vesh etj.

6. Mendohuni dy herë para se të flisni nëse jeni me nerva. Mos u përpiqni të flisni nëse jeni të mërzitur, thjesht heshtni ose qëndroni larg njëri-tjetrit. Dilni për pak çaste të merrni ajër dhe të qetësoheni, dhe kur të riktheheni sërish tek partneri do të shihni se mërzia ka mbetur pas dhe do të jeni gati të përkëdhelni dhe puthni njëri-tjetrin.

7. Mos përdorni sekretet e partnerit apo dobësitë e tij gjatë një zënke për të lënduar, apo edhe në një situatë të zakonshme. Ajo çfarë juve u duket e parëndësishme, idiote, mund të jetë diçka shumë serioze për partnerin tuaj. Merrni në konsideratë atë çfarë është e rëndësishme për njeriun e zemrës dhe mos e diskutoni atë me miqtë apo familjen tuaj.

8. Mendoni së pari për partnerin tuaj. Nëse të dy e bëni këtë, atëherë të dy i keni dhënë një ndihmë të madhe lidhjes suaj. Thuaji "po" partnerit sa më shumë të jetë e mundur, plotësojini atij edhe dëshirat më të vogla dhe mos e pengoni të shijojë aktivitete apo të tjera gjëra që i kanë dhuruar kënaqësi para se të lidheshit.

9. Respektoni partnerin tuaj. Mos e përgojoni atë me asnjëri. Kur flisni për të dashurin tuaj përdorni gjithmonë fjalë që tregojnë dashuri dhe respekt në radhë të parë.

10. Gjeni një mënyrë për t'u bashkuar të dy çdo ditë. Zbuloni çfarë u përshtatet dhe ndihmon me të vërtetë marrëdhënien tuaj. Hani jashtë bashkë, takohuni për të pirë çajin e pasdites, shtrihuni në krevat për të përkëdhelur njëri-tjetrin, bëni një shëtitje etj.

'Të dua' ndonjëherë nuk mjafton. Një gjest dashurie, edhe më pak. Për ta befasuar, ta lumturosh të dashurin duhet ta godasësh në emocionet e tij. Ja disa këshilla për të festuar më bukur Shën Valentinin. Shën Valentini nuk është i gjithë viti. Do të ishte i mërzitshëm nëse do të ishte kështu! Atë çka mund të bësh gjithë vitin është të përmirësosh kapacitetin të jesh i përqendruar te tjetri. Shën Valentini është një moment për të rinovuar dashurinë.

Për Shën Valentinin kemi një mundësi të veçantë, që në përgjithësi nuk na prezantohet gjatë gjithë vitit. Mund të komunikojmë edhe me lule. Duke dhuruar një trëndafil, sipas ngjyrës së karakterit të personit, mund të dërgojmë një mesazh personit që dashurojmë.

Shën Valentini sot është te porta dhe çiftet e festojnë dashurinë e tyre me darka, me qirinj, trëndafila dhe dhurata romantike që ta drithërojnë zemrën.

"Norvegjezët e qoshes së goditur" e Ipsenit

Nga Steve KING

Më 13 mars 1891 pjesa "Fan tazmat" e Ibsenit u shfaq për herë të parë në Londër, e cila ishte një ngjarje "e debatueshme dhe që bënte epokë," thotë biografi Majkëll Mejer, dhe që tani konsiderohet si "një nga rastet më të famshme teatrore." Historianët e teatrit thonë se skandali në lidhje me këtë shfaqje të vetme bëri që të botoheshin mbi 500 artikuj të ndryshëm dhe kjo e bëri Ibsenin "një emër që përmendej në çdo shtëpi, madje edhe të atyre anglezë që kurrë nuk kishin shkuar në teatër apo që kurrë nuk kishin haapur ndonjë libër."

Megjithëse u botua një dekadë më parë, dhe pavëarësisht se kjo nuk ishte breshëria e parë në përpjekjet e Ibsenit për të "siluruar varkën e shpëtimit" të pronës shoqërore, pjesa solli kritikat si dhe kundërkritikat e saj. Për shkak të referencave ndaj sifilisit, dashurisë së lirë, gjaktrazimit dhe dhunës, pjesa u mallkua, u ndalua nga çensura dhe u shmang nga teatrot më kryesore dhe ato shtetërore të Europës. Ajo u konsiderua si tepër e turpshme, madje edhe duke e patur të printuar në shtëpi, duke detyruar të rinjtë dhe mëndjet moderne të mblidheshin në fshehtësi për ta lexuar dhe ta shfaqnin atë të improvizuar në disa qytete.

Regjizorët e Londrës e shmangën çensurën e zyrës së lord Çamberlenit duke krijuar Shoqatën e Teatrit, ku Tomas Hardi dhe Henri Xhejms ishin nga anëtarët e parë të saj, dhe organizuan një shfaqje të vetme në Teatrin Mbretëror në Soho. Shou e ndoqi shfaqjen dhe e quajti audiencën "të zënë nga frika"; ndërsa Uilliam Arçer shkruante se shtypi bënte fjalë për një thirrje unanime të "klithjes së mallkimit" që "rrallë herë është ndeshur në historinë e kritikës":

Një kanal i hapur; një pamje e neveritshme; një akt i ndyrë I bërë publikisht...bruto, pothuajse një punë e urryer... Ndyrësia dhe era e keqe janë shtresuar kaq shumë njera mbi tjetrën si me një mistri...Një gatim kaq i ndyrë dhe i pistë saqë kurrë ndonjëherë nuk është lejuar të turpërojë trupat e një teatri anglez...Të folurat në tym të norvegjezëve të qoshes së goditur...Nëse do të bëhen përpjekje ët tjera për të përsëritur këtë indinjatë, atëhere nuk ka dyshim



se autoritetet do të zgjohen nga letargjia e tyre.

Ibsen ishte "një hije e zezë e fantazmës, që ecën i krrusur duke krijuar tmerre gjatë natës"; aktorët ishin "dashnorë të lapërdhisë dhe diletantë në papërshtashmëri." Gratë që kërkojnë të drejëtn e votës u gjetën veçanërisht të përjashtuara: "Gruaja jo grua, gratë pa seks, e gjithë ushtria e eksentrikëve të shëmtuar me këmishat e natës...të edukuarit dhe qent e qelbur... burrat e feminizuar dhe gratë e mashkulluara...vetë lordi Çamberlen i ka lënë të gjitha këto të lulëzojnë si fantazma."

Më vonë Xhois Xhejms pa një shfaqje të kësaj drame shumë vjet më vonë pasi në mënyrë të ngjashme ajo ishte çensuruar dhe denoncuar se ai ishte një Uliks. Rasti frymëzoi "Eopilogun e Fantazmave të Ibsenit," ku ai bëhet "fantazma e Kapitenit Alving" për të bërë gjuajtjet e tij ndaj atyre që e tregonin me gisht, të cilët donin të shpëtonin epokën duke dënuar Ibsenin.

Çdo numër i botuar, vite me radhë, i revistës letrare "‚JETA E RE"– ishte vepër madhore e Esad Mekulit në veçanti, dhe njëkohësisht të krijuesve shqiptarë dhe botërorë...

Bardin s'e mund harresa

Esad Mekuli

Mr. Milaim BERISHA

Esad Mekuli është njëri ndër poetët më të spikatur të letër sisë shqipe të viteve `30. Poe tika e tij, e rëndësishme si për nga vlera artistike, ashtu edhe për nga domethënia historike letrare, vazhdimisht ka zgjuar në masë të madhe interesim dhe shqyrtim të gjithanshëm. Me përmbajtjen dhe strukturën e krijimtarisë së tij, Mekuli inkuadrohet në grupin e krijuesve të letër sisë shqipe të viteve `30 të shekullit tonë.

Dhembje, revoltë dhe ironi

Libri me vjersha nga ishulli i mallkuar "Avsha Ada" i Mekulit është një përmbledhje vjershash të frymëzuara nga një ambient i ri (me plagë të vjetra), nga realiteti i hidhur në Turqi. Edhe në këtë tufë vargjesh si në tërë krijimtarinë e tij, hetohet ajo nota sociale dhe përkushtimi kah problemet e kohës. Mekuli në çdo kohë dhe në çdo ambient është i angazhuar. Edhe pse është thënë se: Ajo që inspiron artin është e keqja..., prapëseprapë arti nuk është i thirrur vetëm ta prezantojë atë të keqe, por edhe ta luftojë." Vepra dhe fjala e Esad Mekulit, së këndejmi, vihet në funksion të idealeve të kohës dhe të ambientit të ri, Avsha Ada. Edhe këtu poeti nuk qëndron në pozita neutrale as indiferente, as në anën e më të fortëve. Por, përkundrazi ai, duke qëndruar në anën e të përndjekurve sfidon të keqen dhe të fuqishmin. Në këtë antagonizëm dhe në këtë luftë njeriu i tij vazhdimisht mbetet kudo njeri. Avsha Ada", ",Bisedë me Ismajlin", "Fshati në mëngjes", "Hapsanja", "Bekshiu", "Shpresa", "Ciganët", "Dy botëra", "Sharap Bajram", "Shishe mbi pullaz", "Alltën kum" dhe "Pse"- janë të 12 vjershat e lidhura në një rreth të ngushtë kuptimi që përbëjnë këtë libër të vogël, por të pasur me atë që na ofron Mekuli.

Mekuli këtë ironi e sjell në thjerrëz poetike duke na kumtuar të vërtetat elementare. Avsha Ada, vend i shkretë, ishull i shkëputur, mbi të cilin edhe jeta edhe historia kanë gabuar. Një kënd mjaft i caktuar i të vëzhguarit, i qartë qysh në këtë poezi, ku ishulli është "vatër e përleshjeve shekullore", na sugjeron përcaktimin etik dhe poetik të krijuesit dhe postulatet e tij jetësore. Të gjitha këto në kuadrin e një revolte specifike duke prezantuar dhe insistuar në bukurinë e Avsha Adës, ai na ofron këtë bukuri, ndonjëherë si revoltë ose lutje për vendin e mallkuar. Poeti këtë e ka shkruar si poezi të llojit të vet të dhembjes dhe admirimit. Në poezinë "Bisedë me Ismajlin", me kumtesat në formë monologjike, poeti me një shqetësim esencial dhe kob të ishullit, na ofron një informacion të fortë jetësor. Me anë të lundrimit në anije të bardhë (çfarë ironie) arrijnë pushtuesit dhe përhapin shqetësim midis njerëzve, të cilët në shekuj jetojnë së bashku ,, më pak në gëzim, më tepër në mjerim." Mekuli na ofron një panoramë poetike të llojit të vet të Avsha Adës: prej limaneve, rrugëve, çajtoreve, dokeve orientale, gjer te shpirti i qytetit - të personifikuara në fytyrat e peshkatarëve, bejlerëve, hanëmllareve të shehrit, snobeve, kuletë-mbushur, pastaj pasardhësit e tyre, etj. Më tutje, poeti në formë kontrasti na i afron dy botëra, dy shtresa njerëzish: 1. Ajsha – nuse me dimi gjer në kërçik dhe 2. Sheherjanet, me minifund dhe bikini kostume. Çdo poezi është medaljon i veçantë i bukurisë dhe medaljon i pikëllimit. Motivet sociale, temë e shpeshtë në këtë libër, i japin përshtypje këtij dimensioni të dytë. Poetët me imagjinatë të fortë kanë sukses në përpjekjen e njohjes gjer te identiteti i asaj objektives në subjektive, duke i dhuruar qenies së poezisë dinjitetin njerëzor. Në këtë kuadër zhduken relacionet hapësinore, poezia prek bregdetet, të cilat edhe nuk i lidhin urat e vërteta: dashuria është ajo, e cila paramendon çdo akt të vërtetë poetik. Poeti është ai që ndërton ura njerëzore. Në këtë kontekst, vjershat e Esad Mekulit nuk janë vetëm një shënim lirik në margjinat e verës, të takuar në Avsha Adë, por ato janë dëshmi të poetit që ka qenë e hapur dhe e afërt për vuajtjen e çdokujt.

Ëndrra, virtyti dhe zëri i ndërgjegjes

Në anijen "Shpresa", në poezinë me të njëjtin emër agojnë mëngjeset e zbrazta, pa peshk, derisa peshkatarët ëndërrojnë "etën tjetër". Vjersha "Hapsana", është thelbi i këtij libri. Kjo është pamje posaçërisht e suksesshme e kësaj revolte metafizike. "Hapsana", kjo fortifikatë në fortifikatë, kjo botë droje dhe drite, që në Avsha Adë është e zbrazët. Esadi në këtë vjershë qartë e paraqet këtë iluzion hapësinor. Këtë mund ta bëjë dikush i huaj, që nuk i mbetët më vend në ishullth." Në të vërtetë, ajo "mbetet e hapur as e gjallë, as e vdekur." Edhe në ishull vetëm mysafirët e paftuar shkaktojnë pengesa dhe prishin harmoninë shekullore. Është jashtë "Hapsanës" edhe jashtë ishullit, sipas parashikimit poetik të Mekulit, qëndron bota e dëshiruar.

Nën pamjen idilike të "Sharap Bajramit", festës së verës, hareve, kur kënaqësia vetë për vete përjetohet, fshihet, tragjikja dhe drama njerëzore e banorit të Avsha Adës. Fati i këtij ishulli ia ka prerë akuzën dhe vulën e përhershme. Bukuria e aktit poetik është medium në të cilin të gjitha këto kundërthënie harmonizohen në një balancim të urtë të shprehjes poetike duke i dhënë, në shikim shënime të rastit një dimension të thellë, të rëndësisë dhe peshën e akuzës subtile. Në këtë aspekt është përmasë e kësaj poezie dhe rëndësisë së përgjithshme të librit.

Ëndrra e Esad Mekulit nuk ishte ëndërr e robit, por virtyt i atdhetarit dhe shkrimtarit të mirëfilltë, veprimtarit të mençur, guximtarit të urtë, bardit të sakrifikuar, largpamësit dhe çlirimtarit të paepur – është Ai me fjalën dhe veprën e Tij, është krenaria dhe kujtesa jonë kombëtare. Mbi të gjitha: Ai është mendje e zgjuar, forcë e ndërdijes dhe ndërgjegje e kohës sonë dhe kohëve në vijim...

INJAC ZAMPUTTI
12 Shkurt 1910 – 12 Shkurt 2010

Dy ditë më parë u përkujtua Injac Zmaputti (1910-1998) një figurë e rëndësishme e historisë, shkrimtarisë, përkthimit, gjuhësisë, etnologjisë, me rastin e 100-vjetorit të lindjes. Në një simpozium në Akademinë e Shkencave referuan emra të njohur si Seit Mancaku, Pëllumb Xhufi, Luan Malltezi,Musa Vyshka, Behar Gjoka etj mbi kontributin dhe punën e palodhur të profesorit, një kontribu shkencor që lidhet me serialin e dokumenteve për Historinë e Shqipërisë për shekujt XV-XVII, të cilat janë botuar të gjitha në vitet '80. Injac Zamputti u lind në Shkodër ku studioi në kolegjin Saverian të Jezuitëve. Studioi më pas në Universitetin e Triestes për Shkencat Politike. Në vitet e fundit botoi tek "Hylli i Dritës" një ese për fillimet e letërsisë në gjuhën shqipe. Në vitin 1995 i jepet dekorata "Punonjës i shquar i Shkencës dhe i teknikës për kontribut shumë të shquar në zhvillimin e shkencave albanologjike". Në vitin 1993 riatdhesohet në Itali ku vdiq, më 28 shkurt 1998 në Tivoli.

NJË DRAMË E BUKUR E ZAMPUTTIT

Nga Musa VYSHKA

Drama sjell mesazhin e madh dhe të përjetshëm të unitetit tonë kombëtar, të dashurisë midis vëllezërve të të gjitha krahinave, dashuri që nuk e lëkundin aspak, as kufijtë e largësia...

Në kohën kur Zamputti shkroi dramën që kemi nderin t'ju sjellim pas kaq vitesh në dorë, Shkodra e tij qe në ballë të zhvillimit të dramaturgjisë dhe teatrit kombëtar.

Duke u nisur nga Fishta i madh te Ndre Zadeja gjer te talentet më të rinj, pasi e kishin provuar së pari veten në poezi e në prozë, s'di se si, por nga një shtysë shpirtërore e çuditshme, pushtoheshin gati të gjithë nga dëshira e papërballueshme për t'u hedhur në dramaturgji.

Injac Zamputti nuk kishte se si t'i shpëtonte një tundimi të tillë. Dhe shkroi "Damianin himariot", dramën që fjeti prej dekadash në raftet e e bibliotekave, dashamirëve të letërsisë e arkivave gjersa na erdhi koha dhe rasti ta kujtojmë e tua sjellim përsëri në duar.

Ai vetë e quante dramë lyrike. Shpjegimin e këtij emri nuk kishte nevoja ta bënte me gojë sepse vepra e bën vetë. Drama që mund ta titullojmë pa i marrë leje autorit që na ka lënë prej vitesh është më tepër se një tragjedi heroike që qëndron midis legjendës e baladës, që rri krenare përkrah të gjitha veprave epike të popullit tonë, një vepër që përmbledh në vetvete shumë elementë të artit të mrekullueshëm letrar.

Ai përndryshe nga shumë bashkëkohës e bashkëkrijues merr një rrugë të vetën, të vështirë e të panjohur, niset nga Shkodra, nga Mali i Rozafës e gryka e Bunës e duke udhëtuar gjatë arrin në Himarën e largët.

Mesa duket qartë, ky udhëtim është ndër të parët e një prozatori të mbyllur brenda dhimbjeve e gëzimeve të Veriut të tij për të gjetur shtigjet e reja, të panjohura e të pastudiuara të historisë, shkencës ku hyri dhe mbeti një nga Kolombët e papërsëritshëm.

Besoj se nuk ka gjë më të qartë e me të shpjegueshme se kjo, po të mendosh se ai, si studiues e historian i një potenciali madhor e dinte se heroizmi i një kombi, luftrat e përpjekjet e tij për liri kurrë nuk kanë patur e nuk kanë kufij brenda një fisi, krahine apo një vendi të vetëm por kanë qenë dhe janë shpërndarë, kanë buçitur e shpërthyer kudo, në çdo cep të Shqipërisë, se heroizmi, dashuria për lirinë e jetën nuk janë tipare fisnore apo krahinore, por janë tipare e cilësi të një komb të tërë pa të cilat ai do të qe shuar e asimiluar prej kohe.

Zamputti e ka të qartë këtë. Dhe e kërkon nga një cep në cepin tjetër të Shqipërisë, në Himarë. Dhe i gjen atje një vëlla të ri e dinjitoz, Gjergj Elez Alinë, Damianin. Dhe tek të dy sheh shëmbëllimin madhor e heroik të shqiptarit që do ta shpëtojë nderin e Shqipërisë dhe do ta sakrifikojë veten për të ruajtur dinjitetin e saj.

Kjo mendoj se është një nga vlerat kryesore të veprës dhe një nga shenjat ogurbardha që ky shkrimtar, duke kaluar lehtësisht në fushën e historisë po i zgjeron me besim, trimëri, art e dashuri, frymëmarrjen gjithë letrave tona.

Kryen në të njejtën vepër detyrën e dramaturgut dhe historianit. I shton armatës së heronjve të legjendave tona një luftëtar madhor nga bregu i detit, Damianin, që merr guximin të hyjë gjer në oborrin e Sulltanit jo thjesht për të shpëtuar vajzën që dashuron, por për të shpëtuar një komb, një popull nga përçudnimi, fyerja e poshtërimi i një sunduesi që kërkon ta kthejë një vend krenar në një harem që pjell gjarpërinj e korba.

Drama lexohet me një frymë e me lehtësi, ashtu siç lexohet një poemë apo një baladë. Personazhet dalin me pak fjalë, me pak veprim por me tiparet e tyre, dinjitozë e pa lëkundje që nga Marku e Lenae gjer tek Gjini, Gjoni e Aleksandra. Secili ka karakterin e tij, tiparet vetjake por të gjithë së bashku janë përfaqësues të një kombi të vetëm, të Shqipërisë, që pret të bjerë mbi të një agim i ri, që pret me shpresë, siç thotë autori një shpresë, një ardhmëni.

Struktura dramatike është e ndërtuar qartë, e komanduar nga dora e një poeti, prozatori e dramaturgu, i cili synon me aftësi krijuese të poetizojë atë që kërkon të thotë.

Por përveç vlerave të tjera duhet theksuar gjuha, një gegërishte e bukur, e pasur dhe e pastër.

Drama sjell mesazhin e madh dhe të përjetshëm të unitetit tonë kombëtar, të dashurisë midis vëllezërve të të gjitha krahinave, dashuri që nuk e lëkundin aspak, as kufijtë e largësia, as larmia e natyrëshme dhe e domosdoshme e zakoneve e traditave, por që e forcon, ndriçon e lartëson lufta e madhe dhe e përbashkët për liri e përparim.

PËRSIATJE PËR PRANINË GJUHËSORE TË «PELLASGJISHTES SË LASHTË»

Nga Mathieu Aref (Arif Mati)



Për sa i përket historisë ose gjuhës shqipe, sot, çfarë duhet të pro vojnë dijetarët si parahistorianët, historianët, arkeologët ose gjuhëtarët ? Së pari, duhet provuar shkencërisht me anë të studimeve dhe hulumtimeve të thelluara të bazuara me argumente provuese, akte dhe fakte të pakundërshtueshme dhe analiza të drejta se shqiptarët janë me të vërtet pasardhësit e pellazgëve. Këta pellazgë të famshëm janë keqtrajtuar prej shumicës së historianëve dhe gjuhëtarëve modernë me këtë fjali lapidare : « **Pellazgët, popull parahelenik, janë tretur pa lënë gjurmë** ». Ja gabimi fatal që ka penguar breza të tërë dijetarësh të mos shkojnë më larg në hulumtimet për këta pellazgë. Vetëm në shekullin XIX të erës sonë dhe në fillim të shekullit XX disa dijetarë filluan të studiojnë gjuhën shqipe, midis të cilëve një numër i madh gjuhëtarësh gjermanikë (gjermanë dhe austriakë si Jokli, Majeri, von Hahni, Kreçmeri dhe të tjerë jo më pak të njohur). Për fat të keq, ajatollahët e gjuhësisë moderne (dhe të asaj që pranohet prej të gjithëve) nuk i kanë marrë para sysh këto punime që dalin nga shtigjet e rrahura. Ata veç kanë pranuar (pa e studiuar me rrënjë dhe pa pasë përdorur dialektin gegë, të cilin e përfillën fare) se gjuha shqipe është gjuhë « indoeuropiane » (skaj që unë nuk e pranoj) që përbën një degë më vete në gjenealogjinë (çka nuk do të thotë patjetër « **etnogjenezë** ») e gjuhëve. Ja pse nuk është thelluar studimi i kësaj gjuhe (veçanërisht dialekti geg i veriut që mbetet « një fosil i gjallë »). Ky gabim i dyfishtë (Pellazgë të injoruar dhe gjuha shqipe e shtënë në dollap) bëri që gjuha shqipe të përjashtohet nga studime dhe hulumtime në kuadrin e këtij « akademizmi indoeuropian », kahja e shmangur e të cilit e ka zhytur këtë disiplinë në një qorrsokak të vërtetë. Ja pse, për këtë çështje, studime gjuhësore të ndryshme kanë lulëzuar në anarki. Ja pse, edhe sot e gjithë ditën, gjuhëtarët shqiptarë (të nënshtruar ndaj kësaj « ideologjie » indoueropianiste) nuk bëjnë be veçse për « ç'është e pranuar bashkarisht ». Për ata, të gjithë ata që dalin nga kjo vijë « zyrtare » janë « revizionistë, negacionistë ose sharlatanë», që i quajnë persona non grata në « klubin » e tyre.

Kjo që sapo thashë nuk është veçse një parantezë, sepse thelbësorja nuk është të provosh që shqipja është gjuhë shumë e lashtë a universale a e vetmja në botë a prej së cilës kanë dalë gjithë të tjerat ! Jo, s'duhet vënë qerrja para qeve. Më e rëndësishmja është të provosh që shqiptarët rrjedhin prej pellazgëve dhe që grekët janë pushtuesit e vendit të pellazgëve dhe që kanë marrë kulturën e tyre. Vetëm duke u nisur nga ky pohim (me prova, sigurisht) do të mund të thuhet se "me të vërtetë" gjuha shqipe ("**fosil i gjallë** ») është vërtet trashëguesja e kesaj « **pellazgjishteje të lashtë**». Marr përsipër, pa turp të shtirë, atësinë e këtyre dy skajeve, si edhe atë « semito-egjiptian » që ka të bëjë me origjinën e grekëve : i duhet dhënë Cezarit ajo që i takon Cezarit ! Të shumtë janë sot ata që i përdorin këto emërtime pa zënë në gojë burimin e tyre.

Si duhet provuar që pellazgët janë stërgjyshërit e shqiptarëve ? Në fillim duhet provuar që ata bëjnë pjesë në një bashkësi etnolinguistike të pafund që shkonin nga Atlantiku në Detin e Zi dhe nga të dy brigjet e Danubit në Kretë dhe ishujt Egje, pa harruar se ata kanë kaluar nga Ballkani në Azi të Vogël. Po vë në dukje, kalimthi, se pellazgët (që unë i kam quajtur **Homo Pelasgus**, skaj tjetër ky imi) janë popull autokton dhe nuk vijnë nga Azia si mendojnë (pa asnjë provë), sot e gjithë ditën, disa mendje të informuara keq, dashakëqinj ose krejt të paaftë. Gjithashtu duhet sjellë prova se nuk bëhej fjalë për një popull laragan që përmblidhte etni të ndryshme por që bëhej fjalë me të vërtetë **për një popull të vetëm të përbërë nga fise që kanë mbajtur emra të ndryshëm por që kanë pasur një kulturë të përbashkët dhe që kanë pasë folur një gjuhë të vetme (pellazgjishten e lashtë) me dialekte të ndryshme**. Kjo është « etnogjeneza » e vërtetë e gjuhëve indoevropiane. Për ta mbështetur gjithë këtë argumentim, më është dashur « të shkoqit » pothuaj të gjitha shkrimet e antikitetit që nga Hekateu i Miletit dhe Helanikos i Mitilenës dhe duke vazhduar me Herodotin dhe Tukididin deri te kritikët aleksandrinë të shekullit III para erës sonë. Gjithashtu, duket shkoqitur dhe thelluar studimi i teksteve moderne për të nxjerrë andej argumentet e nevojshme për t'u provuar gjuhëtarëve se ata kanë hyrë në « rrugë të gabuar » duke përqafuar ideologjinë « indoeuropianiste ». Duhet provuar se « Mikenienët » (emër modern, i panjohur prej të lashtëve dhe i sajuar prej Shlimanit) nuk qenë grekë dhe se këta të fundit qenë me të vërtetë me origjinë semito-egjiptiane. Duhet provuar, gjithashtu, se « mitologjia » e quajtur greke nuk qe veçse një mitologji e dalë nga qytetërimi i lashtë i pellazgëve dhe të cilën grekët e uzurpuan dhe e manipuluan (për t'i shërbyer çështjes së tyre) kur erdhën në rajonin balkano-egjejan rreth shekullit VIII para erës sonë (me egjiptianin Danaos, Fenikasin Kadmos dhe asirianin Pelops). Duhet, gjithashtu, provuar që shkrimi domethënë ligjërimi (dhe jo domosdo alfabeti) i « linearit B» (dalë prej linearit A i Kretasve, gjuha e të cilëve nuk është deshifruar kurrë) ishte ajo e pellazgëve sepse grekët nuk gjallonin ende në atë kohë. Duhet vënë në pah periudha e quajtur « Motet ë errëta » (1200 deri në 800 para erës sonë) ku nuk dihet gjë fare për mungesë dokumentesh të shkruara (të shkatërruara prej grekëve kur erdhën rreth viteve 800). Megjithatë pjesa më e madhe e shkencëtarëve të specializuar në historinë parahelenike është e bindur se pellazgët zotëronin një alfabet dhe një shkrim të tyrin : pa sjellë prova, kuptohet vetvetiu. Për këtë çështje nuk ka veçse hamendësime provash meqë alfabeti i tyre është zhdukur; po jo pellazgët që kanë lënë një trashëgimi të madhe « gojore » të transmetuar nga brezi në brez (Iliada, Odiseja, mitologjia, legjenda të ndryshme, substrat gjuhësor të lashtë). A i zhdukën grekët gjurmët e këtij qytetërimi prej të cilit u frymëzuan dhe i muarën kulturën ? Po, meqë nuk ka asnjë shkrim të kësaj periudhe të gjatë të quajtur « Motet e errëta ». Për fatin e tyre të keq krimi nuk qe i përsosur : ata nuk e kanë menduar se një ditë do të zbulohej se emrat e mitologjisë dhe fjalë të tjera të « greqishtes së lashtë » do të shpjegoheshin me dialektin gegë të Shqipërisë së Veriut. Dhe nuk e zhdukën dot gjuhën shqipe, që, sot, është mjeti kryesor që ka bërë « t'i hiqen petët lakrorit » ! Megjithatë pellazgët dhe ilirët që humbën alfabetin e tyre ose që e braktisën për arsye që nuk dihen, vazhduan të shkruajnë gjuhën e tyre duke marrë alfabetin më në modë (në epokat e tyre përkatëse) : kret, grek, etrusk, latin … Keltët (**Keltos** ishte vlau i **ilirosit** na thotë legjenda) kanë vepruar njësoj duke përdorur, përgjithësisht, alfabetin latin. Dhe më në fund, shqiptarët kur deshën të shkruajnë gjuhën e tyre përdorën dora-dorës alfabetin grek ose latin, madje edhe arab (meqë otomanët përdornin alfabetin arab). Por, shkurt, katolikët shqiptarë muarën alfabetin latin, për të shkruar gjuhën e tyre liturgjike midis shekullit XII dhe XIV. Më së fundi rreth fundit të shekullit XIX u krijua alfabeti « i shqipes » (1878, Lidhja e Prizrenit). Sidoqoftë, ky alphabet u ripunua duke krijuar, me shkronja latine, shkronja speciale për t'ia përshtatur fonetikës shqipe (1908, Kongresi i Manastirit). Ai u institucionalizua vetëm më 1917. Ky alphabet që u bë zyrtar është ai i ditëve tona. Ataturku u frymëzua nga ky alphabet për të zëvendësuar alfabetin arab të turqve.

Logjikisht, si do të kishin mundur të gjallonin gjatë kësaj periudhe të heshtur (1200-800) madje edhe asaj të mëparshme (>2000 para erës sonë)? Si mundeshin ata të dilnin nga ky "hiç", nga ky "no man's land grek"? Duhet provuar, më së fundi, se s'ka pasur kurrë **luftë të Trojës** midis grekëve dhe pellazgëve midis 1193 dhe 1183 (date kjo e shpikur prej matematikanit Erastoten në shekullin III para erës sonë!) por që ishte fjala për një epope shumë të lashtë ("Zemërimi i Akilit" të transformuar prej pushtuesve helenë në "Iliade") që tregon për disa përpleshje midis fiseve pellazgjike (në Iliadë ka pellazgë në të dy kampet!) dhe të kënduara nga qyteti në qytet prej rapsodëve të famshëm ose aedëve, poetëve epikë. Lufta e vërtetë e Trojës është ajo e pushtimit prej helenëve të vërtetë – rreth 680 para erës sonë – i pjesës veriperëndimore të Anadollit të sotëm, që dikur quhej "**Ilion**". Pra, nuk është Troja e lashtë e treguar te "Odiseja" e famshme e Homerit (që ka shumë gjasa të ketë jetuar por që nuk ka shkruar asnjëherë asgjë!) por ajo e një lufte tjetër, të asaj të fillimit të "**kolonizimit grek**" në 680 para erës sonë. Ja pse epopeja e lashtë pellazgjike ("zemërimi i Akilit") u quajt "**Iliadë**" (nga emir i qytetit Ilion). E gjithë kjo lexohet qartë ose "midis rreshtave" në të gjitha shkrimet antike, pra edhe në poemat epike të quajtura homerike, në teogonine e Hesiodit dhe në shumë tekste të autorëve antikë grekë. Për të provuar këto, kam shkruar vëllimin tim të dytë : "Greqia Mikeenët = Pellazgët ose zgjidhja e një enigme". Për të kurorëzuar "**të tërën**", pasi të sillen të gjitha provat, duhet të ndërhyjë "**kriteri gjuhë".** Pra duhet filluar me **historinë** dhe jo me **Gjuhën.**

E pata gabim që botova, të parin, librin tim « Shqipëria…". Duhet ta kisha filluar me të dytin (« Greqia… ». Dhe me të vërtetë, për të provuar që gjuha shqipe është më e lashtë se gjuha greke duhet më parë të provohet që etnia shqiptare ka gjalluar (përmes trakoilirëvë të ndërfutur) para grekëve dhe se këta të fundit janë pushtues që zunë Ballkanin, Egjeun dhe Azinë e Vogël pas shekullit VIII para erës sonë.

Nuk mund të thuhet kurrsesi (si po lexoj andej-këndej) që grekët janë flurim i një etnie moderne të kryqëzuar dhe që greqishtja kurrë nuk ka qenë folur para kohëve moderne ! Qysh nga mesi i shekullit VI para erës sonë, nga koha e Pisistratit, dalin tekste greke me shfaqjen e poemave epike, të dala nga tradita gojore pellazgjike (të ripunuara për t'i shërbyer çështjes së pushtuesve të rinj), të transkriptuara në këtë greqishte të vjetër që po lindte. Nuk duhet harruar se grekët në Ballkan, në Egje, në Azinë e Vogël dhe në Itali ishin një « **pakicë** » qeverisëse pra një **elitë** që shkruante në gjuhën e vet (edhe pse ishte bastarde, domethënë e dalë nga një përzierje e hollë dialektesh pellazgjike - jonian/atike, eoliane, arkado-qipriote dhe doriane – dhe nga semito-egjiptiane). Grekët, me kohë, ndërtuan një etni të përzier dhe një gjuhë **të përbërë**. Por meqë nuk ishin shumë (pakicë etnike e tipit semitik në krahasim me pellazgët « bjondë me sy të kaltër », si na thotë Homeri te Iliada), kjo përzierje mbeti e çatmuar dhe pak e përhapur. Dhe me të vërtetë, si pohon Herodoti (shekulli V para erës sonë), jonianët ishin pellazgë të bërë helenë pasi mësuan greqishten. Pra greqishtja gjallonte në këtë epokë megjithëse e përzier. **Drejtuesit dorianë** (veçanërisht spartanët) qenë të vetmit **helenë të vërtetë**. Herodoti vetë pohon se drejtuesit (mbretërit) dorianë ishin me origjinë egjiptiane. Në Spartë, mbreti dorian Agios IV pohonte se kishte një spartan për tre periekë. Por, e dimë se Periekët, Hilotët dhe Penestët ishin ilirë të nënshtruar autoritetit të Spartës. Ata shquheshin si « punëtorë » (forca pune) në shoqërinë spartane : ushtarë, bujq, zanatçinj, skulptorë, etj. Mirëpo « **dorë**, **dorët** » do të thotë në shqipe « duart » domethënë « krahë pune » pra ata që punojnë me duart e tyre. Me kohë spartanët muarën emrin e popullit të nënshtruar : ata kanë pranuar dhe asimiluar qytetërimin e të mundurve. Pra janë gjithë këto përzierje (etni dhe gjuhë) që lindën grekët e ardhshëm.

Ja pse është e domosdoshme të thuhet se grekët kanë gjalluar me vonesë pasi asimiluan (madje uzurpuan) qytetërimin e pellazgëve që sapo mbërritën, domethënë **pas shekullit VIII** para erës sonë. Pra grekët nuk gjallojnë qysh prej shekullit XVIII madje qysh prej shekullit XXI para erës sonë si po na e çekanosin në tekstet shkollore dhe universitare qysh prej njëzet e pesë shekujsh. Në fillim greqishtja kishte shumë fjalë pellazgjike (në dialektet : jonian, eolian, arkado-qipriot dhe dorian). Kjo greqishte e lashtë kishte pra me të vërtetë një fond pellazgjik që shpjegohet me shqipen e sotme, që u ka qëndruar rrënimeve të kohës. Ja pse pjesa më e madhe e emrave të Mitologjisë « të quajtur greke » shpjegohet edhe tani me shqipen e sotme (dialektin gegë të Veriut të Shqipërisë, që ka ruajtur të njëjtin fond, të njëjtin ndërtim dhe të njëjtën « fonetikë » si pellazgjishtja e lashtë). Gjuha greke u formua si të gjitha gjuhët nga një nënshtresë (substrat) gjuhësore e lashtë me shumë ndihmesa semito-egjiptane ose të tjera. Prania e grekëve (tezga tregtimi dhe koloni) në gjithë pellgun e Mesdheut u dha mundësinë të përhapin gjuhën e tyre falë takimeve të shumta tregtare. Në fillim ishte gjuhë e folur deri në mes të shekullit VI para erës sonë (nën tiraninë e Pisistratit) epokë kur u shfaqën poemat epike : Iliada dhe Odisea, poema pellazgjike të traditës gojore që ishin në këtë gjuhë greke që po lindte. Këtu po hap një parantezë. *(vijon nesër)*

INTERVISTA

"Kam punuar pa pushim me librat; pa mbaruar ende njërin, nisja tjetrin"

Intervistë me JK Rowling, dhënë para pak vitesh në transmetimin e BBC

Pyetje: Kam në dorë një libër tuajin me 766 faqe. Është një arritje, gjithsesi.

Këtu është trajtuar një çështje sekreti, një nevojë për fshehtësinë dhe pak qesharake apo jo?

Rowling: Jo.

Pyetje: Përse jo? Si e argumentoni këtë?

Rowling: Jo tërësisht, sepse një pjesë e madhe e saj ka rrjedhur prej meje, autore.

Pyetje: Vërtet?

Rowling: Po, në mënyrë përfundimtare madje. Dua të them se njeriu mund të jetë cinik dhe jam e sigurt se e nxitin vetë këtë dhe thonë se ishte një dredhi marketingu, por unë nuk dua që brezi i ri ta marrë vesh gjithë këtë. Kjo, sepse është pjesë e argëtimit prej historisë dhe duhet të mundohesh shumë për të krijuar harengat e kuqe dhe për të dhënë informatat … kjo është imja, kjo është imja … kisha ndërmend të thosha se kjo është jeta ime, nuk është tamam jeta ime, por është një pjesë e rëndësishme e jetës sime.

Pyetje: Ka rezultuar me ndonjë çmim ky sukses dhe famë si shkrimtare?

Rowling: Fama është diçka interesante, sepse unë kurrë nuk kam dashur të jem e famshme, nuk e kam ëndërruar kurrë. E di, fantasia ime për të qenë një shkrimtare e famshme shqitet me realitetin. E mendoja se të jesh një shkrimtare e famshme është njësoj si të jesh Jane Austen.

Të jesh në gjendje të rrish në shtëpinë e famullitarit dhe librat tuaj të ishin të famshëm dhe rastësisht mund të korrespondonte me sekretarin e Princit të Wellsit. Nuk prisja të fotografohesha as në plazh. Kurrë nuk kam ëndërruar të ndikoj te jeta e vajzës sime negativisht. Do të ishte diçka e vrazhdë po të thoja se nuk është gjë e mirë të jesh e famshme; të takosh të huaj rrugëve dhe të thuash shumë gjëra të këndshme, kur ata të lavdërojnë. Dua të them se ka gjëra të këndshme në të qënit e famshme.

Pyetje: Suksesi ju ka ndryshuar?

Rowling: Po.

Pyetje: Në ç'mënyrë?

Rowling: Ndjeja se gjithçka ndryshoi.

Pyetje: Lidhur me paratë do të doja t'ju pyes. Shumë njerëz kur fitojnë shumë para në një periudhë të shkurtër ndihen fajtorë. A ndjeheni edhe ju fajtore?

Rowling: Po, ashtu është, ndihem vërtet fajtore.

Pyetje: Përse vallë?

Rowling: Kur më ndodhi në fillim, nuk është se u bëra e pasur sa hap e mbyll sytë. Kërcimi më i lartë për mua ishte avancimi në Amerikë, që më mjaftoi sa për të blerë një shtëpi. Deri në atë kohë jetoja me qera. Nuk u ndjeva fajtore, por u frikësova deri diku. Mendova se kisha fituar ca para dhe nuk duhej të bëja ndonjë budallallëk me to. Po, po, është e vërtetë, më pas u ndjeva fajtore.

Të paktën të mund të shihja shkakun dhe pasojën. Isha e vetëdijshme që kisha punuar shumë për një kohë shumë të gjatë. Padyshim që shpërblimet ishin tërësisht të pabarabarta, por mund të shihja se si shkova deri aty, kështu që ishte më e lehtë të meditoja.

Pyetje: Le të bisedojmë pak për librin tjetër. Harri, Ron dhe Hermione nuk janë më fëmijë, por rriten nga viti në vit. Si do të ndryshojnë në librat tuaj?

Rowling: Kanë për të ndryshuar shumë. Po të shohësh me kujdes 5 librat p.sh. mendoj se në 21 aventurat, personazhet nuk kanë patur impulse hormonale – përveç Anës, që nganjëherë duket se mund të jetonte një jetë më të mirë.

Pyetje: Ky është modeli i zakonshëm në librat tuaj. Fëmijët mbeten gjithnjë të vegjël. Por, tuajët ..

Rowling: Më ka ardhur një letër e hapur nga një grua që kishte dëgjuar se Harri po përjetonte takimin e parë të dashurisë dhe ajo kishte shkruar "Të lutem, mos e bëj këtë, është e tmerrshme. Unë i dua shumë këta libra, se janë një botë e re ku fëmijët e mi mund të prehen".

Fjalë për fjalë ajo tha "i lirë nga lëndimi dhe frika" dhe po mendoj "A i ke lexuar librat? Je duke folur për lirinë dhe lëndimin, frikën? Harri duket sikur jeton në ferr, sa herë kthehet nga shkolla".

Pyetje: Kështu pra, do të kemi një çift në librat e ardhshëm?

Rowling: Po, në tërësinë e kohës.

Pyetje: Një çift të pazakonshëm? Jo Hermiona dhe Draco Malfoy p.sh?

Rowling: Në fakt nuk dua të them se kjo do të pakësojë fansat. Ata thjesht kënaqen, argëtohen. Disa prej tyre afrohen ca si shumë.

Pyetje: A po ndryshon jeta e adoleshentit Harri?

Rowling: Në këtë libër është shumë më i inatosur. Inatoset dhe justifikohet në veprimin e tij.

Pyetje: Kur sheh materalin tënd që shitet, atëherë i sheh gjërat si Harri Potter dhe të tjerët.

Rowling: Është e vërtetë kjo. E dija që ora ishte vënë me alarm. Si ndjehem për këtë? Ndershmërisht, mendoj se është i mirënjohur. Do të doja të ndalja shitjen. Dy herë në vit ulem me Warner Brothers dhe bisedojmë për shitjet.

Pyetje: Mendoj se kjo tingëllon mjaft argëtuese.

Rowling: E dija që do ta thonit këtë. Nuk është e këndshme në fakt. Ishte e tmerrshme, një gjë e tmerrshme.

Pyetje: Por ju mund të kishit thënë: "Jo, nuk kam për të bërë asnjë shitje".

Rowling: Nuk mendoj se do ta bëja këtë. Jo në atë kohë. Datat nuk i mbaj mend fare. Duhet të ketë qenë periudha midis 1998-1999, kur nisa të bisedoja me Warner Brothers dhe në këtë pikë, nuk kisha fuqi t'i ndaloja. Kjo është natyra e botës së filmit. Ato janë filma majft të kushtueshëm dhe nëse ata vazhdojnë t'i ekranizojnë, kanë për të shpenzuar shumë më tepër dhe dua të shtoj se rrëqethem nga dëshira për të parë 5 librat e mi. Ngaqë mendoj se ata kanë nisur të ndjejnë se unë po shkruaj, vetëm për të parë nëse mund ta bëjnë ose jo.

Pyetje: Nuk shqetësoheni kurrë se mbase trashëgimia juaj nuk do të jetë kjo botë që ju krijuat, por disa copëza plastike?

Rowling: Jo, ndershmërisht them se nuk shqetësohem aspak për të. Mendoj se librat do të jenë shumë të rëndësishëm sesa disa copëza plastike. Vërtet besoj dhe kjo mabse tingëllon paksa arrogante dhe e ndjej në thellësi të shpirtit.

Pyetje: A ndërgjegjësoheni se çfarë fitoni në këtë rast?

Rowling: Jo.

Pyetje: A e dini sa keni fituar vitin që shkoi?

Rowling: Jo.

Pyetje: Them se do kenë qenë nja 10 milionë ...

Rowling: E kam takuar llogaritarin tim dhe i kam thënë "Në listën e të pasurve, jam e pasur, më e pasur se një mbretëreshë". E kam idenë se sa fitoj, gjithsesi.

Përktheu: Rudina Dahri



Pyetje: Çfarë doni të thoni me ashpërsi?

Rowling: Vërtet doni t'jua them?

Pyetje: Nuk e di. Nuk dua t'ju vë në siklet.

Rowling: Jo, nuk të fajësoj, gjithsesi.

Pyetje: Ju keni përmendur në librat e mëparshëm se sapo mbaroni njërin libër, nisni tjetrin. A e keni nisur të gjashtin?

Rowling: Po. Nuk i kam dhënë shumë kohë, sepse kam lindur një foshnje. E nisa këtë libër kur isha shtatzënë me Davidin. Në të vërtetë, kisha shkruar disa faqe dhe nuk është keq kjo sasi, duke qenë se bebi është vetëm 6 javësh.

Pyetje: A do të zbulojmë në librin e 5, se përse Voldemort ka armiqësi me prindërit e Harrit?

Rowling: Po.

Pyetje: Mund të na japësh ca të dhëna ...

Rowling: Mund të gjesh gjithçka në librin e 5. Aty mund të shohësh një dallim të madh midis mësueses së Arteve të Errëta.

Pyetje: A ka për t'u bërë grua ajo?

Rowling: Po. Nuk është zonjusha Figg. As Fleur.

Pyetje: A do të zbulojmë më shumë rreth Snape?

Rowling: Po, sigurisht.

Pyetje: Po nëna e Harrit? A u thërrmua dashuria e nënës së Harrit apo u shpërblye disi?

Rowling: Jo, nuk mund t'jua them këtë. Keni për të zbuluar më shumë për Snape.

Pyetje: A ka vdekje në këtë libër?

Rowling: Po. Një vdekje e tmerrshme.

Pyetje: Një vdekje e tmerrshme e një personazhi të rëndësishëm?

Rowling: Po. e kam shkruar dhe rishkruar disa herë momentin e vdekjes. Ishte përfundimtare, gjithsesi. Personazhi vdiq përfundimisht. Po ecja në kuzhinë duke qarë dhe Neil më tha "Çfarë ka ndodhur?" dhe unë ia ktheva "Sapo vrava një njeri". Neil nuk e dinte për të bëhej fjalë. Por unë i thashë "Sapo kam vrarë një njeri". Ai më tha më pas "Mos e bëj, pra". Ia ktheva "Nuk funksionon kështu. Shkruaj libra për fëmijë, por kam nevojë të jem edhe një vrasëse e dhembshur".

Pyetje: Mendoni se kjo do t'i dëshpërojë njerëzit?

Rowling: Po, ashtu them. Gjithmonë e kam ditur se do të vinte kjo ditë, por ia kam dalë të jetoj në mohim dhe të bart me vete karakterin tim, të mos mendohem gjatë.

Pyetje: Kështu, ju e dini se çfarë do të ndodhë me personazhet kryesore gjatë serialit.

Rowling: Po, padyshim që po.

Pyetje: Përse të ndalim kur personazhet rriten? Duhet të jetë interesante të dimë se çdo të ndodhë me Harrin, tashmë të rritur.

Rowling: Nga e di se mund të jetë gjallë?

Pyetje: Oh. Në fund të librit 7 do të vdesë?

Rowling: Do të ketë një mënyrë për këtë. Tashmë jam më e lumtur se në gjithë jetën time, po, përfundimisht.

Pyetje: Por, nuk ka të bëjë kjo me të shkruarin apo jo?

Rowling: Jo ... por ka të bëjë shumë me këtë. Kisha nevojë për pak më shumë kohë midis librit 5 dhe 6.

Pyetje: E keni bërë publike pasurinë tuaj?

Rowling: Po.

Pyetje: Padyshim që i përket asaj që krijon. Njerëzit e ndjejnë se i përket atyre.

Rowling: Po, ashtu është e vërteta. Këtë javë kemi patur mijëra letra në zyrë. E di ç'dua të them. Në njëfarë mënyre është shumë prekëse, se ata mendojnë realisht se kam patur kohë.

Pyetje: Nëse nuk kërkon, nuk merr.

Rowling: Nuk i fajësoj që janë përpjekur, absolutisht jo. Përveç gruas që më shkroi dhe më kërkoi t'i jepja asaj dhe burrin të saj një rrogë vjetore, sepse nuk kishin qenë në teatër që prej 3 vjetësh.

Pyetje: Paskeni dhuruar një pjesë të pasurisë tuaj?

Rowling: Mirë ... Thjesht i qarkulloj paratë, kjo është gjithçka që mund të them.

(JK Rowling and Jeremy Paxman në tryezë, duke parë disa dorëshkrime).

Rowling: Ky është plani për Urdhrin e Feniksit. Këto plane i kam bërë për çdo libër. Është një mënyrë për t'u kujtuar për çdo gjë, në çdo kapitull.

Pyetje: Këto copëza letre që keni mbushur me elegancë janë plot mendime ...

Rowling: Disa prej tyre janë totalisht të tepërta tashmë, sepse janë shkruar tashmë dhe janë në interes të ndjenjës.

Pyetje: Çfarë mënyre preferoni kur krijoni? Dua të them, se disa syresh ulen dhe thonë "Më duhet të krijoj të paktën 600 fjalë apo 1000 brenda ditës". A punoni edhe ju kështu? Si krijoni ju, në ç'mënyrë?

Rowling: Jo, është njësoj si të pikturosh mbi një gardh. E njëjta gjë.

Pyetje: Disa shkrimtarë shkruajnë kështu, në mënyrën që ju përmenda.

Rowling: Jua tregova pak a shumë.

Pyetje: Jo "shkrimtarë të shquar" ju thashë ... Somerset Maugham ka shkruar në fakt të paktën 600 fjalë në ditë.

Rowling: Jo, unë nuk shkruaj me normë. Krijoj kur më vjen frymëzimi.

Pyetje: Pra, ju uleni dhe ndiheni e rraskapitur, por vazhdoni punën gjithsesi.

Rowling: Pothuaj. Është si një lloj fshikullimi për kalin shkolla e të krijuarit art ose letërsi në rastin tonë. Brenda ditës mund të shkruaj 600 fjalë, më pak ose dhe më shumë.

Pyetje: Dimë që e keni shkruar fundin apo jo?

Rowling: Po, kam shkruar kapitullin e fundit të librit të shtatë.

Pyetje: Mos jeni përfshirë ndonjëherë nga dëshira për të mos e filluar kurrë këtë libër?

Rowling: Po. por jo për arsyet që ju prisni t'i shpreh. Nganjëherë po. kam dëgjuar momente shumë të vështira dhe kam menduar "E përse jam duke e bërë këtë? Shumë rrallë më ka ndodhur, shumë rrallë, gjithsesi.

Pyetje: E keni menduar këtë rastësisht?

Rowling: Nuk kam menduar për të një kohë të gjatë, por më ka ndodhur kur isha duke shkruar librin e katërt. U futa në një shteg shumë të sikletshëm. Gjëja më e bukur ishte se libri po shtypej ndërkohë.

Pyetje: Ja një tjetër sfidë.

Rowling: Po, edhe një tjetër. Ka patur spekulime për mënyrën se si e kalova tensionin ... ishte e këndshme, sepse në kuptimin e plotë të fjalës, nuk po ndjeja ndonjë detyrim në vetvete. Isha e lumtur se po martohesha. Kjo më ndaloi frymëzimin. Në fakt "Urdhri i Feniksit" nuk më ka dhënë asnjë shqetësim. Isha shumë e bindur se duhej shkruar.

Më erdhën më pas shumë mendime të këndshme për të shkruar. "Dhoma e Tregtisë" ishte një rast serioz, e kam shkruar për 5 javë. Te "Kupa e zjarrit" isha e palumtur dhe e kuptova në një pikë se po fantazoja shumë. Kisha thyer krahun. Si mund të më kuptonin fansat se kisha thyer krahun, dhe nuk mund të shkruaja?

Pyetje: Kjo është arsyeja që libri u shkrua brenda 3 vitesh? 3 vjet, sa gjatë...

Rowling: Nuk më ka marrë shumë kohë në fakt. E vendosa .. isha në një gjendje kur më erdhën shumë gjëra në jetë. Tensioni i shtypit më kishte tronditur dhe nuk mund të punoja e qetë në shtëpi. Iku ajo periudhë. Nuk ndalova së shkruari, jo, aspak. Kur mbarova "Kupa e zjarrit" më duhej t'u ktheja paradhënien dy botuesve të mi. Ata gati sa nuk pësuan arrest kardiak, sapo u mbyll telefoni. I sqarova se doja të botoja përsëri vitin tjetër. Doja të shkruaja me qetësi. Kisha përfunduar "Gurin filozofik" dhe atë pasdite nisa "Dhomën e sekreteve". Kur mbarova Dhomën e sekreteve", nisa "Të burgosurin e Azkabanit" ditën tjetër. Kur mbarova "Të burgosurin e Azkabanit", nisa menjëherë "Kupa e zjarrit". Prandaj them që kurrë nuk kam pushuar së shkruari, në çdo gjendje.

Pyetje: A e dini se çfarë do të ndodhë në fund?

Rowling: Gjatë 3 vjetëve kam shkruar shumë krijime të mira dhe më duhet t'i kthehem edhe njëherë atyre. Nuk e di ende si do shkojë.

Pyetje: Mbase ndonjë roman për të rritur?

Rowling: Mmmmm. Është diçka krejt ndryshe. Diçka që më çliron.

Pyetje: Besoj se kjo mund të jetë më e vështirë për ju. Mbase do të duhet të shkruani në pseudonim këtë libër për të rritur?

Rowling: Ekzaktësisht. Por keni për ta gjetur brenda pak sekondave ama. Nuk e nënvlerësoj pushtetin e shtypit, por nuk e di se çfarë do të bëj. Di, që do të shkruaj, me siguri të plotë. A do të botoj? Nuk e di. Do të doja në fakt të jetoja një jetë normale.

Pyetje: Nuk është gjë e keqe, të shkosh në varr, kur ke krijuar këtë botë në trillime dhe ke mbajtur gjallë kureshtjen e fëmijëve në librat tuaj.

Rowling: O, Zot. Jo. Sigurisht që jam krenare për Harrin dhe këtë nuk e mohoj. Premtoj se kurrë nuk do të shfajësohem për të. Kurrë. Sepse jam krenare dhe do ta mbroj Harrin kundër të gjithëve.

JP: JK Rowling, thank you.

I VETMI UNIVERSITET PRIVAT NE JUG

UNIVERSITETI PAVARESIA VLORE

V I T I 2009-2010

TANI JEMI AFER

FAKULTETI I EKONOMISE DHE I SHKENCAVE SHOQERORE

- Ekonomi
- Shkenca Politike
- Drejtësi

FAKULTETI I SHKENCAVE TE APLIKUARA

- Arkitekturë
- Inxhinieri Informatike

ADRESA

Bulevardi Vlorë-Skele
PO. Box 4358 Posta Vlorë
AL-9401 Vlorë-Albania

Tel: +355 33 4 11 555
Tel: +355 33 4 11 666
Fax: +355 33 4 11 777

info@unipavaresia.edu.al
www.unipavaresia.edu.al

Valentini

NAIM FRASHËRI

Dëshira

Zot!
Sot
Jam,
Kam,
Shoh,
Njoh,
Rronj,
Shkonj;
Kam gas
Dhe flas
E them
Të kem
Ditë,
Dritë,
Jetë,
Vetë,
Ah, dua,
Që thua,
Të mos vdes,
Po të mbes
Përjetë
Të ketë
Shpirti im
Pa mundim
Shëndenë
Të jenë
Me mua
Sa dua.
Sonte jam gjall',
E jam mirë,
Po kam dhe mall
E dëshirë,
Zot i vërtetë
I gjithësisë!
Të rronj përjetë
Ndaj njerëzisë!
Ti ke në dorë,
Çdo gjë që të duash;
Nukë je i gjorë,
Arrin që të thuash;
Pa bëhenë gjithë ç'dua,
Po të më dëgjosh mua,
Le të bëhetë thua,
Dhe gjithë janë bërë!
Atë që thua ti vetë,
Zot i math e i vërtetë!
Ajo bënetë në jetë,
Edhe mbaronet' e tërë!
Ti epi jetë njerëzisë,
Shto e beko dhe bagëtinë,
Se ti je Zot' i gjithësisë,
Në dorëz' e ke mirësinë
Njerëzis' epi jetë të gjatë,
Mundimet fare nga jeta ngreji,
Djepinë shkret' e lugënë thatë
Mos e shih kurrë, po mbushur leri.
Fal
Dhe ep
Gjithë ç'ke
Nga të mirat,
E të pështirat
Hidhi këtje,
A vari më ndonjë grep,
A mbuloji më ndonjë mal,
E lërë vetëm mirësitë,
Fal edhe dritë e jet' e ditë
Le të prehet gjithë njerëzija
E të mos ketë kurrë të këqija;
Ligësitë, djallëzitë e marrëzitë
Le të mos rrojnë paskëtaj edhe një ditë
Veç mirësija në këtë jetë të mbretëronjë,
Urdhëri yt, puna jote, Zotth' i math e i vërtetë,
E vërteta le të rronjë, gënjeshtra le të pushonjë
Bëj si të duash, ç'të them unë Zot i vërtetë? Ti e di vetë!

Andon Zako Çajupi

Dashuria

E mban mënd, moj Marë,
dashurin' e parë?
Njeri nuk e gjegji,
se jeshmë te vegji.
Unë pa ty s'rrojë,
vij' e të kërkojë;
ti pa mua s'rroje,

vij' e me kërkoje.
Në lule me erë
putheshim ngahere,
dhe si burr' e grua
losnim nënë ftua.
Një ditë, të dyza
losnim mbylla-syza:
U fshyem pa dukur
Cinë të besoj taninë,
perëndin' a dashurinë?
Perëndi në këte jetë
është dashuria vetë.

———

Bukuria jote, leshërat e tua
posi pëndë korbi, të gjata
mbi thua,ballëtë si diell,
faqetë si mollë,qafa jot' e gjatë,
mesi yt i hollë,sisëtë si shegë,
dhëmbët si thëlpënjë,buzët si
burbuqe, sytë si gështënjë,
dora si dëborë, fjala jote mjaltë,
kurmi yt i derdhur, shtati yt i naltë;
gjithë më kënaqin, të tëra t'i dua,
po zëmëra jote u bë gur për mua!

———

Pika-pika bie shiu
dhe dëbora flokë-flokë,
vetëtin e fryn veriu,
breshëri kërcet mi tokë!
Le të fryjë er' e ftohtë,
s'ka ç'më bën dimëri mua:
Dashuria më mban ngrohtë,
se pushtoj atë që dua.
Kur fryn era me tallas,
kur bie dëbor' e shi,
sa flë njeriu me gas,
kur ka mikenë në gji!

kur më vrau bukuria,
kur më zu dashunia
e më dogji rinia.

Migjeni

Dy buzë...

Dy buzë të kuqe,
dy dëshira të flakta,
që afshin ma thithën,
gëzimin ma fikën,
si fantazma hikën
ndër do bota të larta...
Dy buzë si tëpërgjakta,
dy dëshira të flakta,
që afshin ma thithën
në buzë kur mu njitën
andjet m'i trazuen,
zemrën ma tërbuen,
trurin ma helmuen
e në fund u mërguen...
Dy buzë të kuqe,
bukuri fatale,
të një gruaje stërzane
një pjsë zemre më nxorne,
një pranverë të tanë më morne
dhe gëzimin ma vodhne...
Ato dy buzë të kuqe
dhe dy lote të mija
qenë shenja të dhimbjes,

Lasgush Poradeci

Dëgjimi i Zemrës

Kur të më kujtosh,
Kur të vish të shkosh,
Kur të shkosh këtejza pranë
Që të çmallërosh

Ç'po dëgjon kur shkon?
Kur vjen e përgjon?
Ç'përgjon zemra në kët'anë
Fund në këtë hon?

Zemra jote sot,
Zemra jote mot,
sot e mot në ç'mallërime
Zemra që s'fle dot

Seç të ndjen këtaj,
Seç të ndjen pastaj,
Seç dëgjon ndaj vetes s'ime
(Si ndaj vet'e saj):

Mall e vrer që mbaj
Qaj, moj zemër, qaj.

Vrer e mall që flas
Plas, moj zemër, plas.

Mitrush Kuteli

Sime shoqe

Kaq afër jemi, por kaqë larg
Të lutem mos më prit-
Na ndajnë terre rreth e qark
Dhe yll për mua s'ndrit.

Përse ta lidhësh fatin tënd
Me një pafat si unë,
Kur di se emri im u shëmb
Me dhunë e me përdhunë?

Pra hidhe hapin guximtar
Ndaj jetës së gëzuar.
Dhe më harro këtu, në varr,
Të vdekur pa mbuluar.

Se unë pres, përças po pres
Një udhë fort të gjatë
Dhe një të martë, në mëngjes,
Do hidhem nëpër natë.

Nëpër një natë që s'ka mbarim
Po qetësi për jetë:
Pushim...harrim...pushim...pushim...
Në prehjen e vërtetë.

Ismail Kadare

Ti ishe për mua

Ti ishe për mua e pamposhtur si Troja
Troja që unë dot s'e pushtoja.
Ti ishe për mua e pakuptueshme,
Më e pakuptueshme se mbishkrimet etruske

Vetëm në ëndrra, ah, në ëndrra
T'i përqafoja flokët e dendura.
Gaz më shumë ndjeja tek të pushtoja
Se gjithë grekët kur ra Troja.

Vetëm në ëndrra m'ishe e kuptueshme,
Ti, e shtrenjta ime etruske.

Pa ty

Ti ike udhes se pafundme
Ku zverdhin druret gjetherenes
Mbi gjokse pellgjesh tani tundet
I arti medalion i henes.
Lejleket iken.

Fill pas teje
Si stof i keq u zbeh blerimi
Dhe ngjajne toka, pylli, reja,
Me negativin e nje filmi.
Tani ne fusha shkoj menduar
Ku nis te fryje ere e ftohte,
Ku ca mullare te gjysmuar
Duken qe larg si Don Kishote.
C'te bej, po them me vehten time,
Ne kete ore te vone te muzgut,
Ku qerrja baltave ben shkrime.
Te lashta sa te Gjon Buzukut?
Do te shkoj te ulem permbi pellgjet,
Te pi ne gjunje duke rene,
Ne gryke e di qe do te me ngelet
I ftohte medalioni i henes.

Kristal

Ka kohë që s'shihemi dhe ndjej
si të harroj unë dalëngadal
si vdes tek unë kujtimi yt
si vdesin flokët dhe gjithçka.

Tani kërkoj poshtë e lartë
një vend ku ty të të lëshoj
një strofë a notë, a një brilant
ku të të lë, të puth, të shkoj.

Në s'të pranoftë asnjë varr
asnjë mermer, a morg kristal
mos duhet vallë prapë të të mbart
gjysëm të vdekur, gjysëm të gjallë.

Në s'gjetsha hon ku të të hedh
do gjej një fushë a një lulnajë
ku butësisht porsi polen
gjithkund, gjithkund të të shpërndajë.

Të të mashtroj ndoshta kështu
dhe të të puth të ik pa kthim
dhe nuk do dine as ne askush
harrim ish ky a s'ish harrim.

Dritero Agolli

Këtu s'do jem

Këtu s'do jem do jem larguar
Ne toke i tretur si të tjerët
Në kafenenë e preferuar
Nuk do më shohin kamerierët

Dhe nëpër udhët ku kam ecur
S'do ndihet kolla ime e thatë
Mbi varrin tim do te rrijë i heshtur
Një qipariz si murg i ngratë

Ti do trishtohesh atëherë
Se s'do më kesh në dhome të gjallë
Dhe kur në xham të fryjë erë
Do qash me erën dalëngadalë

Por kur të jesh mërzitur shumë
Në raft të librave kërkomë
Aty do jem i fshehur unë
Në ndonjë fjalë a ndonjë shkronjë

Mjafton që librin pak ta heqësh
Dhe un do të zbres do t'vi pranë teje
Ti si dikur me mall do qeshesh
Si një blerim pas një rrëkeje.

Letrat

Kur dashuroheshim në kohën tonë,
Kur tretesha dhe digjesha për ty,
Nga njeri-tjetri letrat vinin vonë,
Kalonte dhe një muaj apo dy.

Po ndofta dashuria mbahej gjallë,
Se zjarrin mbanin letrat në udhëtim
Me bicikletë a mushkë apo me kalë
Në vapë e shi, dëborë dhe thellim.

Kur dashuroheshim në kohën tonë
Me zor na vinin letrat fshat-qytet
Nuk kishim nëpër dhoma telefonë
Dhe në ëndërr s'kishte faks dhe internet.

Megjithatë më mirë që nuk kishte
As telefon as internet, as faks,
Se fjalë e nisur shpejt dhe mund ta vriste
Një dashuri të vjetër për një çast.

Timo Flloko

Shën Valentini i fundshekullit

Ta kushtoj Ty
këtë Natë të Shën Valentinit
Të gjallët,
prej ankthit të vetmisë
ngërthehen fort,
tek njeri-tjetri shpresat varin...
Këtë natë të fundit të dashurisë,
në fundin e mijëvjeçarit!

Drita Çomo

Dashuri siberiane

Po bie shi...dhe ti je kaq larg
Po ndoshta dhe s'dua të jem me ty
Ky qiell gri... Në shpirt- kaq akull
Kaq ftohtë në shpirt. Si në Siberi.

E megjithatë, unë të dua
Dhe të dua shumë, çuditërisht
Po qe se të urresh është njësoj si të duash
Të urrej dhe të dua njëkohësisht

Të urrej për atë, që më prishe qetësinë
Të urrej, pse erdhe tek unë
Për çdo gjë të vërtetë dhe çdo gjë të dyshimtë
Të urrej dhe të dua kaq shumë

Dhe në shpirt kam dimër, gjithnjë dimër
Një ftohtësi pa fund dhe pa anë
Në sa grade nën zero paske lindur
Dashuria ime siberiane

Në të tërë qenien time bie shi
Dhe ti nuk je. Dhe ti je kaq larg
Kam dëshirë për ty, kam nevojë për ty
Dhe prapë s'dua të jemi bashkë!

Xhevahir Spahiu

Vajzë e bukur

Bora e bardhë, e bardhë pas xhamave,
në kafe "Tirana" hyre,
ti e rralla si dëbora
që në Tirane bie.

Vajzë e bukur, si vajzë e dashuruar,
qofsh e dashuruar dhe prej meje,
prej syrit tënd
lulëzojnë dhe sendet.

Ekspresi gjallërohet
e gjithçka bëhet sy.

Në tavolinën e fundit
dy pleqve kafja po u ftohet.
Të shikojnë ty.

Rekuiem për orën 6...

Ora 6
Akrepat si dy krahë të hapur që presin
dhe ti s'po vjen
ti s'po vjen as në 6 e një minutë
në 6 e dy minuta vetmia ish me mua
unë isha me vetminë në 6 e tre minuta
në 6 e katër bota ishte po ajo
6 e pesa i ngjante 6 e gjashtës si dy pika uji
6 e shtatë, 6 e tetë, 6 e nëntë, 6 e dhjetë
Ti s'po vjen
S'po vjen
S'vjen
në 6 e pesëmbëdhjetë
hodha sytë si dy vetëtima në fushën e orës së qytetit
akrepat u thyen si dy krahë të një zogu
qe s'ekziston

Unë mora pikëllimin për dore
dhe ika!

Bardhyl Londo

Dashuri

Gjithçka si në ankthin e Noes
Si në rregullsinë pedante të një manastiri gjithçka;
Gjithçka e kristaltë, akull.
Gjithçka si krater vullkani
....rrëmujë
Kokën e ndezur të cigares shuaj në një gote ujë

Gratë e poetëve

Sytë e bukur mbyllin. Po gjumi
nuk e di ku është mërguar, nuk e di.
Njëra përsërit me vete një varg. Tjetra
një figure sjell ndër mend...
Si një lirikë dashurie
ledhaton pastaj jastëkun bosh në krahët e saj.

(...Vallë me ke u martuan burrat tanë,
me ne, apo me ty, poezi?...)

Një fjale, një rimë,
një lumë dashurie dhe pak xhelozi,
Mesnata e krijimit çapitet si plak i ngadalshëm.

Vonë. Sytë e bukur mbyllin.
dhe në ëndrra shohin vjershat e librave
të ardhshëm

Teodor Keko

E dashur

E dashur , erdha
E dashur erdha! Pse vrenjtesh kot?
Ti po më prisje përsëri,
mos u çudit, unë jam një zog.

Kur dashuroj bëhem si ajri,
e ngre folenë aty ku dua!
Do, s'do, të futem në kraharor,
të pushtoj si i marri.
Po e mbylle derën,
unë me forcë do ta hap,
do ta coptoj!

Do bësh sikur më ke inat.
Ndodhi e vjetër, unë e di!
S'jam buzëqumësht, por esnaf,
për dashurinë di plot dredhi!
Unë do të puth, do të pushtoj në gji,
dhe po ma mbylle derën ti.

E dashur, erdha, në prag ke dalë,
ke hapur portën dhe qesh nën hundë.
Sa përbetohesh me qindra fjalë,
më mirë, eja, më puth!

Kur dashuroj bëhem si ajri,
e ngre folenë aty ku dua!

Do, s'do të futem në kraharor,
të pushtoj si i marri.
Po e mbylle ti derën,
unë me forcë do ta hap,
do ta coptoj!

E dashur, erdha, pse vrenjtesh kot,
ti po më prisje përsëri.
Mos u çudit! Unë jam një zog.
Po e mbylle ti derën,
unë me forcë do ta hap,
do ta coptoj!

Ali Podrimja

Dashuria

Koha është te duhemi
te kesh besim ne mua kur te them: Trime,
te kem besim ne ty kur me tha: Trim.
Por kokën time kryeneçe shume kurthe ngrite,
shume e pushkët mbushi babai yt, fisi yt,
një mije e një te zeza kurdise ku do ma zije priten.
E nen kulm banonim,
nga frëngjia me drite me peshove,
me dite lexoja Shekspirin ne hijen e Kullës,
se mos do te takoj te kroni i shpresave.
Ma ruaj syrin, dashuria ime,
ma ruaj shpinën nga dielli, nga acari!
Kam frike se ma therin syrin cubat e territ,
kam frike se me vrasin pas shpine te pabesët.
Dashuria ime, ma zgjat dorën ta kapërcejmë këtë ujë te madh,
i huaj s'jam as vij nga toke e vdekshme.
Ne fund te livadhit te kositur a po sheh:
ai kali i bardhe është yni e tash përgjithmonë.
Me shikon drejt ne sy, leri zënkat, fjalët, sharjet,
Unë do te të sjell Lulen nga zemra e Bjeshkës,
do ta ndez llambën në Kullë,
do ta hedh farën në tokën e re.
Kur të desha, çoja dashurie me një grua të marrë,
e mëhalla jehonte nga shpifjet.
Na iku jeta, trime, s'menduam pak edhe për vete,
Koha është të duhemi.

Jorgo Bllaci

Netës

Kushtuar P.J.
Kaq e shtrenjte kurrë s'më je dukur,
Ti vërtet nuk paske shëmbëllim!
Ah, moj Neta, sytë e tu te bukur
Çmendurisht i deshte miku im!

Nëse këtë çast i ngrysur mbeta
Duke të vështruar ty kështu
Ti mos m'u çudit aspak, moj Neta
Me kujtuan mikun sytë e tu

Sa dëshirë do te kisha sonte
T'ju vështroja bashke që të dy:
Vetëm ta dëgjoje te këndonte
Vargjet qe me zjarr t'ë thuri ty!

Ndoshta sot, qe vite pas la jeta,
Miku prapë ne shpirt te mban diku…
Ish e bukur dhembja e tij, moj Neta,
Aq sa ç'janë edhe dy sytë e tu.

Vath Koreshi

Shpesh ti s'di ç'bën

S'është e thjeshtë të dish të bësh.
Shpesh ti s'di se ç'bën e dashur!
Ç'doje që ishe ngritur si në ethe,
ç'doje që vije ashtu tek unë?
Kishe këputur ca lule në kopësht,
kishe ndërruar tualet e krehje flokësh,
kishe marrë me vete dy sy të shndritshëm plot mall.
Në jakën e xhaketës në vend të një luleje,
kishe vënë një sqep skifteri xanxar.

Ah, s'ishe as grua, as vajzë e vogël atë çast,
ishe një hutim plot ditë e gaz.
Ishe një shpirt i mbushur me frikë,
një zemër drithëruese me natë e me dritë.
Eja pra, të thashë, mbështetma kokën tani,
mbushmi supet me ujëvarën e flokëve,
dhe puthmë nëse erdhe për të më puthur,
dhe çelma shpirtin, nëse erdhe për të ma çelur.

Azem Shkreli

Sogje

Sonte ne të dy
jemi dy sy të kësaj sogje

Orët zgjuar
Do të rrinë, kambanat zgjuar

Sonte unë e ti
jemi ai zgjim i zekthët

Ujqit në këmbë
Do të jenë, Kosova në këmbë

Natë që s'more
Pushkë, as të mori pushka

Gezim Mekuli

Pa ty

Tokën prej kohësh e ka zën' gjumi.
Konstelacionet jan' ngatërruar.
Dielli ësht' tretur si shkumë sapuni.
Hëna fytyrën ka dobësuar.

Toka s'po sillet më vërdallë.
Yje në qiell kan' mbetur pak.
Dielli s'po bëhet më i gjallë.
Hëna ndriçon dyfish më larg.

Brixhilda Ndini

Largimi yt

Me sy ma bene avionet e ikjes
Por une nen pallton e kuqe
Me duart e verbra ,mbulova syte.
Nuk ishin te verbrit jo ,
Por sirenat ne bord,
Qe si stuardeza te dehura
Zvarriteshin nen kembet e te dashuruarve.

Të dashuruarit

Yjet dhe gjarperinjte s'te lene te afrohesh kaq shume.
Kurse ti ke rene permbys
Ne reren e shkrifet te trupit tim.
Ne mes te tavolines se autopsiese
Qendron i rrethuar me trendafile
Ne trup s'ke hala, as eshtra
Por penela qe te ngjyrosin,
Reklame e perbindshme dashurie !
Na duhet ti rritim floket,
Ose bejme sikur i zgjasim
mbi paruke perrenjsh,
te futur thelle ne toke,
e kur te jemi larg sa duhet per te mos folur,
te kemi dicka qe te na bashkoje.

Pa ty

Tokën prej kohësh e ka zën' gjumi.
Konstelacionet jan' ngatërruar.
Dielli ësht' tretur si shkumë sapuni.
Hëna fytyrën ka dobësuar.

Toka s'po sillet më vërdallë.
Yje në qiell kan' mbetur pak.
Dielli s'po bëhet më i gjallë.
Hëna ndriçon dyfish më larg.

Bashkim Metalia

Sakrilegj

Kemi në shpirt
Brenda kështjellës,
Tempullit të ëmbël
Të artë,
Tatëpjetës së shpejtë
Zgrip i mendjes ,
Lakuriqësinë e kafshatës
së thatë.
Dielli pa asnjë kordë,
Të të tremb hija
E errësimit.
Parvazit të portës
Gdhendur me modë,
Humbëtirë – endja
Para agimit.
Tempi i udhëve
Afsh dhimbjeje,
Religjion në mëvetësi,
Mbështillemi për motive klime
dhe pse s'e duam letargjinë.
Sikur kështella ime
Të më mbyllet ,
Sot – gjithëmonë
Engjejt le të më binden
Në përjetime…
Shpirti flet – dikush
Ta dëgjojë.
Ritmikisht
frymëmarrja rritet,
jo, s'e dua këtë mëshirë
ky oaz
kafshatë e frikës
mpleks gjetiu
një dëshirë.

Petrit Kuçana

VJESHTA E HERRUR

Është herrur vjeshta. Krejt anjerë zim është anës rrypit të shtrënguar më vegëz të kapur në një rruzë të bardhë gjaku, që lejon gjuajtjet e gjetheve prej majës së degës së myshtshme. Është sosur edhe drita prej ku më duhet të largohem. Të thashë se duhet të nisem mikja ime, për në anën tjetër ku lidhen dy guaska dritë të vjedhura në një shkëmb të hershem. Kjo duhet të jetë arsyeja kryesore që sillet si një grusht mizash në porcelanin e plasur, para syve të mi. Ishte më e madhja pabesi që toka që po iu merrte detit. Nuk pat më tokë për detin. Rrumbullak e mblodha në peshqirin tim, detin dhe nuk prita ta fsheh në ndonjë rrudhë por e mora më vete në çantën zyrtare, që nuk kontrollohet në aeroporte. Rrafsh më tavanin e flliqët ishte edhe lavdia shtatkrenore e strucëve që hëngrën bukën e papjekur, krejt të vetëdijshëm se mullixhiu nuk i kishte përvjelur krahët as kur ana e samarit u rrokullis në globin e shpuar në paralelen rrethore që ndan tokën e zezë më detin e kuq. Krejt i kurrkundshëm më duket se isha kur ju shkrova letrën e parë kur nuk tregova kujdes dhe djepi u përkund dhe kërmilli ra më fytyrë në hi. As nuk fola për zjarrin as nuk i tregova kujt, se peshqirin e kisha në çantën e vogël të dorës, tip dosje të zezë. Nuk më ka rënë që të bëhet më pluhur pasi shpesh i pështyja gishtat i gatshëm për t'i hequr çdo njollë sado të vogël. Nuk e kam humbur atë çantë. Di që e kam mbjellë. Nuk mbaj mend mirë që në të kishte shkronja të rreshtuara sipas një rendi të kopjuar nga gardhi i kalbur, që është gati të bjerë e ketrat sulmojnë arat më misër për të lehtësuar ardhjen e vjeshtës. Nuk më kujtohen as piktutrat që i koleksionova më njerëz pa krahë e më fytyra të lyera rëndë më krem që të shpëtojnë prej zverdhjes. Çantën e kam mbjellur, bashkë më peshqirin që e mblodha detin. Për të mos çelë minj në atë çantë e lashë edhe një cigare, një mollë të pakafshuar dhe një kokërr dhëmbi të bardhë. Arsyeja janë mijtë kryekëput origjinal pasi një peshqir i lagur dhe një kujtim në një mjedis të mbyllur janë kushtet ideale për të çelur minj. Por prapë nuk besoj se peshqiri është i lagur. Deti ishte i kuq kur e mora në peshqir. Atë ditë në qytet u poq halmë për të gjithë e unë nuk e hëngra as edhe një grimë, për t'u betuar që nuk kam marrë pjesë në lirinë e vdekjes. Unë nuk isha i lirë e as i gatshëm për këtë. Nuk kam mundur të rri pa ndrequr rrasa varresh e as nuk kam mundur të rri pa shndritur ndonjë emër të shlyer prej myshkut. Në fushën e vrapit nuk pati më anije që të sillnin pëllitjet e tyre në emër të lirisë. Bari kishte mbirë për mrekulli e gropzat mes fijeve të barit ishim të shumta si stinë e bereqetshme që u cilësua. E më shanë mikja ime se nuk arrita të përfitoj nga teprimi i jetës e nga fyerja e tokës. Ishte britma e dritës që kapi mitrën e tokës, e unë e mora vesh se dita është e tokës. Është krejt e tokës. Edhe nën drizat gjembaçe mund të duken gishtat e dritës për nga gjiri i shtypur gur më gur i tokës. Ishte vjeshtë e kalakryq ishin firnajat më këmbë të nxira nga kënga e buzve të rreshkura deri në genin e ndërgjegjes, e prapë nuk u kuptua uria si dergjë e një kujtimi, si shenjë e plakjes së parakohshme. Nuk pati më as lundër vajtuese për dritën e piskama u mbyt në tavan ku mizat lanë vezët. Edhe zogjtë mbeten jetim e kukullat u groposën ditën e hallmës në gropën e hapur në fund të qytetit nga varrmihës të panjohur. U mbuluan më gjethe të lagura dhe skifterët u përqafuan paqtësisht e bënë orgji në degët e shkurtra të rrasura në trungun e tharë. Pranverën nuk e priten për të herrur barërat në rrënjët e lisave, e turmat e dallëndysheve thanë se do t'i kthejnë. Ajo vjeshtë ishte e herrur. Nuk kishte as dritë, as gjethe madje as berber për të qethur lavditë shtatëkrenore të strucëve bishtprerë.

ENERGJI



ENERGJI

Ne ndërtojmë Energji







ENERGJI SH.P.K

Adresa: Rruga "Mihal Grameno" Pallati 94, shkalla 2, ap.25 Tiranë